# RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

## “AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE NË BASHKINË LIBRAZHD”

**TIRANË, QERSHOR 2019**

| NR | PERMBAJTJA | FAQE |
|---|---|---|
| I | PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 4-16 |
| II | HYRJA | 17- 21 |
| III | PËRSHKRIMI AUDITIMIT | 22 - 78 |
| IV | GJETJET DHE REKOMANDIMET | 78 - 87 |

# SHKURTIME.

| | |
|---|---|
| **KLSH** | Kontrolli i Lartë i Shtetit. |
| **MFK** | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli. |
| **NA** | Nëpunës Autorizues. |
| **NZ** | Nëpunës Zbatues. |
| **GSM** | Grupi i Menaxhimit Strategjik. |
| **NJAB** | Njësia e Audtimit të Brendshëm. |
| **AB** | Auditi i Brendshëm |
| **MAB** | Manuali i Auditimit të Brendshëm. |
| **FZHR** | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve |
| **AQT** | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara. |
| **UMF** | Udhëzim i Ministrisë së Finacave |
| **VKM** | Vendim i Këshillit të Ministrave. |
| **VKB** | Vendim i Këshillit Bashkiak. |
| **ISSAI** | Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. |
| **INOTSAI** | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit. |
| **ISA** | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit |
| **IFAC** | Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve |
| **IPSAS** | Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik |
| **ALUIZNI** | Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale. |
| **IT** | Teknologjia e Informacionit. |
| **NJA** | Njësi Administrative. |
| **SHA** | Shoqëri Anonimë. |
| **BOE** | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë. |
| **OE** | Operator Ekonomik. |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**1.a.** Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Librazhd dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar 65 transaksione financiare nga data bazë e thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur tre zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230- 231 “investime, si dhe 16 procedura prokurimi, me vlerë 70% të fondit limit të prokuruar për periudhën objekt auditimi.

## I.b. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE.

| Gjetja | Përmbledhje e gjetjes | Referenca në Raport | Rëndësia | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nga auditimi i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera në Bashkinë Librazhd rezultoi se, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se:<br>- Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh.<br>- Nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut sipas nenit 21. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.<br>- Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohej me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. | *23 – 24* | E lartë | Nga Bashkia Librazhd, nëpërmjet Nëpunësit Autorizues dhe strukturës së Auditit të Brendshëm, të marren masa për njohjen nga menaxhimi dhe stafi i MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. |
| 2 | Nga auditimi i Aktiveve të Qëndrueshme të | *24 – 27* | E lartë | Nga Bashkia Librazhd të merren |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | trupëzuara, rezultoi se:<br>**a- *Llogaria 210*** <u>"Toka, troje, terrene".</u> Krahasuar me vitin 2016 ka shtesë në zërin "Toka, troje terrene" në vlerën **2,261,693 lekë**. Kjo shtesë ka të bëjë me investime në varrezat e reja publike të qytetit me emërtimin "Varrezat e fushës së Manes", në vlerën 2,261,693 lekë, investim i përfunduar dhe i marrë në dorëzim gjatë vitit 2017. **Vlera prej 621,522 lekë** (e përbërë nga 144,650 lekë vlera e truallit të varrezave të vjetra të qytetit, dhe 476,872 lekë vlera e trashëguar nga ish komuna Qendër, sot NJA e Bashkisë Librazhd, për prita lumore e mbrojtje tokash) është gjendje në fund të vitit 2016. ***Pavarësisht se është regjistruar në kontabilitet "Prita lumore" e trashëguar nga ish komuna Qendër, në vlerën 476,872 lekë, nuk është e regjistruar në ZVRPP.***<br>**b- *Llogaria 211*** "Pyje, kullota, plantacione" paraqitet në vlerën 4,662,464 lekë dhe i përket ish komunës Hotolisht. Për këto objekte janë hartuar listat, por për këto pasuri nuk është kryer regjistrimi i pronave në ZVRPP, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi VKM nr. 510, datë 10.6.15 që janë vënë në dispozicion të Bashkisë Librazhd dhe njësive administrative.<br>**c- Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione"** është në vlerën 557,525,466 lekë dhe përbehet nga 111 ndërtesa. Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të Bashkisë Librazhd vlera e llogarisë "Ndërtime e konstruksione" në fund të vitit 2017 është 557,525,466 lekë. Krahasuar me vitin 2016 kemi një shtesë prej **15,544,739** lekë. Kjo shtese ka ardhur si rezultat i shtimit të vlerës se disa objekteve nga investimet e kryera në objekte.<br>Nga auditimi rezultoi se janë regjistruar si pasuri dhe janë pajisur me certifikatë pronësie vetëm ndërtesat në territorin e ish Bashkisë Librazhd, përkatësisht 22 ndërtesa me një vlerë në kontabilitet prej 161,220,267 lekë. 89 ndërtesa qe ndodhen ne territorin e ish komunave qe i janë bashkuar Bashkisë Librazhd në kuadrin e reformës territoriale dhe qe janë përfshirë në kontabilitet me një vlere prej 396,323,199 lekë, nuk është bere regjistrimi i tyre si pasuri e Bashkisë Librazhd .<br>***d- Llogaria 213*** *"Rrugë, rrjete vepra ujore"*, sipas pasqyrave financiare të Bashkisë | | | masa për inventarizimin e këtyre aktiveve, plotësimi i dosjes me dokumentet ligjore dhe regjistrimi i tyre ne ZVRPP Librazhd. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Librazhd, në fund të vitit 2017 është në shumën 1,958,871,679 lekë. Krahasuar me vitin 2016 kemi një shtesë në vlerë të kësaj llogarie **prej 677,009,852 lekë** si rezultat i investimeve të kryera nga Bashkia Librazhd gjate vitit 2017 në shumën **80,019,117 lekë**, në rrugë, rrjete e vepra ujore si dhe si rezultat i transferimit kapital pa pagesë të kanaleve vaditëse nga Drejtoria Rajonale e Ujitjes dhe Kullimit Korçe. Shtesat e kësaj llogarie gjatë vitit 2017 janë në vlerën **596,990,736 lekë**.<br>Lista e objekteve të ardhura nga Drejtoria Rajonale e Kullimit Korçe për rrjete vepra ujore kanë vlere fillestare, por këto objekte nuk janë hipotekuar, regjistrimi i tyre në kontabilitet është kryer sipas proces-verbalit datë 18.12.2016, "Mbi gjendjen aktuale për transferimin e infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit" të mbajtur nga komisionet përkatëse të Bordit Rajonal të Kullimit Korçë dhe Bashkisë Librazhd, me nr. prot 1528, datë 16.03.2017. ***Nga ana e Bashkisë Librazhd*** asetet janë bëra hyrje dhe janë kontabilizuar, pa u regjistruar në ZVRPP. | | | |
| 3 | Nga auditimi i **Llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm"** rezultoi se sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Librazhd gjendja e debitorëve ne fund te vitit 2017 është 75,553,179 lekë. Konstatohet se nuk janë përfshire në bilancet e viteve 2016- 2017 detyrimet e pa likuiduara për vendimet gjyqësore në **vlerën 9,094,562 lekë.** Gjatë vitit 2017- 2018, janë likuiduar detyrimet e lindura nga vendimet gjyqësorë të formës prerë **6,883,329 lekë**, pavarësisht se nuk janë përfshirë në bilancin e viteve të mësipërme. Vlera e detyrime për vendimet gjyqësore të formës se prerë me datë 31.12.2018 është 22,656,907 lekë, vlerë e cila duhet të përfshihet ne bilancin e vitit 2018. | *27 – 28* | E lartë | Nga ana e Bashkisë Librazhd, të merren masa që të përfshihet vlera e detyrimeve për vendimet gjyqësore të formës së prerë në shumën 22,656,907 lekë ne bilancin e vitit 2018. |
| 4 | Nga auditimi u konstatua se në fund të vitit 2018, detyrimet e faturuara dhe të pa likuiduara për fondet e bashkisë, buxhetit të shtetit, Fondit të Zhvillimit të Rajoneve dhe Vendimeve Gjygjësore në fund të vitit 2018 është **në shumën 87,132,631 lekë** Nga të cilat:<br>-Fatura të pa likuiduara për mallra e shërbime, për 33 raste në vlerën, 28,831,096 lekë;<br>-Fatura të pa likuiduara për mallra e shërbime para vitit 2015 nga ish Komunat, janë 9 raste në vlerën, 35,644,628 lekë; | *33 -34* | I mesëm | Bashkia Librazhd, Drejtoria Ekonomike, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **87,132,631 lekë** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | -Vendime gjygjësore në vlerën, 22,656,907 lekë, | | | |
| 5 | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Taksave, Bashkia Librazhd, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27-Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **188 persona** me vlerë **6,368,160 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd, sipas Aneksit nr. 21. | *34 -35* | E lartë | Bashkia Librazhd, nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Sektorit të Taksave në bashkëpunim me ALUIZNI-n Librazhd dhe ZVRPP Librazhd të merren masa të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së infrastrukturës në vlerën **6,368,160 lekë**, sipas listave të debitorëve bashkëlidhur në Aneksin nr.21 të Projekt Raportit të Auditimit. |
| 6 | **:** Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej **520 subjekte debitore, për vlerën 26,214,306 lekë lekë** (sipas Anekseve nr. 22, 23 dhe 24) dhe **4921 familje për vlerën 39,016,000 lekë** (për taksë toke në vlerën 18,711,000 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 7,134,000 lekë, për taksë trualli në vlerën 35,000 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 13,136,000 lekë.<br>Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për njoftimin e subjekteve debitore të biznesit të vogël nuk ka zbatuar përcaktimet e pikës 1 të nenit 89, të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.<br>-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet. | *35 -37* | I mesëm | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Taksave, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj 520 subjekteve me vlerë prej 26,214,306 lekë *(sipas Anekseve nr. 22, 23 dhe 24)* dhe 4921 familje për vlerën 39,016,000 lekë (për taksë toke në vlerën 18,711,000 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 7,134,000 lekë, për taksë trualli në vlerën 35,000 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 13,136,000 lekë), |
| 7 | Nga verifikimin e listave të subjekteve debitorë në vite, konstatohen subjekte aktiv dhe me detyrime. Kështu sipas të dhënave kemi 480 subjekte aktiv me detyrime, e barabartë me 92.3% të numrit total të subjekteve (520 subjekte), gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të Sektorit të Taksave në arkëtimin e detyrimeve debitorë, veprim | *35 -37* | | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Taksave në bashkëpunim me Sektorin Juridik, në funksion të mbledhjes së detyrimeve të papaguara, të marrë masa administrative apo sekuestro deri në kallëzim penal për mos pagesë të detyrimeve |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | në papajtueshmëri me kërkesat e Kreut XI- *Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve.* | | | |
| 8 | Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Librazhd, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e lidhura me subjektet për shfrytëzimin e sipërfaqeve për ndërtimin e HECEVE, **për vlerën 2,465,694 lekë,** që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, Veprim në kundërshtim me nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe kushtet e kontratave. | *37 -38* | I mesëm | Bashkia Librazhd, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **2,465,694 lekë,** nga *(subjekti “D....” në vlerën 339,300 lekë, “Hec. D...” në vlerën 1,421,733 lekë, “E...” në vlerën 359,500 lekë dhe “B...” në vlerën 345,161 lekë).* |
| 9 | Agjencia e Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Librazhd, për subjektet të cilat nga MIE kanë marrë leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore dhe kullosore nuk ka zbatuar kërkesat ligjore, për lidhjen e kontratave për shfrytëzim të fondit pyjor nga subjekte të ndryshme **me sipërfaqe 512 ha**, për realizimin e të ardhurave për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me kërkesave të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të pikës 6 neni 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, nuk ka njoftuar subjektet për t`u paraqitur për lidhjen e kontratave për të ushtruar këtë aktivitet dhe likuidimin e detyrimeve që lindin nga zbatimi i VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, sipas lidhjes nr. 2. | *38 -39* | I mesëm | Agjencia e Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Librazhd, t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.<br>Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 10 | Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Librazhd, për periudhën objekt auditimi, është miratuar për të funksionuar me tre punonjës. Nga auditimi rezultoi se për periudhën 01.01.2016 deri me 30.06.2018, ka funksionuar me një punonjës dhe më pas me dy punonjës. NJAB nuk ka vlerësuar si duhet riskun.<br>- Për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 114 datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10 2016, "Për miratimin e Manualit te Auditimit te Brendshëm në sektorin publik" "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik". | *75 -77* | I mesëm | Nga Bashkia Librazhd të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të plotësohet me numrin e punonjësve sipas organikës së miratuar,<br>NJAB, Bashkia Librazhd, të hartojë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për cdo auditim. |
| 11 | Nga auditimi rezultoi se në hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim në procedurat e prokurimit të audituiara për periudhën objekt auditimi rezultoi se nuk kanë gjetur zbatim aktet ligjore e nënligjore të fushës së prokurimit publik, duke mos i argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 26, pika 5, nenin 61, pika 2, paragraf i të VKM nr.914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". | *39 – 62* | I mesëm | Autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd, të marrë masa në zbatimin e akteve ligjore e nënligjore të LPP, për përcaktimin e kritereve të veçanta për kualifikim në përputhje me objektin e prokurimit. |
| 12 | **KLSH nga auditimi konstatoi se** fondi limit dhe specifikimet teknike për procedurat e prokurimit per vitet 6 mujori i dytë 2016, 2017 e 2018, janë përllogaritur nga komisionet e vlerësimit të fondit limit, të ngritur sipas urdhrave të Kryetarit të Bashkisë, sipas tabelave ANEKS C/3, bashkëlidhur. Në këto urdhra është përcaktuar që specifikimet teknike të hartohen në përputhje me kërkesat e nenit 23 | *39 -44* | I mesëm | Bashkia Librazhd të marrë masa që komisionet e hartimit të fondit limit, të respektojnë urdhrat e Titullarit të AK si dhe aktet ligjore e nënligjore të prokurimit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | "Specifikimet teknike" të LPP. Në kundërshtim me urdhrin e dhënë nga Titullari i AK në procesverbalet e punës së komisioneve, ku është hartuar preventivi (fondi limit), nuk janë përcaktuar kërkesat teknike në lidhje me procedurën e prokurimit (fuqinë punëtore, stafin drejtues teknik, punonjësit e specializuar, kategoritë e licencës, makineritë, certifikatat ISO, etj.), në kundërshtim me kërkesat e nenit 23/4 të LPP, si dhe të Urdhrave të Titullarit të Autoritetit Kontraktor. | | | |
| 13 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt "Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)" të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe BOE "B..." SHPK & "C..." shpk, përfaqësuar nga OE "B...", u konstatua se aktualisht në veprën e ndërtuar, nuk është montuar pajisja "Impianti i klorifikimit të ujit të pishëm" me vlerë 351,549 lekë pa TVSH si dhe nuk është realizuar pika e lidhjes për furnizimin me energji elektrike të dhomës së komandimit. | *62 -65* | I mesëm | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t'i kërkojë BOE "B..." SHPK & "C..." shpk, përfaqësuar nga OE "B..." SHPK, lidhjen e energjisë elektrike si dhe montimin e Impiantit të klorifikimit të ujit të pishëm, sipas projektit të zbatimit në zbatimin të detyrimeve kontraktuale i përcaktuar në kontratën dy paleshe. |
| 14 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt: "Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik "V..." SHPK, u konstatua se, në progresivin Prog. 3+693 deri Prog. 3+713, pra për gjatësinë 20 m dhe gjerësi 4 m shtresat asfaltike kanë çeduar duke shkaktuar një efekt negativ si vijon:<br>- Shtresë binderi me zall lavatriçe, 5 cm me makineri 80 m2 x 1275 lekë = 80,000 lekë<br>- Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe, 3 cm me makineri 80 m2 x 1000 lekë = 102,000 lekë<br>Për sa më sipër është në kundërshtim me DST dhe kontratën e nënshkruar, cilësia e punimeve në ndërtim. | *68 -70* | I mesëm | Bashkia Librazhd t'i kërkojë shoqërisë "V..." SHPK, të marrë masa për riparimin e defekteve të konstatuara në shtresat asfaltike, si dhe të realizojë riparrimin e tyre në përputhje me specifikimet teknike brenda periudhës së garancisë së defekteve.<br>Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa që në vazhdimësi për kryerjen e procesit të kolaudimit, të ngrejë grupin brenda 30 ditëve nga data e deklarimit të përfundimit të punimeve nga zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve. |
| 15 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt: "Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibrës", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik "V..." SHPK, u konstatua se, në piketën poshtë urës për gjatësinë 7 m dhe gjerësi 4 m shtresat | *71 -73* | I mesëm | Bashkia Librazhd t'i kërkojë Operatorit Ekonomik "V..." SHPK , të marrë masa për riparimin e defekteve të konstatuara në shtresat asfaltike, si dhe të realizojë riparrimin e tyre në përputhje me specifikimet teknike brenda periudhës së garancisë së defekteve. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | asfaltike (shtresë binderi dhe shtresë asfaltobetoni) janë dëmtuar. Nisur nga fakti që punimet e ndërtimit janë brenda periudhës së garancisë AK të marrë masa që të mos e marrë në dorëzim pa bërë rregullimet përkatëse. Për sa më sipër realizimi i punimeve me cilësi të dobët, është në kundërshtim me DST dhe kontratën dy palëshe të nënshkruar. | | | |
| 16 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt : “Furnizimi me ujë i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Bashkimit të Operatorëve “B...” SHPK & OE “C...” shpk u konstatua se zërat e punimeve si vijon: Gërmim dheu me krah e transport me k. Dore 10 m, kategoria IV; Kollona të plota b/a C 16/20 të parapërgatitura dhe F.V Hekur betoni periodik ø 6-10 mm, janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **307,200 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. | *63 -64* | E lartë | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t’i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “B...” SHPK & “C...” shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **307,200 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)”. |
| 17 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: Ndërtimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza II), të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik “B...” SHPK u konstatua se zëri i punimeve: “2(3.30/c) Gërmim shkëmbi me krahë, në seksion të detyruar, h=1.5 m, shkëmb i fortë” është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **249,200 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. | *63 -65* | E lartë | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t’i kërkojë Operatorit Ekonomik “B...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 249,200 lekë pa TVSH, |
| 18 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik “V...” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve “Zëri (An-9) Mbushje me zhavorr pas mureve”, është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **267,804 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. | *66 -69* | E lartë | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t’i kërkojë Operatorit Ekonomik “V...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **267,804 lekë pa TVSH,** të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)”. |
| 19 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt: | *66 -70* | E lartë | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t’i kërkojë Bashkimit të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | “Rikualifikimi urban blloku i banimit nr. 1, qyteti Librazhd”), të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “E...” SHPK & “L...” SHPK, përfaqësuar nga OE “E...” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve, “Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m$^2$, Rruga e Policisë dhe Rruga Arbëria”, është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume është në shumën **152,256 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. | | | Operatorëve Ekonomik “E...” SHPK & “L...” SHPK, përfaqësuar nga OE “E...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **152,256 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër**.** |
| 20 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik “V...” SHPK përfaqësuar nga administratori (përfaqësues ligjor) z. F.K., u konstatua se zërat e punimeve: “Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m$^2$”; “F.V bordura betoni 20x35 cm beton 16/20” dhe “Bazament betoni (rreth rrotullimi) dhe zëri (2.271) shtresë mozaik mermeri (rreth rrotullimi)”, janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume është në shumën **262,220 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. | *70 -70* | E lartë | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t’i kërkojë Operatorit Ekonomik “V...” SHPK përfaqësuar nga administratori z.F.K., duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **262,220 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibrës”. |
| 21 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rehabilitim urban, zona në hyrjen perëndimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik “V...” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve: “Kallëp dërrase për mure”, është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume është në shumën **245,000 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. | *73 -74* | E lartë | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t’i kërkojë Operatorit Ekonomik “V...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **245,000 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rehabilitim Urban, Zona në hyrjen perendimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore”. |

## I.c. OPINIONI I AUDITIMIT

**Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.**

**Për drejtimin e Bashkisë Librazhd.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare[1] të Bashkisë Librazhd, për vitin ushtrimor, nga 1 Janar 2017 deri 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

**Opinion i modifikuar me rezervë[2]:**

Sipas mendimit tonë, përveç çështjes së theksuar në paragrafin e "Bazës për Opinionin e Modifikuar me rezerve", pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare më datë 31 dhjetor 2017, referuar Ligjit "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

**Baza për opinion e modifikuar me rezervë:**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin "Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare" të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se:

**a-** Në llogaritë e poshtëshënuara të AQT, janë bërë hyrje dhe janë kontabilizuar vlerat, në shumën 618,943,922 lekë, në një kohë që nuk është bere regjistrimi i tyre si pasuri e Bashkisë Librazhd, konkretisht llogaritë me vlerat përkatëse sa vijon:

Llogaria 210 "Toka, troje, terrene", në shumën 476,872 lekë

[1] *ISSAI 1705 - "Ndryshimet në opinionin e auditimit në raportin e audituesit të pavarur"; ISA 1705 ka të bëjë me përgjegjësinë e audituesve për të përgatitur një raport të përshtatshëm, në kushtet kur gjatë krijimit të një opinioni në përputhje me ISA 700175), audituesi arrin në përfundimin që modifikimet e opinionit janë të nevojshme për pasqyrat financiare.*

[2] ***Opinioni i modifikuar.*** *Audituesi duhet të shprehë një opinion të modifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku,* ***janë materiale, por jo të përhapura****, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë* ***dëshmi të mjaftueshme*** *dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.*

Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”, në shumën 4,662,464 lekë
Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, në shumën 396,323,199 lekë
Llogaria 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, në shumën 596,990,736 lekë

**b-** Në Llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë në bilancin e vitit 2017 detyrimet e pa likuiduara për vendimet gjyqësore në vlerën 9,094,562 lekë. Gjatë vitit 2017-2018 janë likuiduar për shlyerjen e detyrimeve të lindura nga vendimet gjyqësorë të formës prerë 6,883,329 lekë, pavarësisht se nuk janë përfshirë në pasqzrat financiare të viteve të mësipërme. Vlera e detyrime për vendimet gjyqësore të formës se prerë me datë 31.12.2018 është 22,656,907 lekë, vlerë e cila duhet të përfshihet ne bilancin e vitit 2018.

**Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Librazhd**[3]

Ne kemi audituar përputhshmërinë[4] e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).
Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Librazhd, gjatë periudhave ushtrimore 6 mujori i dytë i vitit 2016, 2017 dhe 2018.

**Opinion i modifikuar me rezervë.**

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Librazhd, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e modifikuar me rezervë”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura.

**Baza për opinion me rezervë:**

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime nga kuadri rregullator për sa i përket, menaxhimit financiar dhe kontrollit, transaksionet e kryera për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi. Kemi konstatuar se:

**1-** Nga auditimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, rezultoi se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm;

**2-** Detyrimet e faturuara dhe të pa likuiduara për fondet e bashkisë, buxhetit të shtetit, Fondit të zhvillimit të rajoneve dhe vendime gjygjësore në fund të vitit 2018 janë **në vlerën 87,132,631 lekë**.

**3-** Përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk janë nxjerrë akte që provojnë gjurmën e auditimit të këtij procesi,

**4-** Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në fund të periudhës konstatohet nivel i lartë i debitorëve i cili në fund të periudhës rezulton në **520 subjekte për vlerën 26,214,306 lekë**

**5-** Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2018, janë gjithsej debitorë **4921 familje për vlerën 39,016,000 lekë** (për taksë toke në vlerën 18,711,000 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 7,134,000 lekë, për taksë trualli në vlerën 35,000 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 13,136,000 lekë;

[3] ***ISSAI 4100 –*** *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.*
[4] *Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.*

**6-** Nga verifikimin e listave të subjekteve debitorë në vite, konstatohen subjekte aktiv dhe me detyrime. Kështu sipas të dhënave kemi 480 subjekte aktiv me detyrime, e barabartë me 92.3% të numrit total të subjekteve 520 gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të Sektorit të Taksave në arkëtimin e detyrimeve debitorë,

**7-** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Librazhd, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e lidhura me subjektet për shfrytëzimin e sipërfaqeve për ndërtimin e HEC$^{eve}$, **për vlerën 2,465,694 lekë,**

**8-** Nga auditimi rezultoi se në hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim në 4 procedurat e mëposhtme:

-"Rehabilitimi urban i zonës përreth fushës së sportit, Librazhd";

-"Rikonstruksion dhe shtesë anësore shkolla e mesme e bashkuar "Isa Alla", fshati Zgosht, NJA Lunik";

-"Rehabilitim urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore të qytetit të Librazhdit dhe SA rruga e Dibrës";

-"Rikualifikim urban, blloku i banimit nr.1, të qytetit të Librazhdit",

rezultoi se nuk kanë gjetur zbatim aktet ligjore e nënligjore të fushës së prokurimit publik, duke mos i argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 26, pika 5, nenin 61, pika 2, paragraf i të VKM nr.914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime.

**9-** Në zbatimin e 5 kontratave u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm të punimeve, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, konkretisht:

"Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)" (dëmi ekonomik 307,200 lekë pa TVSH);

"Ndërtimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza II)" (dëmi ekonomik 249,200 lekë pa TVSH);

"Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)") (dëmi ekonomik 267,804 lekë pa TVSH);

"Rikualifikimi urban blloku i banimit nr. 1, qyteti Librazhd" (dëmi ekonomik 152,256 lekë pa TVSH);

"Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibrës" (dëmi ekonomik 262,220 lekë pa TVSH)

"Rehabilitim Urban, Zona në hyrjen perëndimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore" (dëmi ekonomik 245,000 lekë pa TVSH)

**Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Librazhd**

Drejtimi i Bashkisë Librazhd, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i

kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## II.HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.14 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr.1433/1, datë 29.01.19 "Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Librazhd", të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 07.01.19 deri më datë 28.02.19., në subjektin Bashkia Librazhd për periudhën nga 01.07.16 – 30.09.18, u krye auditimi "Auditim financiar dhe përputhshmërie" nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **L.B., Përgjegjës Grupi**
2. **P.G., Auditues**
3. **V.V., Auditues**
4. **S.M., Auditues**

**Titulli:** Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Librazhd.
**Marrësi:** Bashkia Librazhd.
**Objektivat dhe qëllimi:** Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të Bashkisë Librazhd për vitin 2017 dhe dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me kuadrin rregullator në fuqi. Auditimi u shtri në vlerësimin e pasqyrave të Bashkisë Librazhd.
**Qëllimi i auditimit** të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.
Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.
Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.
**Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes:** Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.
Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi", duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.
Ai promovon përgjegjshmëri ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre, duke identifikuar dobësitë dhe devijimet nga

ligjet dhe rregulloret, si dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm.
Mashtrimi dhe korrupsioni, për shkak të natyrës së tyre, përmbajnë elementë që janë në kundërshtim me transparencën, përgjegjshmërinë dhe administrimin e mirë.
Auditimi ka përfshirë veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, menaxhimin financiar dhe kontrollin, hartimi e zbatimi i buxhetit, auditimin e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu auditimi ka përfshirë edhe zbatimin e procedurave të prokurimit, zbatimin e kontratave të punimeve, si dhe zbatimin e detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për te dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Librazhd.
**Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes:**
Strukturat drejtuese të Bashkisë Librazhd janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe në të njëjtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të Bashkisë Librazhd, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin e Buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin e Prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
**Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e auditimit**
Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:
-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
-ISSAI 200 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve IFAC,
-Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,
-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar",
-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),
-Në praktikat më të mira të fushës,
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.10 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",
-Ligji nr. 9228, datë 29.04.04 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar,
-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.11 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik".

-UMF nr. 14, datë 28.12.06, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre" i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.07.
-Ligjin nr. 139/15 dt. 17.12.15 "Për vetëqeverisjen vendore".

**Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare:**

Administratori i Përgjithshëm (Nëpunësi autorizues) z. Kastriot Gurra - Kryetar i Bashkisë Librazhd dhe (Nëpunësi zbatues) znj. Afërdita Alla – Drejtore e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Administratori i përgjithshëm dhe Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Librazhd.

Bazuar në pikën 6 e nenit 34, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 "Për vetëqeverisjen vendore", ku thuhet se: "Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore".

Neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
b)vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

Neni 65; "Administrata e njësisë administrative", pika 1. "Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori".

**Përgjegjësitë e audituesve të KLSH për auditimin e pasqyrave financiare:**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Librazhd dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryeje auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

**Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:**

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

*Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:*

**Përkatësia:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

**Saktësia:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
**Periudha:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
**Klasifikimi:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
**Ligjshmëria dhe rregullsia:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion
*Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës*
**Ekzistenca:** asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë
**Të drejtat dhe detyrimet:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
**Plotësia:** Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
**Vlerësimi dhe alokimi:** Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.
*Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese*
**Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
**Plotësia:** Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
**Klasifikimi dhe kuptueshmëria:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
**Saktësia dhe vlerësimi:** Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.
**Kriteret e vlerësimit**. Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:
-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
-ISSAI 0 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve IFAC,
-Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,
-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar",
-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),
-Në praktikat më të mira të fushës,
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.10 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",
-Ligji nr. 9228, datë 29.04.04 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar,
-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.11 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik".
-UMF nr. 14, datë 28.12.06, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre" i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.07.
-Ligjin nr. 139/15 dt. 17.12.15 "Për vetëqeverisjen vendore".

**Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin.**
Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.
Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, për vitin 16, në shumën 10,990 mijë lekë, për vitin 2017 vlerën 14,501 mije lekë dhe për vitin 18, 9 mujori në shumën 18,836 mijë lekë, dhe për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.
**Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:**

1. **Kontrolli aritmetik.** Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
2. **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese**. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.11 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
3. **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese**. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
4. **Kontrolli i vlerësimit.** Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
5. **Konfirmim nga të tretët**, Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
6. **Kontrolli sipas një treguesi**. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

## III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

**Informacioni i Përgjithshëm:**

Bashkia Librazhdi kufizohet në veri me Bashkinë Bulqizë, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Përrenjas dhe në perëndim me Bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Librazhdit.

Sipas Censusit të vitit 2011, Librazhdi ka një popullsi prej 31,892 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 44,181 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 793.36 km2. Sipas regjistrit civil, densiteti i popullsisë është 55.68 banorë/km2 sipas ndërsa sipas censusit, densiteti është 40 banorë/km2.

Kjo bashki përbëhet nga 7 njësi administrative, të cilat janë: Librazhd, Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Stëblevë, Polis dhe Orenjë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 52 fshatra.

Bashkia e re e Librazhdit ka potencial për zhvillimin e turizmit malor, por një gjë e tillë ka qenë jashtë vëmendjes së drejtuesve vendorë deri më sot. Mbrojtja e parkut kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe përfshirja e tij në guidat e turizmit malor në vend do të krijonte një perspektivë të re zhvillimi për Librazhdin dhe banorët e këtyre zonave.

Paralelisht me resurset natyrore, zona e Librazhdit shquhet për folklorin e pasur, kostumet popullore të veçanta dhe zanatin e ndërtimit të shtëpive. Kjo zonë ka kultivuar gjithashtu mjeshtërinë e përpunimit të gurit dhe të drurit.

**Misioni** për **njësinë që auditohet** është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).*

**Objektivat** burojnë nga ligji "Për vetëqeverisjen vendore".

*Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni* ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

*Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet*: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

**A- PLANIFIKIMI DHE IDENTIFIKIMI I RISKUT; STRATEGJIA DHE VLERËSIMI I RISKUT; EKZEKUTIMI I PROCEDURAVE TË TESTIMIT; PËRGATITJA E DOKUMENTEVE STANDARDE TË AUDITIMIT DHE KOMUNIKIMI I TYRE NË MËNYRË TË VAZHDUESHME ME SUBJEKTIN E AUDITUAR.**

**Gjetja 1- Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.**

| | |
|---|---|
| **Situata** | Në Bashkinë Librazhd për periudhën objekt auditimi, rezulton se sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, kuptohen deri në një farë mase. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel të moderuar të riskut lidhur sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nga ku rezultoi se:<br>*<u>Në lidhje me mjedisin e kontrollit.</u>* Është hartuar Rregullorja e funksionimit të Njësisë, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh.<br>*<u>Në lidhje me menaxhimin e riskut:</u>* Është ngritur dhe ka vepruar grupi GMS. Nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut sipas nenit 21. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.<br>*<u>-Në lidhje me informacionin dhe komunikimin:</u>* Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohej me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.<br>Nuk është bërë i plotë sistemi i vetvlerësimit.<br>Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk është plotësuar me numrin e punonjësve sipas organikës së miratuar, nuk ka bërë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, nuk ka bërë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe kryerjen e procesit të kontrollit të cilësisë për çdo auditim. |
| **Kriteri** | Ligji nr. 10296, datë 8.7.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” |
| **Impakti** | Sistem jo funksional i kontrollit, mungesa të disipines financiare në fushën e MFK. |
| **Shkaku** | Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të |

| | |
|---|---|
| | sistemeve të kontrollit të brendshëm |
| **Rëndësia** | I lartë. |
| **Rekomandimi:** | Nga Bashkia Librazhd, nëpërmjet Nëpunësit Autorizues, të merren masa për njohjen nga menaxhimi dhe stafi i MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve e përcaktim të kordinatorit të riskut me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. |
| **Afati për zbatim** | Menjëherë dhe në vazhdimësi |

**A/3.2. AUDITIM MBI ORGANIZIMIN, MBAJTJEN E KONTABILITETIT, HARTIMIN DHE SAKTËSINË E VEPRIMEVE RREGULLUESE DHE MBYLLËSE PËR PARAQITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE.**

**Gjetje nr.2: Llogaria 210 "Toka, troje, terrene"**

| | |
|---|---|
| **Situata** | ***Llogaria 210*** "Toka, troje, terrene", sipas të dhënave të pasqyrave financiare, në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën **2,882,715** lekë. Krahasuar me vitin 16 ka shtesë në zërin "Toka, troje terrene" në vlerën **2,261,693 lekë**. Kjo shtesë ka të bëjë me investime në varrezat e reja publike të qytetit me emërtimin "Varrezat e fushës së Manes", në vlerën 2,261,693 lekë, investim i përfunduar dhe i marrë në dorëzim gjatë vitit 2017. **Vlera prej 621,522 lekë** (e përbërë nga 144,650 lekë vlera e truallit të varrezave të vjetra të qytetit, dhe 476,872 lekë vlera e trashëguar nga ish komuna Qendër, sot NJA e Bashkisë Librazhd , për prita lumore e mbrojtje tokash) është gjendje në fund të 16..<br>***Nga shuma 621,522 lekë gjendje e llogarisë në fund të vitit 16, nuk është riregjistruar në ZVRPP "Prita lumore" e trashëguar nga ish komuna Qendër, ndërsa në kontabilitet ka vlerën 476,872 lekë.*** |
| **Kriteri** | UMF nr. 14, datë 28.12.06, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre", ndryshuar, dhe me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.06 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël". |
| **Impakti** | Rritja e vlerës së aktiveve në kontabilitet pa u regjistruar në ZVRPP. |
| **Shkaku** | Moszbatimi i akteve nënligjore. |
| **Rëndësia** | **E lartë** |
| **Rekomandimi:** | Nga Bashkia Librazhd të merren masa për inventarizimin e këtyre aktiveve, plotësimi i dosjes me dokumentet ligjore dhe regjistrimi i tyre ne ZVRPP Librazhd. |
| **Afati** për zbatim | **Menjëherë** |

**Gjetje nr.3: Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione"**

| | |
|---|---|
| **Situata** | ***Llogaria 211*** "Pyje, kullota, plantacione" paraqitet në vlerën 4,662,464 lekë dhe i përket ish komunës Hotolisht. Kjo llogari nuk ka pësuar ndryshime krahasuar me vitin 16. Konstatohet se vlera e objekteve të kontabilizuar nuk është regjistruar në ZVRPP. Për këto objekte janë hartuar listat por këto pasuri nuk janë të hipotekuara.<br>Konstatohet se nuk është kryer regjistrimi i pronave në ZVRPP në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi VKM nr. 510, datë 10.6.15 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme" që janë vënë në dispozicion të Bashkisë Librazhd dhe njësive administrative. |
| **Kriteri** | UMF nr. 14, datë 28.12.06, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre", ndryshuar, dhe me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.06 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël". |
| **Impakti** | Rritja e vlerës së aktiveve në kontabilitet pa u regjistruar në ZVRPP. |
| **Shkaku** | Moszbatimi i akteve nënligjore. |
| **Rëndësia** | E lartë |
| **Rekomandimi:** | Nga Bashkia Librazhd të merren masa për inventarizimin e këtyre aktiveve, plotësimi i dosjes me dokumentet ligjore dhe regjistrimi i tyre ne ZVRPP Librazhd. |
| **Afati** për zbatim | Menjëherë |

**Gjetje nr.4: Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione"**

| | |
|---|---|
| **Situata** | **Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione"** është në vlerën 557,525,466 lekë dhe përbehet nga 111 ndërtesa.<br>Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të Bashkisë Librazhd vlera e llogarisë "Ndërtime e konstruksione" në fund të vitit 2017 është 557,525,466 lekë. Krahasuar me vitin 16 kemi një shtesë prej **15,544,739** lekë.<br>Në debi të kësaj llogarie janë kontabilizuar shpenzimet për investime të Bashkisë Librazhd gjate vitit 2017.<br>Kjo shtese ka ardhur si rezultat i shtimit të vlerës se disa objekteve nga investimet e kryera në objekte. Objektet apo ndërtesat të cilave u është rritur vlera si rezultat i investimeve gjate viti 2017 janë si me poshtë :<br>- Sistemim i shpenzimeve ne proces "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Gurakuq Rinas", në vlerën 10,246,210 lekë;<br>– Sistemim veprimi për sa likuiduar investimi i prapambetur i ish Komunës Qendër "Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Babje", me urdhër shpenzimin nr.254, datë 5.05.17, në vlerën 1,224,528 lekë;<br>– Rikonstruksion i lapidareve në territorin e Bashkisë, në vlerën 897,102 lekë;<br>– Investime në objektet arsimore "Ndërtim i një shkolle me dy |

klasa, lagja Xhami” dhe “Ndërtim i kopshtit në fshatin Kokreve”, investim i përfunduar në vlerën 2,714,907 lekë;

– “Investimi shtese shkolla Zdrajsh”, në vlerën 661,386 lekë;

– “Ndërtim muri mbajtës shkolla Gurakuq, Njësia Administrative Orenje”, në vlerën 524,080 lekë;

– Sistemim veprimi për sa paguar kolaudim për objektin “Rikonstruksion i kopshtit nr.2 " Librazhd”, në vlerën 12,000 lekë;

– Pakësim në vlerën 744,474 për objektin e Bashkisë Librazhd si 5% i ngurtësuar për investimin në Bashki.

Nga auditimi rezultoi se në rregjistrin e aktiveve të cilat janë inventarizuar në fund të vitit rezultoi se janë regjistruar si pasuri dhe janë pajisur me certifikatë pronësie vetëm ndërtesat në territorin e ish Bashkisë Librazhd, përkatësisht 22 ndërtesa me një vlerë në kontabilitet prej 161,220,267 lekë. Ndërsa për 89 ndërtesa qe ndodhen ne territorin e ish komunave qe i janë bashkuar Bashkisë Librazhd në kuadrin e reformës territoriale dhe qe janë përfshirë në kontabilitet me një vlere prej 396,323,199 lekë, nuk është bere regjistrimi i tyre si pasuri e Bashkisë Librazhd .

**Kriteri** UMF nr. 14, datë 28.12.06, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre”, ndryshuar, dhe me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.06 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

**Impakti** Rritja e vlerës së aktiveve në kontabilitet pa u regjistruar në ZVRPP.

**Shkaku** Moszbatimi i akteve nënligjore.

**Rëndësia** **E lartë**

**Rekomandimi:** Nga Bashkia Librazhd të merren masa për inventarizimin e këtyre aktiveve, plotësimi i dosjes me dokumentet ligjore dhe regjistrimi i tyre ne ZVRPP Librazhd.

**Afati** për zbatim **Menjëherë**

**Gjetje nr.5 Llogaria 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”**

**Situata** ***- Llogaria 213*** *“Rrugë, rrjete vepra ujore”*

Vlera e llogarisë 213, sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Librazhd, në fund të vitit 2017 është 1,958,871,679 lekë. Krahasuar me vitin 16 kemi një shtesë në vlerë të kësaj llogarie **prej 677,009,852 lekësh** si rezultat i investimeve të kryera nga Bashkia Librazhd gjate vitit 2017 në shumën **80,019,117 lekë**, në rrugë, rrjete e vepra ujore si dhe si rezultat i transferimit kapital pa pagesë të kanaleve vaditëse nga Drejtoria Rajonale e Ujitjes dhe Kullimit Korçë. Shtesat e kësaj llogarie gjatë vitit 2017 janë në vlerën **596,990,736 lekë**.

Lista e objekteve të ardhura nga Drejtoria Rajonale e Kullimit Korçe për rrjete vepra ujore kanë vlere fillestare, por këto objekte nuk janë hipotekuar, regjistrimi i tyre në kontabilitet është kryer sipas proces-verbalit datë 18.12.16, “Mbi gjendjen aktuale për transferimin e infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit” të mbajtur nga komisionet përkatëse të Bordit Rajonal të Kullimit Korçë dhe Bashkisë Librazhd,

| | |
|---|---|
| | me nr. prot 1528, datë 16.03.17. ***Nga ana e Bashkisë Librazhd janë bërë hyrje asetet sipas proces-verbalit me F.H.nr.31, datë 18.04.17 dhe kontabilizimi i tyre pa u regjistruar në ZVRPP.*** |
| **Kriteri** | UMF nr. 14, datë 28.12.06, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre", ndryshuar, dhe me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.06 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël". |
| **Impakti** | Rritja e vlerës së aktiveve në kontabilitet pa u regjistruar në ZVRPP. |
| **Shkaku** | Moszbatimi i akteve nënligjore. |
| **Rëndësia** | **E lartë** |
| **Rekomandimi:** | Nga Bashkia Librazhd të merren masa për inventarizimin e këtyre aktiveve, plotësimi i dosjes me dokumentet ligjore dhe regjistrimi i tyre ne ZVRPP Librazhd. |
| **Afati** për zbatim | **Menjëherë** |

**AKTIVET QARKULLUESE**

KLSH konstatoi se vlera e aktiveve qarkulluese sipas pasqyrave financiare të paraqitura nga Bashkia Librazhd më datë 31.12.17, paraqitet në vlerën 738,088,9 lekë. Nga auditimi i këtyre llogarive u konstatua se: nuk janë përfshire në bilancet e viteve 2016-2017 detyrimet e pa likuiduara për vendimet gjyqësore në **vlerën 9,094,562 lekë.**
(Më hollësisht trajtuar **Aneksi nr. A,** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit).

**Gjetje nr.6** **Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"**

| | |
|---|---|
| **Situata** | Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Librazhd gjendja e debitorëve ne fund te vitit 2017 është 75,553,179 lekë..<br>Konstatohet se nuk janë përfshire në bilancet e viteve 2016-2017 detyrimet e pa likuiduara për vendimet gjyqësore në **vlerën 9,094,562 lekë.**<br>Gjatë vitit 2017-2018 janë likuiduar për shlyerjen e detyrimeve të lindura nga vendimet gjyqësorë të formës prerë **6,883,329 lekë**, pavarësisht se nuk janë përfshirë në bilancin e viteve të mësipërme. Vlera e detyrime për vendimet gjyqësore të formës se prerë me datë 31.12.18 është 22,656,907 lekë, vlerë e cila duhet të përfshihet ne bilancin e vitit 2018. |
| **Kriteri** | UMF nr. 14, datë 28.12.06, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 06, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre", ndryshuar, dhe me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.06 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël". |
| **Impakti** | Mos pasqyrimi i detyrimeve në pasqyrat financiare. |
| **Shkaku** | Moszbatimi i akteve nënligjore. |
| **Rëndësia** | **I mesëm** |
| **Rekomandimi:** | Nga ana e Bashkisë Librazhd, të merren masa që të përfshihet vlera e detyrimeve për vendimet gjyqësore të formës së prerë në shumën 22,656,907 lekë ne bilancin e vitit 2018. |
| **Afati** për zbatim | **Menjëherë.** |

**Komente nga subjekti i audituar të ardhur me shkresën nr.1857/1, datë 26.04.2019, e protokolluar në KLSH me numër 1433/3, datë 21.05.2019**: "*Në lidhje me Akt Konstatimin nr. 6, datë 28.02.2019 dërguar me shkresë nr.1427, datë 07.03.2019, thuhet se: te gjitha objektet e konstatuara nga ana juaj si te pa rregjistruara ne ZVRPP, jane objekete te trasheguara nga ish Komunat ,ne kuadrin e reformes territoriale sipas ligjit 115/2014 " per ndarjen adminstrativo –territoriale te njesive te Qeverisjes Vendore .Keto objekte kane qene te pasqyruara ne pasqyrat financiare individuale te sejciles Komune dhe nga ana e Bashkise Librazhd ne perputhje me VKM nr.510,date 10.06.2015 ,kreu I pika 5:" Per miratimin e procedurave per transferimin e te drejtave dhe detyrimeve ,persioneli,aktiveve te trupezuara dhe te pa trupezuara,te arkivave dhe cdo dokumentacioni tjeter zyrtar ne Njesite e qeverisjes vendore te prekura nga riorganizimi administrative-territorial " ,eshte bere hartimi i pasqyrave financiare te konsoliduara.*
*Ne perputhje me kreun IV , pika 2 te ketij vendimi nga ana e Njesive te shkrira eshte depozituar inventari i te gjitha pronave te pa luajtshme dhe te luajtshme sipas pasqyrave financiare te pa shoqeruara me certifikata pronesie .*
*Ne kreun VII ,pika 2 te ketij Vendimi kerkohet intergrimi i paqsyrave financiare te Njesive te shkrira me pasqyrat e veta te Bashkise dhe ne perfundim te vitit ushtrimor pregatitet bilanci i konsoliduar duke perfunduar keshtu bashkimin financiar te bashkise gje e cila eshte bere nga ana jone.*
*I njejti konstatim eshte edhe per listen e objekteve te ardhura nga Drejtoria Rajonale e Kullimit Korce per kanalet vaditese qe i transferohen Bashkise Librazhd ku permendet qe eshte bere kontabilizimi i tyre pa u rregjistruar ne ZVRPP.*
*Persa I perket rregjistrimit te pronave nuk eshte koompetence e Drejtorise se Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.*
*Nisur nga konstatimi juaj nga ana jone eshte informuar Kryetari i Bashkise per marrjen e masave dhe ngritjen e struktures perkatese per asetet dhe rregjistrimin e tyre".*
**Përgjigje e grupit të auditimit:** Sa më sipër kundërshtimet tuaja nuk merren në konsideratë pasi është përcaktim ligjorë që asetet të cilat paraqiten në pasqyrat finaciare duhet të jenë të rregjistruara në ZVRPP dhe në kontabilitet.

## B. MBI PLANIFIKIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË BUXHETIT, BAZUAR NË LIGJIN ORGANIK TË BUXHETIT DHE NË LIGJIN NR. 130/2016, DATË 17.12.2016 "PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2017", ME NDRYSHIMET E TIJ, LIGJI NR. 109/2017, DATË 30.11.2017 "PËR BUXHETIN E VITIT 2018".

Për periudhën objekt auditimi, titullari i Bashkisë me urdhra të veçantë ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për strategji, buxhet dhe integrim (GSBI). Tavanet e parashikuar për fazën e parë, janë miratuar me VKB dhe rezulton se ato rezultojnë me rritje të fondeve buxhetore. Miratimi i ndryshimeve të buxhetit të Bashkisë, është bërë me VKB, rezultoi se për vitin 2016 nuk ka shtesë buxheti, ndërsa për vitin 2017, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se ky buxhet fillestar është ndryshuar duke u rritur për 9,831 mijë lekë dhe për vitin 2018, buxheti fillestar është ndryshuar duke u rritur për 13,604 mijë lekë.
Miratimi i buxhetit për vitet 2016 është bërë me VKB nr.34, datë 22.01. 2016 dhe 2017 me VKB nr.14, datë 25.01.2017, është bërë jashtë afatit ligjor në kundërshtim me kërkesat ligjore.
Për vitin 2016, tavani i parashikuar për fazën e parë paraqitet në shumën 432,745 mijë lekë i miratuar me VKB nr. 68 datë 28.05.2015, ku 92,687 mijë lekë janë miratuar për buxhetin vendor dhe 340,158 mijë lekë janë miratuar si shpenzime nga fondet e deleguara, me

shkresën nr. 257, datë 28.10.2015, titullari i Bashkisë ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për strategji, buxhet dhe integrim(GSBI).
Për vitin 2017, tavani i parashikuar për fazën e parë paraqitet në shumën 846,672 mijë lekë i miratuar me VKB nr. 31, datë 23.05.2016 , ku 254,817 mijë lekë janë miratuar për buxhetin vendor dhe 591,655 mijë lekë janë miratuar si shpenzime nga fondet e deleguara, me shkresën nr. 561, datë 31.10.2016, titullari i Bashkisë ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për strategji, buxhet dhe integrim (GSBI).
Për vitin 2018, tavani i parashikuar për fazën e parë paraqitet në shumën 1,176,321 mijë lekë i miratuar me VKB nr. 68 datë 21.07.2017, ku 488,483 mijë lekë janë miratuar për buxhetin vendor dhe 687,838 mijë lekë janë miratuar si shpenzime nga fondet e deleguara, me shkresën nr. 173, datë 28.03.2017, titullari i Bashkisë ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për strategji, buxhet dhe integrim(GSBI).
Për vitin 2016, me VKB nr.34 datë 22.01.2016 është miratuar buxheti i Bashkisë në vlerën 1,462,063 mijë lekë (428,328 mijë lekë për buxhetin vendor dhe 1,033,735 mijë lekë për buxhetin e deleguar) pra rezulton me rritje krahasuar me fazën e parë që është miratuar për vlerën 432,745 mijë lekë (92,687 mijë lekë për buxhetin vendor dhe 340,158 mijë lekë për buxhetin e deleguar).
- Për vitin 2017, me VKB nr.14 datë 25.01.2017 është miratuar buxheti i Bashkisë në vlerën 1,598,484 mijë lekë (769,138 mijë lekë për buxhetin vendor dhe 829,346 mijë lekë për buxhetin e deleguar) pra rezulton me rritje krahasuar me fazën e parë që është miratuar për vlerën 846,672 mijë lekë (254,817 mijë lekë për buxhetin vendor dhe 591,655 mijë lekë për buxhetin e deleguar).
-Për vitin 2018, me VKB nr.112 datë 29.12.2017 është miratuar buxheti i Bashkisë në vlerën 1,663,229 mijë lekë (767,261 mijë lekë për buxhetin vendor dhe 895,968 mijë lekë për buxhetin e deleguar) pra rezulton me rritje krahasuar me fazën e parë që është miratuar për vlerën 1,176,321 mijë lekë (488,483 mijë lekë për buxhetin vendor dhe 687,838 mijë lekë për buxhetin e deleguar), miratimi i buxhetit për vitin 2016 dhe 2017, është bërë jashtë afatit ligjorë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.208 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 "Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore", ku përcaktohet……… Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 25 dhjetor, miraton buxhetin vendor, në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor
U konstatua se për vitet 2016, 2017 dhe 2018, miratimi i ndryshimeve të buxhetit të Bashkisë, është bërë me VKB, rezultoi se për vitin 2016 nuk ka shtesë buxheti, ndërsa për vitin 2017, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se ky buxhet fillestar është ndryshuar duke u rritur për 9,831 mijë lekë, pra plani i buxhetit përfundimtar i Bashkisë Librazhd për vitin 2017 është për vlerën 1,608.389 mijë lekë dhe për vitin 2018, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se ky buxhet fillestar është ndryshuar duke u rritur për 13,604 mijë lekë, pra plani i buxhetit përfundimtar i Bashkisë Librazhd për vitin 2017 është për vlerën 1,676,834 mijë lekë.
Për vitin 2016, treguesit e buxhetit nga 1,462,063 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt 1,004,188 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 458,000 mijë lekë ose 69%, nga të cilët peshën më të madhe e zënë shpenzimet për investime, që janë për vlerën 391,547 mijë lekë ose 85% e mosrealizimit kjo për faktin se këto fonde janë prokuruar dhe kontratat janë lidhur në fund të vitit, shpenzime për paga dhe sigurime në vlerën 30,239 mijë lekë ose 7% e mosrealizimit kjo nga mos plotësimit të organikës me punonjësit e planifikuar dhe shpenzime operative në vlerën 20,209 mijë lekë ose 4% e mosrealizimit.

Për vitin 2017, treguesit e buxhetit nga 1,608,315 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt 1,211,160 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 397,155mijë lekë ose 75.3%, nga të cilët peshën më të madhe e zënë shpenzimet për investime, që janë për vlerën 321,895 mijë lekë ose 81% e mosrealizimit kjo për faktin se këto fonde janë prokuruar dhe kontratat janë lidhur në fund të vitit, shpenzime për paga dhe sigurime në vlerën 15,918 mijë lekë ose 4% e mosrealizimit kjo nga mos plotësimit të organikës me punonjësit e planifikuar dhe shpenzime operative në vlerën 31,585 mijë lekë ose 8% e mosrealizimit, pasi nuk janë realizuar shpenzimet për lyerje shkollash dhe blerje dru zjarri.
Për vitin 2018, treguesit e buxhetit nga 1,676,833 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt 1,462,986 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 213,847 mijë lekë ose 87%, nga të cilët peshën më të madhe e zënë shpenzimet për investime, që janë për vlerën 125,641 mijë lekë ose 59% e mosrealizimit kjo për faktin se këto fonde janë prokuruar dhe kontratat janë lidhur në fund të vitit, shpenzime për paga dhe sigurime në vlerën 32,163 mijë lekë ose 15% e mosrealizimit kjo nga mos plotësimit të organikës me punonjësit e planifikuar, mos shpërndarja e fondit të veçantë dhe shpenzime operative në vlerën 36,975 mijë lekë ose 17% e mosrealizimit, pasi nuk janë realizuar shpenzimet për regjistrimin e pasurive në ZVRPP, faturat e pa likuiduara në fund të vitit si dhe shpenzimet e planifikuara për pagesa për vendime gjykate.
Nga auditimi u konstatua se në fund të vitit 2018, detyrimet e faturuara dhe të pa likuiduara për fondet e bashkisë, buxhetit të shtetit dhe të rajoneve në fund të vitit 2018 është në shumën 123,404,893 lekë (fatura 64,475,724 lekë dhe 5% të ngurtësuar 59,039,122 lekë).
Në detyrimet për fatura të pa likuiduara për vitin 2018, përfshihen:
**Detyrime te pa likuiduara nga viti 2018 për vlerën 27,503,929 lekë**, janë 18 raste faturash të ardhura nga subjektet nga datat 26, 27, 28.12.2018, për vlerën 2,084,515 lekë, 1 rast me datë 19.12.2018 në vlerën 6,282,876 lekë për investimin "Rikonstruksion dhe shtese anësore për shkollën e mesme " Isa Alla, Njësia Lunik", me burim financimi nga Fondet e Rajoneve, me dy faza financimi 2018-2019 , 1rast me datë 10.07.2018 në vlerën 8,589,932 lekë për investimin "Blerje materiale për kanalet vaditëse (tubacione), investim I parashikuar per t'u likuiduar ne dy vite 2018-2019, 1 rast me datë 1.09.2018 në vlerën 8,534,111 lekë për investimin "Rikualifikimi urban zona në hyrjen perëndimore të qytetit dhe mbrojtja lumore " për këtë Bashkia Librazhd është ne proces gjyqësore si vlerë e llogaritur si penalitete nga Bashkia , 2 raste me datë 17.12.2018 në vlerën 97,200 lekë për 2 objekte "Kolaudim objektit rikonstruksion , rrethimi I jashtëm fusha e sportit sopoti" dhe "Kolaudim punimesh për objektin rikonstruksion I kanaleve vaditëse", për keto fatura janë prerë urdhër shpenzimet për likuidim nr.1008 date 27.12.2018 dhe 1019 date 27.12.2018 , pagesa është anuluar nga dega e thesarit pasi subjekti ka mbyllur numrin e llogarisë , e vërtetuar kjo me proces-verbalin e mbajtur midis Bashkisë dhe Degës së Thesarit me datë 08.01.2019 dhe 7 raste të mbetura të pa likuiduara në vlerën 1,915,325 lekë nuk janë likuiduar pasi nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr.19932 date 7.11.2018 është vendosur limit.
**Detyrime te pa likuiduara nga viti 2017, në vlerën 1,327,167 lekë,** janë 3 raste fatura te pa likuiduara që kanë mbetur pa likuiduar pasi janë investime me burim financimi buxhetin e shtetit dhe me financim në vitin 2019.
**Detyrime te pa likuiduara nga ish Komunat 35,644,628 lekë**, ja 5 raste në vlerën 33,920,122 lekë që kanë të bëjnë me investimet e pa likuiduara të trashëguara nga ish Komunat me burim financimi Fondet e Rajoneve dhe 4 raste fatura në vlerën 1,724,506 lekë nuk janë likuiduar për efekt të parregullsive në dokumentacion .
**Detyrime për 5% të garancisë së punimeve për investime të periudhave viti 2016-2018 në vlerën 59,039,122 lekë.**

Nga auditimi u rezultoi se me buxhetin vitit 2018, janë likuiduar 37 fatura shpenzimesh për investime dhe shpenzime operative në vlerën 294,207,253 lekë, që I përkasin vitit 2017, rezultoi se mos likuidimi i tyre në vitin buxhetorë 2017 ka ardhur si rezultat i investimeve me dy faza financimi dhe vendosjes së limitit të shpenzimeve nga Ministria e Financave me shkresën nr. 15973, datë 09.11.2017, për vlerën 45,305,562 lekë kur fatura të depozituara për likuidim për muajt nëntor dhjetorë janë në vlerën 146,613,251 lekë, financimi në dy faza të investimeve nga buxheti i shtetit dhe fondet e rajoneve.
Bashkia Librazhd ka administruar 16 detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën 29,540,236 lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore. Nga shuma e mësipërme janë zbatuar (likuiduar) në vlerën 6,883,329 lekë, mbetur për likuidim të mëtejshëm në buxhetin e vitit 2019, vlera 22,656,907 lekë. Rezultoi se përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimin nr.2, datë 06.02. 2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
**Komente nga subjekti i audituar të ardhura me shkresën nr.1857/1, datë 26.04.2019, e protokolluar në KLSH me numër 1433/3, datë 21.05.2019:** *"Per mos miratimin brenda afateve ligjore ju sqarojme se, kjo nuk ka ardhur per neglizhence te Drejtorise Ekonomike ,Sektorit te buxhetit pasi ne hartimin e buxhetit eshte pjesmarres EMP dhe GSBI te cilet nuk kane dorezuar ne kohe kerkesat buxhetore vertetuar kjo me numrin dhe daten e dorezimit ne protokoll ,ne kundershtim me afatet e percaktuara ne urdherin e titullarit dhe udhezimit perkates te buxhetit. Ne momentin e venies ne dispozicion te kerkesave buxhetore dhe paraqitjes nga GMS te materialeve, nga ana jone eshte bere menjehere perpunimi i te dhenave dhe hartuar project –buxheti. Vlen te permendim qe me insistimin dhe kembenguljen e Drejtorise se Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar kjo mangesi e konstatuar ne vitet 2016 dhe 2017 eshte korigjuar per vitet 2018 -2019 duke miratuar buxhetin brenda afateve ligjore te percaktuar ne ligjin nr 9936 date 26.06.2008 " Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise*
*Ne konstatimet e nxjerra nga ne akt konstatimin nr.1 pika 7 te auditimi i Kontrollit te Larte te Shtetit citohet:"Bashkia Librazhd ka administruar 16 detyrime per zbatimin e vendimeve gjyqesore te forms se prere (vendime te mbartura dhe gjate periudhes se auditimit) ne vleren 29 540 236 leke, efekt negative ne buxhetin e njesise se vendore. Nga shuma e mesiperme jane zbatuar (likujduar) ne vleren 6 883 329 leke, mbetur per likujdim te metejshem ne buxheti e vitit 2019, vlera 22 656 907 leke.*
*Rezultoi se perpara zbatimit te vendimeve gjyqesore, nga titullari nuk jane njxerre pergjegjesite administrative dhe nuk eshte nxjerre akti qe provon gjurmen e auditimit te ketij procesi, ne kundershtim me kerkesat e pikes 62 te udhezimit nr. 2 date 06.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit".*
*Ne lidhje me konsatimin ne piken nr 7) te aktit te mesiperm ,Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar ne Bashkine Librazhd ka proceduar ne perputhje me Kodin Civil dhe nenet 510 e vijues te Kodit te Procedures Civile, si edhe ne udhezimin nr. 1 date 04.06.2014 "Per menyren e ekzekutimin e detryrimeve monetare te njesive te qeverisjes se pergjithsme ne llogari te thesarit" konkretisht: Neni 510 I k. Pr. Civile Titujt ekzekutivë, Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: v**__endimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim,__** vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;*
*Te gjitha vendimet gjyqsore e likujduara nga ana e Bashkise Librazhd sa me siper jane tituj ekzekutiv.*

*Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, Sektori I Buxhetit pas marrjes se titujve ekzekutive nga Vendimet e Gjykatave (sipas shkreses numer 6894 prot ,date 05.12.2016 te Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike per cdo rast) ka bere verifikimin dhe planifikimin e fondeve buxhetore. Me propozimin e NA eshte bere miratimi I ketyre fondeve ne keshillin Bashkiak. Eshte hartuar grafiku i shlyrjes se Vendimeve Gjyqsore nga ana e Drejtorise se Zhvillimit Ekonomik dhe miratuar tek titullari duke respektuar rrallen e pagese .*
*Ne rastet e mungeses se likujditetit nga Bashkia Librazhd eshte arritur ne nje marreveshje me palet kreditore per menyren e likujdimit me keste.*
*Pothuajse ne te 16 rastet e vendime gjyqesore te formes se prere qe duhen likujduar, nga Permbaruesit Gjyqesore eshte marre masa e sekuestros per bllokimin e llogarive bankare ne Thesarin Dega Librazhd dhe Bankave te nivelit te dyte, duke penguar keshtu mbarevajtjen e funksionimit dhe arritjen e objektiveve te Bashkise Librazhd.*
*Sa me siper, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar ka proceduar ne perputhje te plote me kudrin ligjor ne fuqi dhe zbatim te Urdherave te Titullarit te Bashkise".*
**Saqrime mbi komentet nga grupi i auditimit:**
**Së pari:** në lidhje me observimet nga ana juaj, se në hartimin e buxhetit është pjesmarrës EMP dhe GSBI të cilët nuk kanë dorëzuar në kohë kerkesat buxhetore vertetuar kjo me numrin dhe datën e dorëzimit në protokoll ,në kundërshtim me afatet e percaktuara në urdhërin e titullarit dhe udhezimit perkatës të buxhetit dhe se ato nuk kanë dorëzuar në kohë dokumentat, nuk merren ne konsiderate pasi është detyrim ligjorë që hartimi i projekt buxhetit duhet të paraqitet brenda afatit në KB për mieratim dhe Drejtoria Ekonomike është përgjegjëse për marvajtjen e këtij procesi.
**Së dyti:** në lidhje me konstatimin për pagesat vendimeve të gjykatës kemi kërkuar ytë zbatohen përcaktimet të ligjit për buxhetin dhe udhëzimit, **pasi** nga titullari nuk jane njxerre pergjegjesite administrative dhe nuk eshte nxjerre akti qe provon gjurmen e auditimit te ketij procesi, ne kundershtim me kerkesat e pikes 62 te udhezimit nr. 2 date 06.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", nuk merren në konsideratë.

**Gjetje nr.7 Faturat e pa likuiduara.**

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se në fund të vitit 2018, detyrimet e faturuara dhe të pa likuiduara për fondet e bashkisë, buxhetit të shtetit dhe të rajoneve në fund të vitit 2018 është në shumën 123,404,893 lekë (fatura 64,475,724 lekë dhe 5% të ngurtësuar 59,039,122 lekë).
Në detyrimet për fatura të pa likuiduara për vitin 2018, përfshihen:
**Detyrime te pa likuiduara nga viti 2018 për vlerën 27,503,929 lekë**, janë 18 raste faturash të ardhura nga subjektet nga datat 26, 27, 28.12.2018, për vlerën 2,084,515 lekë, 1 rast me datë 19.12.2018 në vlerën 6,282,876 lekë për investimin "Rikonstruksion dhe shtese anësore për shkollën e mesme " Isa Alla, Njësia Lunik", me burim financimi nga Fondet e Rajoneve, me dy faza financimi 2018-2019 , 1rast me datë 10.07.2018 në vlerën 8,589,932 lekë për investimin "Blerje materiale për kanalet vaditëse (tubacione), investim I parashikuar per t'u likuiduar ne dy vite 2018-2019, 1 rast me datë 1.09.2018 në vlerën 8,534,111 lekë për investimin "Rikualifikimi urban zona në hyrjen perëndimore të qytetit dhe mbrojtja lumore " për këtë Bashkia Librazhd është ne proces gjyqësore si vlerë e llogaritur si penalitete nga Bashkia , 2 raste me datë 17.12.2018 në

vlerën 97,200 lekë për 2 objekte "Kolaudim objektit rikonstruksion , rrethimi I jashtëm fusha e sportit sopoti" dhe "Kolaudim punimesh për objektin rikonstruksion I kanaleve vaditëse", për keto fatura janë prerë urdhër shpenzimet për likuidim nr.1008 date 27.12.2018 dhe 1019 date 27.12.2018 , pagesa është anuluar nga dega e thesarit pasi subjekti ka mbyllur numrin e llogarisë , e vërtetuar kjo me proces-verbalin e mbajtur midis Bashkisë dhe Degës së Thesarit me datë 08.01.2019 dhe 7 raste të mbetura të pa likuiduara në vlerën 1,915,325 lekë nuk janë likuiduar pasi nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë me shkresën nr.19932 date 7.11.2018 është vendosur limit.

**Detyrime te pa likuiduara nga viti 2017, në vlerën 1,327,167 lekë,** janë 3 raste fatura te pa likuiduara që kanë mbetur pa likuiduar pasi janë investime me burim financimi buxhetin e shtetit dhe me financim në vitin 2019.

**Detyrime te pa likuiduara nga ish Komunat 35,644,628 lekë**, ja 5 raste në vlerën 33,920,122 lekë që kanë të bëjnë me investimet e pa likuiduara të trashëguara nga ish Komunat me burim financimi Fondet e Rajoneve dhe 4 raste fatura në vlerën 1,724,506 lekë nuk janë likuiduar për efekt të parregullsive në dokumentacion .

**Detyrime për 5% të garancisë së punimeve për investime të periudhave viti 2016-2018 në vlerën 59,039,122 lekë.**

**Kriteri** -Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 – *Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*.

**Impakti** Moslikuidim në kohë i detyrimeve të prapambetura.

**Shkaku** - Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

**Rëndësia:** -I mesëm.

**Rekomandimi** Nga Bashkia Librazhd të merren masa që të zbatohen procedurat ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

**Afati për zbatim** Menjëherë

**Gjetje nr. 8 Detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.**

**Situata** Bashkia Librazhd ka administruar 16 detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit) në vlerën **29,540,236 lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore,** nga të cilat, katër raste për "detyrim kontrate" fatura të pa likuiduara në vlerën 6,428,031 lekë, nga ish Komunat, tetë raste për largime të pa drejta nga puna në vlerën 6,319,662 lekë, katër raste për dëm pasuror në vlerën 16,792,533 lekë. Nga shuma e mësipërme janë zbatuar (likuiduar) në vlerën **6,883,329 lekë**, mbetur për likuidim të mëtejshëm në buxhetin e vitit 2019 **vlera 22,656,907 lekë**.

**Kriteri** -Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
-Udhëzimi nr.2, datë 06.02. 2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". pikës 62.

**Impakti** -Efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore, nga zbatimi i vendimeve gjyqësore

| | |
|---|---|
| | të formës së prerë, vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit, në vlerën 29,540,236 lekë. |
| **Shkaku** | - Mos zbatimi i kërkesave ligjore. |
| **Rëndësia** | **I lartë** |
| **Rekomandimi:** | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që të zbatohen procedurat ligjore për nxjerrjen e përgjegjësisë administrative. |
| **Afati** për zbatim | **Menjëherë** |

*Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi: Afërdita Alla me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe znj. Brikena Agastra me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit për periudhën e auditimit.*

**B.1.4 "Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe njësive të varësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre në Bashkinë Librazhd**

Paketat fiskale për vitin 2016 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr.21, datë 23.12.2015, për vitin 2017 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 100, datë 15.12.2016 dhe për vitin 2018 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 109, datë 12.12.2017.
Për vitin 2016, kanë ushtruar aktivitet 652 subjekte *(544 subjekte të biznesit të vogël, 108 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera institucione),* për vitin 2017, kanë ushtruar aktivitet 653 subjekte *(542 subjekte të biznesit të vogël, 111subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera institucione)* dhe për vitin 2018, kanë ushtruar aktivitet 719 subjekte *(580 subjekte të biznesit të vogël, 139 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera institucione),*

| Lloji Biznesit | Viti 2016 | | | | Viti 2017 | | | | Viti 2018 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjendja fillim | Biznese të reja | Biznese të mbyllur | Gjendja në fund | Gjendja fillim | Biznese të reja | Biznese të mbyllur | Gjendja në fund | Gjendja fillim | Biznese të reja | Biznese të mbyllur | Gjendja në fund |
| B. Vogël | 524 | 60 | 40 | 544 | 544 | 36 | 38 | 542 | 542 | 72 | 34 | 580 |
| B. Madh | 91 | 6 | 5 | 92 | 92 | 9 | 6 | 95 | 95 | 17 | 3 | 109 |
| Instituci | 16 | 0 | 0 | 16 | 16 | 0 | 0 | 16 | 16 | 14 | 0 | 30 |
| **Gjithsej** | **631** | **66** | **45** | **652** | **652** | **45** | **44** | **653** | **653** | **103** | **37** | **719** |

Plani i të ardhurave për vitin 2016, nga 80,450 mijë lekë të parashikuara, është realizuar në vlerën 81,020 mijë lekë ose 107 %, me një tejkalim në vlerën 570 mijë lekë.
Për vitin 2017, nga 107,070 mijë lekë të parashikuara, është realizuar në vlerën 97,476 mijë lekë ose 91 %, me një mos realizim në vlerën 9 594 mijë lekë.
Për vitin 2018, nga 113,951 mijë lekë të parashikuara, është realizuar në vlerën 107,456 mijë lekë ose 94.3 %, me një mos realizim në vlerën 6 495 mijë lekë. **Më hollësisht trajtuar ne ANEKS B/1.**
Nga auditimi rezultuan gjetjet sa vijon:

**Gjetje nr.9: KLSH konstatoi se** Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Taksave, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për

objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Librazhd, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 6,368,160 lekë**.**

| | |
|---|---|
| **Situata** | **Të ardhurat nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga legalizimet**, nga të dhënat që disponon Sektori i Taksave, Bashkia Librazhd në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Librazhd ka dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP Librazhd.<br>Konkretisht për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2018, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **188 persona** me vlerë **6,368,160 lekë**, **e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd,** sipas listës së bashkangjitur këtij akt konstatimi. Trajtuar analitikisht në aneksin nr.21/B, bashkëlidhur. |
| **Kriteri** | VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5 dhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë,* pika 2/1. |
| **Impakti** | Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd në shumën **6,368,160 lekë.** |
| **Shkaku** | Mos rakordimi i punës midis ALUIZNI-t dhe Bashkisë Librazhd. |
| **Rëndësia** | **I mesëm** |
| **Rekoman dimi:** | Bashkia Librazhd, nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Sektorit të Taksave në bashkëpunim me ALUIZNI-n Librazhd dhe ZVRPP Librazhd të merren masa të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së infrastrukturës në vlerën **6,368,160 lekë**, sipas listave të debitorëve bashkëlidhur në Aneksin nr.21 të Projekt Raportit të Auditimit. |
| **Afati** për zbatim | **Menjëherë** |

**Gjetje nr.10: KLSH konstatoi se** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e debitorëve të biznesit në vlerën **26,214,306 lekë** dhe debitorëve familjarë në vlerën 39,016,000 lekë.

| | |
|---|---|
| **Situata** | Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej **debitorë 520 subjekte për vlerën 26,214,306 lekë** dhe debitorë familjarë **4921 familje për vlerën gjithsej 39,016,000 lekë.**<br>-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve.<br>Në verifikimin e listave të subjekteve debitorë në vite, konstatohen subjekte aktiv dhe me detyrime. Kështu sipas të dhënave kemi 480 subjekte aktiv me detyrime, e barabartë me 92.3% të numrit total të subjekteve 520 gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të Sektorit të |

| | |
|---|---|
| | Taksave në arkëtimin e detyrimeve debitorë. |
| **Kriteri** | Kreu XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet. |
| **Impakti** | Mos realizimi i të ardhurave. |
| **Shkaku** | Mos ndjekja e procedurave ligjore |
| **Rëndësia** | **I mesëm** |
| **Rekomandimi** | Bashkia Librazhd, nëpërmjet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Taksave të marrë masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore të pa arkëtuara në vlerën **26,214,306 lekë** për sektorin e biznesit dhe të vlerës **39,016,000** lekë nga familjarët, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar. Sa sipër, bazuar në nenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar, nga Drejtoria e Taksave të nxirren njoftim vlerësimet tatimore dhe për arkëtimin e detyrimeve të mësipërme të ndiqen rrugët e mëposhtme:<br>a) T'u ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (Në rast mos kryerjes të urdhër bllokimeve prej bankave të njoftohet Guvernatori i Bankës Shqipërisë).<br>b) T'i ridërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.<br>c) Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të fillojë llogaritja e gjobës në masën 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë " të ndryshuar, me ligjin nr.164/2014, datë 15.12.2014.<br>ç) Në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet e akumuluara në vite, nga ana e Bashkisë (Sektori i të Ardhurave dhe Sektori Juridike) të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të Republikën e Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.<br>d) Sektori e Taksave në Bashkinë Librazhd të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve, taksës së tokës nga fermerët e Njësive Administrative. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifat etj. |

| | |
|---|---|
| **Afati** për zbatim | **Menjëherë** |

*Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi: Sh.Z. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Tatim Taksave për periudhën 01.01.2016 deri më 19.06.2018, larguar nga Bashkia dhe L.S. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Tatim Taksave për periudhën 19.06.2018 deri me 31.12.2018.*

**Komente nga subjekti i audituar të ardhura me shkresën nr.1857/1, datë 26.04.2019, e protokolluar në KLSH me numër 1433/3, datë 21.05.2019:** *"Thuhet se: Ne piken " Taksa e ndikimit ne infrastrukture dhe legalizimet " veprimet jane ne kundershtim me VKM nr. 860 date 10.12.2014 , pika " 5"*
*Per objektet qe legalizohen arketimet per taksen e infrastructures behen vetem kur paraqiten vete qytetaret , ne nuk I detyrojme , pasi ligji detyron ZVRPP ( hipoteken ) qe te mos jepet certifikata e pronesise pa u paguar taksa e infrastruktures .*
*Ne lidhje me njoftime te subjekteve per debitoret per periudhen qe une kam filluar detyren nga data 19.06.2018 kam derguar njoftime per pagese bllokime dhe mase sigurie 454 njoftime . ku totali I vitit 2018 eshte 454 . te gjitha njoftimet jane derguar nga ana ime .*
*Per debitoret jane sistemuar progresive nga viti 2011 deri 2018 gje te cilen nuk ishte bere me pare" .*

**Sqarime mbi komentet nga grupi i auditimit:**

Sa më sipër në lidhje me atë që pagesat për lejet e legalizimeve bëhen vetëm atëhere kur paraqiten qytetarët dhe se ligji detyron ZVRPP që të mos bëjë rregjistrim dhe se nga ana juaj janë dërguar 454 njoftime për bllokim llogarish, ju sqarojmë se në akt konstatim kemi thekduar se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27 dhe nuk ka asnjë rast ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet, përsa më sipër kundërshtimet tuaja nga grupi i auditimit nuk merren në konsideratë.

### B.1.4 - Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kontratat e qirave për shfrytëzim të fondit pyjorë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre.

Bashkisë Librazhd me VKM nr.433, datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive", i janë kaluar në pronësi sipërfaqe gjithsej 33,084.6 ha, nga këto 18,517.5 ha pyje, 8,519.1 ha kullotë, 2,646.7 ha toka joproduktive, 3,400.8 ha djerr dhe 0.5 ha ujore.

**Gjetje nr. 11:**

| | |
|---|---|
| **Situata** | Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se: janë lidhur kontrata për dhënie në përdorim të fondit pyjorë gjithsej 21 (shtatë |

kontrata janë lidhur nga ish-Komunat dhe 14 kontrata janë lidhur në periudhën 2016-2018), nga të dhënat e Drejtorisë së Financës rezulton se nuk kanë paguar detyrimet e kontratës në vlerën ***2,465,694 lekë, që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd***, subjektet sipas pasqyrës si më poshtë:

| Nr | Subjekti | Kontrata | | Siperfaqe ha | Gjatësia km | Vlera e pa likuiduar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr | Datë | | | |
| 1 | D. E. | 9 | 07.01.2015 | | 1,1 | 339,300 |
| 2 | Hec. D. | 1/1 | 07.01.2014 | 5,2 | 1,87 | 1,421,733 |
| 3 | E. | 6078 | 18.10.2017 | | 2.34 | 359,500 |
| 4 | B.G.E. | | | | 2,2 | 345,161 |
| **Totali** | | | | | | **2,465,694** |

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Librazhd, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e lidhura me subjektet për shfrytëzimin e sipërfaqeve për ndërtimin e HECEVE, **për vlerën 2,465,694 lekë, që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.**

**Kriteri** Veprim në kundërshtim me nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin" dhe kushtet e kontratave.

**Impakti** Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd për vlerën 2,465,694 lekë.

**Shkaku** Moszbatim i procedurave për arkëtimin e detyrimeve kontraktuale.

**Rëndësia** **I mesëm**

**Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **2,465,694 lekë,** nga 4 subjektet.

**Afati** për zbatim **Menjëherë**

**Gjetje nr.12: KLSH konstatoi se** nga të dhënat e afishuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për Bashkinë Librazhd, në zonën Pyjore e kullosore pronë aset i kësaj bashkie kanë marrë leje e kryejnë aktivitet shfrytëzim karriere subjekte për nxjerrje gurë gëlqerorë mineral etj, **me sipërfaqe 512 ha.**

**Situata** Agjencia e Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Librazhd, për subjektet të cilat nga MIE kanë marrë leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore dhe kullosore nuk ka zbatuar kërkesat ligjore, për lidhjen e kontratave për shfrytëzim të fondit pyjor nga subjekte të ndryshme **me sipërfaqe 512 ha**, për realizimin e të ardhurave për buxhetin e Bashkisë.

**Kriteri** Moszbatim i kërkesave të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të pikës 6 neni 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor", me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 "Për rregullat dhe procedurat që

ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, nuk ka njoftuar subjektet për t`u paraqitur për lidhjen e kontratave për të ushtruar këtë aktivitet dhe likuidimin e detyrimeve që lindin nga zbatimi i VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", sipas lidhjes nr. 2

**Impakti** Mosdhënia në përdorim e sipërfaqes prej 512 ha për realizimin e të ardhurave për buxhetin e Bashkisë.

**Shkaku** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të sipërpërmendura.

**Rëndësia** **I mesëm**

**Rekomandimi:** Agjencia e Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Librazhd, t'i kërkojë Ministrisë Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

**Afati** për zbatim **Menjëherë**

*Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi: Q.F. me detyrë Drejtor i Agjencisë së Pyjeve dhe Kullotave, për periudhën e auditimit.*

**C. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017.**

***C/1- Regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve.***

Nga ana e AK është hartuar lista e parashikimit të prokurimeve dhe është dorëzuar në kohë. Vlerat e prokuruar janë në përputhje me buxhetin dhe të mbështetura plotësisht me fonde buxhetore. Regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve, janë hartuar në mbështetje të kërkesave të ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" dhe janë dërguar në APP e në degën e thesarit sipas kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr.139/2018, "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe vendimet e këshillimit bashkiak, ato janë dërguar në përputhje me kërkesat e LPP, sa vijon:

| Vitet | Regjistri i: | | | | Shtesa në regjistër | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | parashikimit | | realizimit | | | |
| | nr. | datë | nr. | datë | nr. | datë |
| Viti 2016 | 525 | 08.02.16 | 318 | 19.01.17 | 1512 | 08.04.16 |
| | | | | | 6072 | 25.10.16 |
| | | | | | 6592 | 15.11.16 |
| | | | | | 6712 | 23.11.16 |
| | | | | | 6958/1 | 07.12.16 |
| | | | | | 7208 | 19.12.16 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 7372 | 29.12.16 |
| **Viti 2017** | 178 | 13.01.17 | 325 | 19.01.18 | 1348 | 07.03.17 |
| | 868 | 10.02.17 | | | 2585 | 08.05.17 |
| **Viti 2018** | 1239 | 07.03.18 | 51 | 07.01.19 | 4562 | 11.09.18 |
| | | | | | 2062 | 23.04.18 |

Ndryshimet në regjistrin e parashikimit të prokurimeve rezultuan të mbështetura me fonde buxhetore përkatëse përpara se të bëhej ndryshimi përkatës. Në të gjitha rastet është vepruar sipas ligjit dhe akteve nënligjore për njoftimet në APP.
Konkretisht për vitin 2016 janë shtuar 37 procedura prokurimi me vlerë 449,356,898 lekë. Theksojmë se vlera prej 193,564,393 lekë ose 13 procedura janë shtesë e dhjetorit 2016, të përfituara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, të cilat janë zhvilluar në vitin 2017.
Për vitin 2017, janë shtuar 9 procedura prokurimi me vlerë 127,085,904 lekë, ndërsa për vitin 2018 janë shtuar 36 procedura me vlerë 189,000,142 lekë,
Nga auditimi i dosjeve të prokurimit rezultoi se janë bërë njoftimet në APP për fillimin e procedurave deri në lidhje kontrate, sipas kërkesave të legjislacionit dhe akteve të tjera nënligjore të LPP.
Regjistri i prokurimeve të realizuara ka të gjitha prokurimet e kryera gjatë vitit përkatës.

***C/2- Fondet në dispozicion:***
Fondet për investime në të gjitha rastet nga të ardhurat, granti dhe fondet e deleguara specifike janë miratuar me VKB në të gjitha rastet.
Fondet nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, Ministria e Arsimit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, janë sipas VKM përkatëse si dhe me shkresat e çeljeve të fondeve nga Ministria e linjës. Nga auditimi rezultoi se është ruajtur destinacioni i përdorimit të tyre, limiti, si dhe shpenzimet shumë vjeçare janë të mbështetura në PBA. (shërbimi i pastrimit, investimet në ujësjellësi me fonde nga buxheti i shtetit si dhe investimet ne infrastrukturë me burim financimi FZHR). Janë respektuar periudhat e financimit sipas fazave të investimeve, e përcaktuar kjo në shkresat e çeljes së këtyre fondeve.
Më hollësisht këto të dhëna janë në **ANEKSIN C/1**, “Çeljet buxhetore për investime për vitet 2016-2017-2018”, bashkëlidhur këtij materiali.

***C/3- Realizimi i investimeve.***
Nga auditimi i periudhës objekt auditimi ka rezultuar se urdhrat e prokurimit janë të saktë dhe në vlerë të plotë në sistemin e thesari përpara fillimit të procedurës dhe brenda afateve të përcaktuar ne ligj.
Sipas viteve realizimi i investimeve paraqitet sa vijon:
***Për vitin 2016*** mosrealizimi për investime, është në shumën **391,547 mijë lekë ose në masën 56%,** ku nga auditimi rezultoi se arsyeja është si rezultat i:
**-** lidhjes së kontratave në fund të vitit buxhetor;
- financimi me dy faza;
kryesisht në objektet:

*në 000/lekë*

| Nr. | Emërtimi i objektit | Plan | Fakt | Dif. + - | % |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Fur. me ujë fshatrave Dorez ,Gizavesh, -Katund Qendër | 17,423 | 0 | 17,423 | 0 |
| 2 | Ndërtim Rruga Orenje –Librazhd Loti I dyte | 131,313 | 0 | 131,313 | 0 |
| 3 | Rikonstruksion I kanalit vadites Gurakuq Floq | 12,391 | 0 | 12,3901 | 0 |
| 4 | Rik. I kanaleve vaditës Orenje ,Lunik ,Polis ,Hotolisht | 40,068 | 0 | 40,068 | 0 |
| 5 | Blerje ekskavator | 16,347 | 0 | 16,347 | 0 |
| 6 | Rikonstruksion Fusha e Futbollit dhe zyrat | 10,000 | 0 | 10,000 | 0 |
| 7 | Rruga Kotorice -Dragostunje ,Ndërtim trase rruga e | 7,800 | 0 | 7,800 | 0 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Kërrabës,lyerja e sifonit te kanalit te mesem (faza e pare ) | | | | |
| 8 | Shtrim çakëll ne rrugët Librazhd Katund -Bojas ,Depo ujit -gurët e mullirit ,Gizavesh ,Librazhd -Qendër | 10,000 | 0 | 10,000 | 0 |
| 9 | Sistemim I fushës se plehrave | 2,970 | 0 | 2,970 | 0 |
| 10 | Sistemim Varrezat fusha e Manes | 1,500 | 0 | 1,500 | 0 |
| 11 | Rikualifikimi urban , blloku I banimit nr.1 | 66,882 | 11,400 | 55,482 | 17.04 |
| 12 | Rikualifikim urban zona perendimore ne hyrje te qytetit | 49,918 | 0 | 49,918 | 0 |

***Trajtuar më hollësisht në pikën B të Projekt Raportit të auditimit (Pasqyra nr.4 "Planifikimit dhe realizimit të investimeve viti 2016".***

***Për vitin 2017*** mosrealizimi për i investime, është në shumen **321,895** mijë lekë ose në masën **55.5%,** ku nga auditimi rezultoi se arsyeja e mosrealizimit është si rezultat i:
- kryesisht nga vendosja e limitit nga Ministria e Financave.
- bllokimi i fondeve nga Ministria e Financës me shkresat përkatëse.

kryesisht në objektet:

*000/lekë*

| Nr. | Emërtimi i objektit | Plan | Fakt | Dif. + - | % e mosrealizimit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rikualifikimi urban , blloku I banimit nr.1 | 120,878 | 57,920 | 62,958 | 47.9 |
| 2 | Rik. urban zona perëndimore ne hyrje te qytetit, mbrojtja lumore | 98,641 | 65,557 | 33,084 | 66.5 |
| 5 | Rehabilitim i zonës ne te dyja anët e rrugës kryesore Librazhd , unaza e Dibrës | 33,458 | 0 | 33,458 | 100 |
| 18 | Projektime | 2,720,000 | 0 | 2,720,000 | 100 |
| 26 | Projektime | 4,280,000 | 0 | 4,280,000 | 100 |
| 33 | Rruga Kotorice -Dragostunje ,ndërtim trase rruga e krrabes, rruga Dranovice - Kostenje, etj. | 8,600,000 | 3,981,108 | 4,618,892 | 46.23 |
| 38 | Rikonstruksion Rruges Prevall-Dranovice | 1,194,928 | 0 | 1,194,928 | 100 |
| 39 | Rikonstruksion I rruges Lunik-Qendër | 299,962 | 0 | 299,962 | 100 |
| 45 | Rik. i kanalit Gurakuq Floq | 12,390,783 | 6,873,288 | 5,517,495 | 55.5 |
| 49 | Investime ne pyje | 4,100,000 | 0 | 4,100,000 | 100 |
| 50 | Rik. i Palestres se shkolles se mesme "I.Muca". | 2,840,939 | 0 | 2,840,939 | 100 |
| 54 | Ndertim kopesht femijesh Kokreve | 1,500,000 | 0 | 1,500,000 | 100 |
| 55 | Rik. I shkolles CU Floq ,shkolla vartese e Orenjes | 7,434,535 | 0 | 7,434,535 | 100 |
| 56 | Rik. I shkolles 9-vjecare Zdrajsh , | 957,684 | 0 | 957,684 | 100 |
| 57 | Rik. I shkolles 9-vjecare Gurakuq , | 948,607 | 0 | 948,607 | 100 |
| 58 | Rik. i Fushes se Futbollit Sopoti | 10,000,000 | 0 | 10,000,000 | 100 |
| 59 | Nivelim –sistemim terrenit - fusha e re e futbollit ) | 15,000,000 | 0 | 15,000,000 | 100 |
| 62 | Rikonstruksion i ujësjellësit Zgosht | 4,000,000 | 0 | 4,000,000 | 100 |
| 63 | Kanali i ujerave te zeza Mirake Plane | 1,100,000 | 0 | 1,100,000 | 100 |
| 66 | Ndërtim i rrjetit te jashtëm te ujësjellësit te fshatit Zgosht | 2,223,216 | 0 | 2,223,216 | 100 |
| 67 | Rip.i ujesjellesave Orenje | 357,672 | 0 | 357,672 | 100 |
| 71 | Rik. i Qendres se fshatit Togez | 3,500,000 | 0 | 3,500,000 | 100 |
| 78 | Rik. rruge Lunik Prevall + Ndertim ure | 5,000,000 | 0 | 5,000,000 | 100 |
| 80 | Rikualifikimi i Qendres Fshati Fushe Studen | 1,600,000 | 0 | 1,600,000 | 100 |
| 81 | Ndërtim prita Gjovac | 11,000,000 | 0 | 11,000,000 | 100 |
| 82 | Ndërtim prite Polis Gostime ( vazhdimi) | 4,500,000 | 0 | 4,500,000 | 100 |
| 84 | Rikonstruksion Rruga Marinaj Veshje me Beton | 1,000,000 | 0 | 1,000,000 | 100 |

| Nr. | Emërtimi i objektit | Plan | Fakt | Dif. + - | % e mosrealizimit |
|---|---|---|---|---|---|
| 85 | Ndërtim rruge Orenje -Librazhd loti 2 | 131,313,000 | 55,799,831 | 75,513,169 | 42.5 |
| 86 | Sistemime malore -përrenj St.Trenit dhe M.Alla | 1,470,750 | 0 | 1,470,750 | 100 |

*Trajtuar më hollësisht në Pasqyrën nr. 8 "Planifikimit dhe realizimit të investimeve viti 2017"*

**Për vitin 2018,** nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e investimeve në Bashkinë Librazhd rezulton se për vitin 2018 mosrealizimi është në vlerën 18%, e ardhur kryesisht nga:

- mbajtja 5 % e garancisë së defekteve
- kontratat e lidhura në fund të vitit
- limit i vendosur nga Ministria e Financës

kryesisht në objektet:

*në 000/lekë*

| Nr. | Emërtimi i objektit | Plan | Fakt | Dif, + - | % mos realizimit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndërtim Kopshti fshatit Semes, | 1,427 | 0 | 1,427 | 100 |
| 2 | Instalim e blerje kamerash për objektet shkollore te qytetit, çerdhet, kopshtet, rrugët kryesore e kryqëzimet e qytetit | 2,809 | 0 | 2,809 | 100 |
| 3 | Rikonstruksion i rrugës Lagja Dardha e Qoses , fshati Dragostunje. | 1,345 | 0 | 1,345 | 100 |
| 4 | Rikonstruksion pjesor rruga Qendër - Ballolli, fshati Polis Qender. | 1,471 | 0 | 1,471 | 100 |
| 5 | Rikonstruksion rruga lagja Gjere, fshati Polis . | 7,134 | 0 | 7,134 | 100 |
| 6 | Rikonstruksion rruga Kamine, fshati Xhyre , | 2,071 | 0 | 2,071 | 100 |
| 7 | Rehabilitimi urban i zonës përreth fushës se sportit | 6,000 | 3,631 | 2,369 | 39.48 |
| 8 | Rikonstruksion i ujësjellësit "Gurra e Bardhe - Lagja e Cekrezit", fshati Dardhe. | 2,188 | **0** | 2,188 | 100 |
| 9 | Rikonstruksion i ujësjellësit fshati Prevall, | 1,592 | 0 | 1,592 | 100 |
| 10 | Rikonstruksion Rrugës Prevall-Dranovice | 1,194 | | 1,194 | 100 |
| 11 | Nivelim -Sistemim I terrenit ku fdo te ndertohet stadiumi I ri | 13,089 | 10,869 | 2,220 | 16.96 |
| 12 | Ndertim prite gjatesore me gabione për rehabilitimin rruga e Shese , Lagja Poda Librazhd | 1,111 | 601 | 510 | 45.90 |
| 13 | Ndërtim rruge Orenje -Librazhd loti 2 | 72,579 | 67,769 | 4,810 | 6.63 |
| 14 | Rikonstruksion I kanalit Gurakuq Floq Njesia Orenje | 5,159 | 3,541 | 1,618 | 31.36 |
| 15 | Rik.kanaleve vaditëse Orenje,Lunik,Polis,Hotolisht | 3,818 | 2,857 | 961 | 25.17 |
| 16 | Furnizimi me uje Dorez-Gizavesh, L.Katund,-L. Qendër | 63,936 | 60,730 | 3,206 | 5.01 |
| 17 | Ndërtimi I rrjetit shpërndarës Dorez ,Gizavesh | 83,457 | 75,145 | 8,312 | 9.96 |
| 18 | Përmirësim kushteve te banimit te komunitetit rom | 13,500 | 12,817 | 683 | 5.06 |
| 19 | Rikualifikimi urban Blloku I banimit Nr.1 | 59,910 | 56,914 | 2,996 | 5 |
| 20 | Rehab. zonës ne te dyja anët e rrugës ,Rruga e Dibrës | 92,400 | 87,780 | 4,620 | 5 |
| 21 | Rik. urban zonës ne hyrje te qytetit dhe mbrojtje lumore | 29,633 | 19,618 | 10,015 | 33.80 |
| 22 | Rikonstruksion i shkollës se mesme Hotolisht | 29,013 | 27,561 | 1,452 | 5 |
| 23 | Rik.dhe shtese anësore sh. Mesme Isa Alla Zgosht | 23,154 | 16,345 | 6,809 | 29.41 |

***Trajtuar më hollësisht në Pasqyrën nr. 12 "Planifikimit dhe realizimit të investimeve viti 2018"***

## C/4- *Auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik.*

Në Bashkinë Librazhd, për periudhën objekt auditimi (01.07.2016 – 31.12.2018), janë zhvilluar 73 procedura prokurimi, në vlerë **1,057,280 mijë lekë**. Kanë marrë pjesë në procedura prokurimi 224 operatorë ekonomikë dhe janë s`kualifikuar 118 prej tyre.
Diferenca nga fondi limit për këto procedura është në shumën 35,281,540 lekë ose 3.3% e fondit limit.
Të dhënat sipas viteve paraqiten sipas tabelës sa më poshtë vijon:

| Vitet | Fondi limit | OE | | Vlera fituese | Diferenca nga fondi limit | Kontrata | Shtese kontrate |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Σ | - | | | | |
| **6 mujori II/ 2016** | 298,402,954 | 21 | 15 | 295,724,247 | 2,678,707 | 340,811,350 | 16,223, 216 |
| **2017** | 500,118,718 | 123 | 63 | 475,213,452 | 24,905,266 | 570,257,342 | 5,728,883 |
| **2018** | 258,758,396 | 80 | 40 | 251,060,829 | 7,697,567 | 299,509,914 | 0 |
| **Totali** | **1,057,280,068** | **224** | **118** | **1,021,998,528** | **35,281,540** | **1,210,578,606** | **21,952,099** |

Grupi i auditimit për periudhën objekt auditimi, ka audituar 16 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit **724,200,803 lekë ose 70 % të fondit limit** të prokuruar. Në këto procedura diferenca nga fondi limit është në shumën **24,191** mijë lekë ose 3.2% të fondit limit si dhe kanë marrë pjesë në procedura 60 OE dhe janë s`kualifikuar 35 prej tyre ose 58%.
Përzgjedhja e procedurave u bë në bazë risku dhe materialiteti, kryesisht bazuar në vlerën e tyre të fondit limit, duke nisur nga vlerat më të mëdha si dhe në llojin e procedurës së prokurimit kryesisht e hapur si dhe në dy raste kërkesë për propozim.
Konkretisht vlerat e audituara sipas viteve paraqiten sipas tabelës sa më poshtë vijon:

| Viti | Fondi limit | Oferta fituese | Diferenca | OE | | Kontrata |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Σ | - | |
| 6 mujori 2016 | 274,449,328 | 271,800,852 | 2,648,476 | 16 | 12 | 326,036,714 |
| 2017 | 337,605,318 | 317,485,039 | 20,120,279 | 30 | 14 | 380,982,048 |
| 2018 | 112,146,157 | 110,726,228 | 1,422,478 | 14 | 9 | 123,386,807 |
| **Totali** | **724,200,803** | **700,012,119** | **24,191,233** | **60** | **35** | **830,405,569** |

Procedurat e prokurimit të audituara nga KLSH për periudhën objekt auditimi në Bashkinë Librazhd janë të pasqyruara në **ANEKS C/2, bashkëlidhur.**
Bazuar në përllogaritjen e riskut dhe nivelin e materialitetit, rezultuan gjetjet sa më poshtë vijon:

**Gjetje nr.14: KLSH konstatoi se** në procesverbalet e punës së komisioneve të përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, ku është hartuar preventivi (fondi limit) nuk janë përcaktuar kërkesat teknike në lidhje me objektin e procedurës së prokurimit (fuqinë punëtore, stafin teknik, punonjësit e specializuar, kategoritë e licencës, makineritë, certifikatat ISO, etj, kjo për 16 procedurat e audituara, të trajtuara në aktkonstatime si dhe në anekset bashkëlidhur këtij materiali.

**Situata** Fondi limit dhe specifikimet teknike për procedurat e prokurimit per vitet 6 mujori i dytë 2017, 2017 e 2018, janë përllogaritur nga komisionet e vlerësimit të fondit limit, të ngritur sipas urdhrave të Kryetarit të Bashkisë, sipas tabelave ANEKS C/3, bashkëlidhur.

Në këto urdhëra, në pikën 4, është përcaktuar se: “Në përcaktimin e

| | |
|---|---|
| | specifikimeve teknike komisioni të përcaktojë kërkesat për:<br>- Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar. (neni 23 i LPP).<br>- Grafikun e punimeve përcakton qartë mënyrën dhe afatet përfundimtare për realizimin e punimeve."<br>Komisionet në specifikimet teknike që janë bërë pjesë e dokumenteve të tenderit, kanë vendosur përshkrimin e punimeve, të materialeve, etj.<br>Në procesverbalet e punës së komisioneve ku është hartuar preventivi (fondi limit) nuk janë përcaktuar kërkesat teknike në lidhje me procedurën e prokurimit (fuqinë punëtore, stafin teknik, punonjësit e specializuar, kategoritë e licencës, makineritë, certifikatat ISO, etj. |
| **Kriteri** | Moszbatim i kërkesave të nenit 23 të LPP, si dhe të Urdhrave të Titullarit të Autoritetit Kontraktor. Në nenin 23/4të LPP është përcaktuar se:<br>"4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, maketë etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. **Nga përshkrimi i punëve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me ketë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale**. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin". |
| **Impakti** | Ndikim në përcaktimin e kritereve teknike për kualifikim. |
| **Shkaku** | Mospërcaktimi nga persona të specializuar të kritereve teknike për kualifikim si dhe moszbatim i urdhërave të Kryetarit të Bashkisë |
| **Rëndësia** | **I lartë.** |
| **Rekomandimi:** | Bashkia Librazhd të marrë masa që komisionet e hartimit të fondit limit, të respektojnë urdhërat e Titullarit të AK si dhe aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik. |
| **Afati për zbatim** | **Menjëherë** |

***Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi:***
**Për vitin 2016**: *M.B., V.D., A.L., B.B., B.M., N.A..*
**Për vitin 2017:** *B.M., S.T., N.A., A.P., A.L., L.T., O.A., M.B..*
**Për vitin 2018:** *M.B., E.G., E.A., B.M., A.L. e O.A.*

**Gjetje nr. 15: KLSH konstatoi** se procedurën e prokurimit me objekt: **"Rehabilitimi urban i zonës përreth fushës së sportit, Librazhd",** me të dhënat sa vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Fondi limit**: 9,569,723 lekë<br>**Burimi i financimit**: Keshilli I Qarkut Elbasan<br>Dhe Bashkia Librazhd<br>**Data e hapjes:10.09.2018** | **NJHDT** Nr. 595, date 30.08.2018<br>S.K.<br>M.B.<br>B.M. | KVO **nr.596, datë 30.08.2018**<br>- D.T.<br>- Q.D.<br>- E.G. |
| **OE:**<br>Pjesemarres1 , s`kualifikuar 0 kualifikuar 1 | **Oferta Fituese** 9,179,080 lekë | Afati 3 muaj nga lidhja e kontratës. |

| **OE Fitues:** “D....”& “L....”shpk | **Diferenca me fondin limit** 390,643 leke. | Vlera e kontratës: 11,014,896 lekë me tvsh |
|---|---|---|

Rezultuan kërkesa në kundërshtim me nenin 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 dhe neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2.

**Situata** **Në DT janë kërkuar:**

**a-** **“2.2.3.**Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga secila prej njësive qeverisjes vendore shoqëruar me dokumentacion që dëshmon pagesën e tyre **(mandat pagesa)** se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për periudhën nga 1 janari 2017 deri në datën 31 korrik 2018**.”**

**a/1-** Kërkesa për paraqitjen edhe të mandat pagesës që vërteton se subjekti ka paguar detyrimet është kërkesë e tejkaluar e LPP, pasi është përgjegjësi e institucioneve që kanë lëshuar dokumentin e kërkuar nga ana e AK me apo pa mandat pagesë.

**b-** **2.3.4.** Kërkesat e cilësisë. Kandidati/ofertuesi duhet te paraqesë ndërmjet të tjerave edhe “Certifikatë për sistemin e menaxhimit te energjisë **EN ISO 50001:2012** ose e përditësuar (e vlefshme)”.

**b/1-** Kërkesa për këtë certifikatë ISO, nuk është e lidhur me objektin e prokurimit, pasi është një specifikim i krijuar nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) për një sistem të menaxhimit të energjisë. Standardi specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është të mundësojë një organizatë që të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, sigurinë e energjisë, përdorimin e energjisë dhe konsumit. Standardi synon të ndihmojë organizatat që vazhdimisht të zvogëlojnë përdorimin e tyre të energjisë, prandaj edhe kostot e tyre të energjisë dhe emetimet e tyre të gazrave serrë.

**c-** Listë pagesat e konfirmuar nga administrata tatimore.

**c/1-** Kërkesa “e konfirmuar nga administrata tatimore” , është në kundërshtim me VKM nr.922, datë 29.12.2014, “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave dhe dokumenteve të tjera tatimore vetëm nëpërmjet formës elektronike”, neni 2, ku përcaktohet se:

> “Cdo tatim pagues është i detyruar të bëjë dorëzimin e deklaratave dhe dokumenteve tatimore të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij vendimi, vetëm nëpërmjet formës elektronike duke filluar nga data 01.01.2015, sipas afateve ligjore të përcaktuara dhe formës së deklaratës apo të dokumentit të miratuar me udhëzim të Ministrisë së Finanacave**”.**

pasi OE ka detyrim vetëm të deklarojë listëpagesat nëpërmjet formës elektronike dhe jo ti konfirmojë ato në administratën tatimore.

**Kriteri** Neni 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 dhe neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2.

**Impakti** Përcaktim jo i drejtë i kërkesave për kualifikim.

**Shkaku** Moszbatimi i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik.

**Rëndësia** I mesëm.

***Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi NJHDT:*** S.K., M.B. e B.M.

***Komente të ardhura nga subjekti me shkresën nr.2492, datë 25.04.2019, e protokolluar në KLSH me numër 291, datë 24.05.2019.***
***Ju komentoni se:***
Ne procesverbalin e hartimit te dokumentave te tenderit gjithsej 9 (nente) flete , per cdo kriter kualifikues eshte vendosur baza ligjore, ne baze te te cilit eshte kerkuar si kerkese kualifikuese.
Njesia e Prokurimit, ne hartimin e dokumentave te tenderit me objekt: " Rehabilitim urban i Zones perreth fushes se Sportit, Librazhd ",eshte bazuar ne nenin 46 te LPP, ka percaktuar si kritere kualifikuese kerkesat teknike dhe ligjore qe i ka vlerësuar të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.
Njesia e Prokurimit sqaron se ne lidhje me kete objekt prokurimi, hartimi i kerkesave te vecanta kualifikuese teknike, eshte i argumentuar teknikisht me dosjen e komisionit te perllogaritjes se fondit limit, hartimin e preventivit, analizat e cmimeve, analizen e punetorise , grafikun e punimeve, specifikimet teknike, projektin e vepres etj, ndersa nga ana ligjore keto kritere jane te bazuara ne legjislacionin ne fushen e prokurimeve publike, sipas percaktimeve konkrete ne procesverbalin e mbajtur nga Njesia e Prokurimit, ku per cdo kriter apo kerkese kualifikuese eshte percaktuar edhe baza ligjore ne te cilen eshte mbeshtetur apo eshte bazuar.
*Përsa cituam më lart ky pretendim nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk duhet të përfshihet në projektraportin e auditimit.*
***Sqarim:*** *edhe ne ballafaqimin e bërë rezultoi se ju nuk i keni argumentuar kërkesat për kualifikim. Ju sqarojmë se vendosja e bazëz ligjore nuk do të thotë që i keni argumentuar kërkesat.*
**Se dyti,** eshte permendur qe per kete objekt prokurimi , ne kriterin kualifikues , citojme : " ***2.2.3.****Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim te leshuar nga sejcila prej njesive qeverisjes vendore shoqëruar me dokumentacion që dëshmon pagesën e tyre(mandatpagesa) se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per periudhen nga 1 janari 2017 deri ne daten 31 korrik 2018", kerkesa per paraqitjen edhe te mandatpagesave qe verteton se subjekti i ka paguar detyrimet eshte kerkese e tejkaluar e LPP, pasi eshte pergjegjesi e institucioneve qe kane leshuar dokumentin e kerkuar nga ana e AK me apo pa mandat pagese.".*
Ne lidhje me kete pike sqarojme se : Kerkesa qe subjekti te paraqese si pjese te dokumentacionit ne SPE te paraqese edhe dokumantacion qe deshmon pagesen e tyre nuk eshte kerkese diskriminuese per Operatoret Ekonomike, pasi AK e kerkon kete dokumentacion plotesues vetem per te perforcuar bindjen qe operatori ekonomik nuk ka detyrime per taksa dhe tarifa vendore ndaj njesive vendore ku ushtron apo ka ushtruar aktivitet sipas ekstratit te QKB-se.
Kjo kerkese eshte e mbeshtetur ne ligjin nr. 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore",i ndryshuar dhe ne Udhezimin e Ministrise se Financave nr, 08, date 09.03.2018 "Per pasqyrat e pergatitjes , paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore ne njesite e qeverisjes se pergjithshme".
Ne ligjin nr. 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni **4,:** *"Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar ".*

Ne Udhezimin e Ministrise se Financave nr, 08, date 09.03.2018 " Per pasqyrat e pergatitjes , paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore ne njesite e qeverisjes se pergjithshme ", pika 6, percaktohet , citojme :
*"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues, të cilët dallohen në: - Dokumente bazë justifikuese (faturë blerje/ shitjeje, fletëhyrje/dalje,* ***mandatarkëtim/pagesë****), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike dhe shërbejnë* ***për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit".***
***Sa me siper kerkesa per kualifikim qe*** *Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim te leshuar nga sejcila prej njesive qeverisjes vendore shoqëruar me dokumentacion që dëshmon pagesën e tyre(mandatpagesa) se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, eshte nje kerkese e mbeshtetur ne Ligj, dhe aktet normative te RSH, dhe eshte* ***në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.***
*Përsa cituam më lart ky pretendim nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk duhet të përfshihet në projektraportin e auditimit.*
**Sqarim:** Është përgjegjësi e Institucionit që ka lëshuar vërtetimin pagesa e tij. Juve ju mjafton vertetimit në fjale, në rast se dyshoni mund ta vërtetoni. Nuk është detyrim ligjor që OE pasi të marrë një dokument të ruajë mandat pagesën për tja u vërtetuar juve. Vërtetimin e një dokumenti e ben firma dhe vula e një institucioni. Lind pyetja si duhet vepruar në rast se nje vërtetim jepet pa pagesë, do të s`kualifikohet OE?
**Se pesti,** eshte konstatuar qe per kete objekt prokurimi kriteri kualifikues pika : *2.3.4. Kërkesat e cilësisë. Kandidati/ofertuesi duhet te paraqesë ndërmjet të tjerave edhe "Certifikatëpër sistemin e menaxhimit te energjisë* **EN ISO 50001:2012** *ose e përditësuar(e vlefshme)", kërkesa për këtë certifikatë ISO, nuk është e lidhur me objektin e prokurimit. Kuptimi i ISO 50001 Sistemet e menaxhimit të energjisë është një specifikim i krijuar nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) për një sistem të menaxhimit të energjisë. Standardi specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është të mundësojë një organizatë që të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, sigurinë e energjisë, përdorimin e energjisë dhe konsumit. Standardi synon të ndihmojë organizatat që vazhdimisht të zvogëlojnë përdorimin e tyre të energjisë, prandaj edhe kostot e tyre të energjisë dhe emetimet e tyre të gazrave serrë.*
**Ne lidhje me kete pike, Njesia e Prokurimit argumenton se: Kerkesa qe** kandidati/ofertuesi duhet te paraqesë ndërmjet të tjerave edhe "Certifikatëpër sistemin e menaxhimit te energjisë **EN ISO 50001:2012** ose e përditësuar(e vlefshme), eshte e lidhur me objektin e prokurimit pasi **pervec faktit qe kemi te bejme me nje zone te urbanizuar,zone perreth fushes se sportit e cila duhet te kete nje ndricim , lidhje, dhe sistemi i energjise sa me eficente , lidhje sa me te sigurta per perdorimin dhe konsumin e energjise .** Konkretisht po ju citojme zerat e preventivit sipas se ciles lidhen me Certifikatë për sistemin e menaxhimit te energjisë **EN ISO 50001:2012** ose e përditësuar:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 27 | 480/5 | F.V tub plastmasi Ø 31-36mm, ndricimi | ml | 62 |
| 28 | 2-481/4 | F.V kabell (3+1) 6 mm2 | ml | 67 |
| 29 | 2-481/2 | F.V percjelles PV-500 Ø 2.5mm2 ( 2+1) | ml | 69 |
| 30 | an | F V shtylla dekorative +ndricues , H=4.6m, | cope | 5 |
| 31 | an | F.V puseta plastike 20x20x20 elektrike | cope | 5 |
| 32 | 3 An/et | F.V elektroda tokezimi te xinguara 50x3 mm l=1.5m | cope | 5 |
| 33 | 2.489 | F.V siguresa 25 A | cope | 5 |

Njesia e Prokurimit duke iu referuar ketyre zerave te preventivit te sipercituar, e ka gjykuar te domosdoshme vendosjen e "Certifikatë për sistemin e menaxhimit te energjisë EN ISO 50001:2012 ose e përditësuar(e vlefshme), pasi kemi zera preventivi qe kane te bejne me krijimin e sistemit elektrik ndriçues dhe kjo ka patur si qellim zbatimin e punimeve nga subjekte qe te jene te certifikuar ne sistemin e menaxhimit te energjise elektrike.
*Përsa cituam më lart ky pretendim nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk duhet të përfshihet në projektraportin e auditimit.*
***Sqarim:*** *Objekti i prokurimit nuk ka lidhje me objektin e certifikatës ISO në fjalë.*
**Se gjashti,** Listepagesa te konfirmuara nga administrata tatimore, kjo kerkese eshte ne kundershtim me VKM nr. 922, date 29.12.2014, sipas se ciles OE ka detyrimin ti deklaroje listepagesat vetem nepermjet formes elektronike dhen jo ti konfirmoje ato ne administraten tatimore.
Ky pretendim i grupit të auditimit nuk qëndron për shkak se formulimi i konfirmuar nga Administrata Tatimore nuk nënkupton marrjen e firmës dhe vulosjen me vulë të njomë të listëpagesave të operatorëve ekonomikë nga ana e Tatimeve por përfshirjen në kriter edhe nëpërmjet formës elektronike.
Për më tepër paraqitja e listëpagesave nga ana e OE nëpërmjet listëpagesave elektronike nuk ka shërbyer dhe nuk është konsideruar në asnjë rast nga ana e KVO si arsye për skualifikim për operatorët ekonomikë nga proçedurat e prokurimit të zhvilluara nga ana e AK Bashkia Librazhd.
Theksojmë se problem do të përbënte fakti nëse KVO do ta përdorte si arsye skualifikimi për operatorët ekonomikë dhe përderisa nuk është aplikuar asnjëherë si arsye skualifikimi tregon qartazi që listëpagesat nuk janë kërkuar nga ana e njësisë së prokurimit të firmosura dhe të vulosura me vulë të njomë nga organet tatimore.
Nëse do të vërenim në sistemin elektronik proçedura prokurimi të publikuara në faqen e Agjensisë së Prokurimit Publik madje në periudhën aktuale 2018-2019 konstatohet se shumica dërrmuese e Autoriteteve Kontraktore vazhdojnë të njëjtin formulim… Listëpagesat e konfirmuara nga administrate tatimor cka nënkupton se edhe pse kanë kaluar programe auditimi vijon të mbetet në fuqi.
Përsa cituam më lart ky pretendim i grupit të audituesve nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk duhet të përfshihet si shkelje në projektraport.
Njesia e Prokurimit , argumenton ne lidhje me kete pike se kerkesa qe te paraqiten listepagesat te konfirmuara nga administrata tatimore, nuk nenkupton vetem faktin e dorezimit fizikisht te listepagesave prane AT, por konfirmimi i listepagesave nga administrate tatimore tashme mund te behet edhe ne formen elektronike, nepermjet nenshkrimit elektronik sipas vules elektronike te AT.
Sa me siper ky kriter nuk disfavorizon aspak operatoret ekonomike te interesuar ne kete procedure prokurimi.
**Sqarim:** Argumentimi juaj nuk qëndron, nuk ka mbështetje ligjore. Ju vëmë në dijeni se kjo është konstatuar edhe në udhëzimet e APP për OE, si kërkesë e cila nuk duhet të jetë më.

**Gjetje nr. 16: KLSH konstatoi se** procedurën e prokurimit me objekt: **"Rikonstruksion dhe shtesë anësore shkolla e mesme e bashkuar "Isa Alla", fshati Zgosht, NJA Lunik",** me të dhënat sa vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Urdhër prokurimi** Nr. 514, datë 10.07.2018 | **NJHDT** Nr. 514, datë 10.07.2018<br>S.K.<br>M.B.<br>S.D. | KVO<br>Nr. 518, datë 10.07.2018<br>- H.H.<br>- Q.D. |
| **Procedura prokurimit** e hapur | | |
| **Fondi limit**:47,060,671 lekë | | |

| | | |
|---|---|---|
| **Burimi i financimit**: FZHR dhe Bashkia Librazhd 10% | | - E.G. |
| **Data e hapjes:15.08.2018** | **OE Fitues:**"E..."shpk | Kontrata nr.4320, datë 24.09.2018 Afati 5 muaj nga data e fillimit të punimeve |
| **OE:** Pjesemarres3 s`kualifikuar 2 kualifikuar 1 | **Diferenca me fondin limit** 69, 473 leke. | |
| | Miratimi i procedurës, datë 18.09.2018. | Vlera e kontratës: 46,991,198 lekë me tvsh Kontrata është në process. |
| **Oferta Fituese** 46,991,198 lekë | | |

Rezultuan kërkesa në kundërshtim me nenin 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 dhe neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2.

**Situata** **Në DT janë kërkuar:**

**a-** Listë pagesat e punonjësve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhën Janar 2017 – Maj 2018 **shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave** për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

**a/1-** Kërkesa shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, është një kërkesë e fryrë dhe e tejkaluar e LPP, pasi nga vetë organet tatimore, bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.23, datë 09.12.2014, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", të dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në të cilin në pikën 10, "Të tjera". Sa më sipër fakti që OE ka marrë vërtetimin nga administrata tatimore dhe listë pagesat do të thotë që e ka paraqitur formularin e deklarimit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

- 5.Shoqëria pjesëmarrëse duhet të ketë të punësuar staf si drejtues teknik në liçencë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme, diplomë/liçencë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë dhe në listpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar me lart, stafi inxhinierik si :1 Ndërtimi; 1 Arkitekt; 1 Elektrik; 1 Hidroteknik; 1 Mjedisi; 1 Topograf; 1 Mekanik dhe 1 Gjeolog.

**b/1- Numri prej 8 inxhinierësh në staf** si drejtues teknik, është i fryrë dhe ul konkurencën në procedurë. OE mund të marrë staf edhe të punësuar me kontratë. Gjithashtu sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor që stafi i punonjësve të jetë i pasqyruar në listëpagesa, **kjo kërkesë kufizon numrin e shoqërive pjesëmarrëse që nuk zotërojnë staf teknik të përhershëm** (gjë që reflektohet në listëpagesat e shoqërisë), por që kanë mundësinë t'a sigurojnë këtë staf, duke lidhur kontrata pune me afat sa afati i kontratës objekt prokurimi.

**b/2- Në lidhje me kërkesën për arkitekt në staf si drejtues teknik, sqarojmë se** në dokumentet e procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve","Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit", duke i vënë në dispozicion, informacionin operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi projektin të cilët këto të fundit do të zbatojnë në rast të fitimit të kontratës. Disponueshmëria si pjesë e stafit teknik të një arkiktekti në fazën e zbatimit të punimeve, ku ndër të tjera autoriteti kontrakor ka kërkuar referuar kritereve të veçanta të kualifikimit pjesë të stafit teknik, inxhinierët, si ndërtimi, hidroteknik, mekanik, gjeodet, elektrik,

mjedisi, gjeolog, shkon përtej synimit të autoritetit kontraktor dhe njëherazi nuk është në proprocion me natyrën dhe volumin e kontratës. Disponueshmëria e një arkitekti referuar natyrës së punimeve dhe duke marrë në konsideratë faktin se autoriteti kontraktor ka parashikuar në mënyrë të detajuar projektin e zbatimit, specifikimet teknike, nuk shfaqet e nevojshme në proprocion me natyrën dhe volumin e punimeve.

**b-** "18. Do të organizohet një vizitë në kantier më **23.07.2018 ,ora 11:00**, në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familjarizohen me kushtet lokale njohur me ne hollesi projektin dhe krijuar ide të qarta e konkrete mbi organizimin e punes gjatë zbatimit punimeve. Operatori ekonomiki interesuarduhet të konfirmojë paraprakishtme shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Të gjitha kostot e operatorëve ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër,dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Operatoret ekonomike pas vizitës ne kantier do të pajisen me vërtetim nga bashkia per vizitën e kryer të cilin do ta paraqesin si pjese të dokumentave të tenderit.

**c/1-** Vendosja e kësaj kërkese në kriteret e veçanta për kualifikim është në kundërshtim me DST, të miratuara për vitin përkatës. Kjo kërkesë është pjesë e kapitullit **II. Udhëzime për operatorët ekonomikë", Seksioni 1. "Hartimi i ofertës", pika 1.3.**

**Kriteri** Neni 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 dhe neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2.

**Impakti** Përcaktim jo i drejtë i kërkesave për kualifikim.

**Shkaku** Moszbatimi i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik.

**Rëndësia** **I lartë.**

***Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi NJHDT:*** S.K., M.B. e B.M.

***Komente të ardhura nga subjekti me shkresën nr.2492, datë 25.04.2019, e protokolluar në KLSH me numër 291, datë 24.05.2019.***

***Ju komentoni se:***

Njesia e Prokurimit ne hartimin e dokumentave te tenderit me objekt: "Rikonstruksion dhe shtesë anësore shkolla e mesme e bashkuar "Isa Alla", fshati Zgosht, NJA Lunik", eshte bazuar ne nenin 46 te LPP, ka percaktuar si kritere kualifikuese kerkesat teknike dhe ligjore qe i ka vlerësuar të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

Njesia e Prokurimit sqaron se ne lidhje me kete objekt prokurimi, hartimi i kerkesave te vecanta kualifikuese teknike, eshte i argumentuar teknikisht me dosjen e komisionit te perllogaritjes se fondit limit, hartimin e preventivit, analizat e cmimeve, analizen e punetorise , grafikun e punimeve, specifikimet teknike, projektin e vepres etj, ndersa nga ana ligjore keto kritere jane te bazuara ne legjislacionin ne fushen e prokurimeve publike, sipas percaktimeve konkrete ne procesverbalin e mbajtur nga Njesia e Prokurimit, ku per cdo kriter apo kerkese kualifikuese eshte percaktuar edhe baza ligjore ne te cilen eshte mbeshtetur apo eshte bazuar.

***Sqarim****: në procesverbalin e hartimit të DT ju keni listuar kërkesat por nuk i keni argumentuar ato, fakt i vënë në dukje edhe gjatë ballafaqimeve verbale..*

***Ju komentoni se:***

kërkesa shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”.
Ne lidhje me kete konstatim Njesia e prokurimit sqaron dhe argumenton se : ***Kjo kerkese e percaktuar nga njesia e prokurimit si kriter kualifikues, nuk diskriminon aspak Operatoret Ekonomike te interesuar ne kete procedure prokurimi, pasi formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore jane baza mbi te cilen punonjesit e nje operatori ekonomik deklarohen ne administraten tatimore si te punesuar, dhe mbi bazen e te cilit paguhen detyrimet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per punonjesit e OE***.
Sa me siper nuk eshte nje kriter apo kerkese e tejkaluar e LPP, pasi ne nenin 46 te Ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : “*1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme,* ***që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:***
***Sqarim:*** Ju sqarojme se spjegimet tuaja nuk merren në konsideratë për këtë pikë pasi organet tatimore per vertetimin e numrit të punonjësve lëshojnë vertetime dhe liste pagesa të konfirmuara.
***Ju komentoni se:***
**Për numrin prej 8 inxhinierësh në staf** si drejtues teknik, është i fryrë dhe ul konkurencën në procedurë. OE mund të marrë staf edhe të punësuar me kontratë. Gjithashtu sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor që stafi i punonjësve të jetë i pasqyruar në listëpagesa, **kjo kërkesë kufizon numrin e shoqërive pjesëmarrëse që nuk zotërojnë staf tekniktë përhershëm** (gjë që reflektohet në listëpagesat e shoqërisë), por që kanë mundësinë t’a sigurojnë këtë staf, duke lidhur kontrata pune me afat sa afati i kontratës objekt prokurimi.
Njesia e Prokurimit argumenton kete kriter kualifikues si me poshte: **Perderisa jane kerkuar si kategori te licenses se punimeve per kete objekt prokurimi, kategorite e meposhteme**:
“ 2.Liçencat profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, do të jetë:
N.P – 1A, N.P - 2B. N.P – 3B. N.P – 12A. N.S – 1A,, N.S – 2 A, N.S - 4 A, N.S - 6A , N.S - 8 A, NS – 9 A, N.S – 12 A, N.S-14 A, N.S-18 B, .
Kerkesa per stafin teknik te mesiperm, si drejtues teknik te shoqerise eshte e lidhur ngushte edhe me kategorite e Liçences profesionale që duhet të plotësojnë OE, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, te kerkuara ne DST, si kriter me vete.
Sipas VKM nr. 42, date 16.01.2008 “ Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve qe ushtrojne veprimtari ndertimit”, e ndryshuar:
Kerkesa per stafin teknik te mesiperm, si drejtues teknik te shoqerise eshte e lidhur ngushte edhe me kategorite e Liçences profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, te kerkuara ne DST, si kriter me vete.
**Sqarim:** Ju sqarojmë se grupi i auditimit nuk është kundër përcaktimit të nevojave të stafit, por qenia e tyre si drejtues teknik është shumë e fryrë pasi për disa prej tyre mund të kërkohet edhe me kontratë pune.
***Ju komentoni se:***
**Se shtati**, Kerkesa per viziten ne kantier eshte kerkese e mbeshtetur teresisht ne LPP, RRPP dhe sipas formatit te DST. Kjo kerkese eshte nje alternative qe operatoret ekonomike te interesuar per kete procedure prokurimi te njihen nga afer me terrenin ku do te zhvillohen punimet , objektin konkret qe do te punohen, shtrirjen gjeografike etj. Njesia e Prokurimit,

ne asnje rast ne DST nuk e ka vendosur kete opsion te vizites ne kantier , si kriter kualifikues , apo skualifikues te operatoreve ekonomike pjesmarres te interesuar ne nje procedure prokurimi. Perves kesaj ne piken 18, te DST, per kete objekt prokurimi , eshte percaktuar se " *Pa paragjykuar sa më sipër,dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik* ***mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit,*** *nëse një gjë e tillë është e mundur", dmth eshte ne te drejten e OE nqs duan te bejne nje vizite ne terren ne diten e percaktuar ne DST, apo edhe mund ta vizitojne ne cdo kohe vendodhjen e kantierit sipas deshirave te tyre. Pra mospjesmarrja ne takimin e organizuar , nuk ka patur per qellim penalizimin e operatoreve ekonomike gjate vleresimit te ofertave per ta konsideruar te suksesshme apo jo oferten e tyre ekonomike te dorezuar, dhe ne asnje rast nga KVO nuk eshte perdoruar si e tille gjate vleresimit te ofertave.*
Pavaresisht se eshte percaktuar , ne faqen e DST, tek kriteret e pergjithshme dhe te vecanta, ne asnje rast nuk eshte patur si qellim qe te perdoret si kriter kualifikues apo skualifikues per operatoret ekonomike .
**Sqarim:** Ju sqarojmë se ky koment nuk merret në kosideratë, kjo kërkesë nuk është pjesë e kritereve për kualifikim, trajtuar më hollësisht në akt konstatim.

**Gjetje nr. 17: KLSH konstatoi se** procedurën e prokurimit me objekt: **"Rehabilitim urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore të qytetit të Librazhdit dhe SA rruga e Dibrës",** me të dhënat sa vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Urdhër prokurimi** Nr. 177, date 30.03.2017<br>**Procedura prokurimit** – e hapur<br>**Fondi limit**:92,939,507 lekë<br>**Burimi i financimit**:buxheti i shtetit | **NJHDT** Nr. 177, date 30.03.2017<br>A.Q.,<br>M.B.,<br>I.H. | KVO<br>Nr. 178, date 30.03.2017<br>- E.A.<br>- S.K.<br>- B.P. |
| **Data e hapjes:**24.04.2017 | **OE Fitues:**"V...." shpk | Kontrata nr.5439, datë 11.09.2017 Afati 4 muaj e 20 ditë nga data e fillimit të punimeve. |
| **OE:**<br>Pjesemarres5<br>s`kualifikuar 4<br>kualifikuar 1 | **Diferenca me fondin limit** 15,799,930 leke.<br>**Oferta Fituese** 77,139,577 lekë<br>**Titullari AK**:Nëpunësi Autorizues K.G. | Miratimi i procedurës, datë 28.05.2017.<br>Vlera e kontratës: 92,567,493 lekë me tvsh |

Rezultuan kërkesa në kundërshtim me nenin 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 dhe neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2.

**Situata** **Në DT janë kërkuar:**

**a-** Vërtetim per mos pasje detyrimesh vendore, detyrime tatimore apo penalitetë të evidentuara nga auditimet e kryera ne Bashkine Librazhd nga institucionet e ndryshem ligjzbatuese . Vërtetim leshuar nga bashkia Librazhd . (*ketë vërtetim operatoret mund ta terheqinedhe ne rruge elektronike me anen e nje kerkese ne:****info@bashkialibrazhd.gov.al*** *dhe vërtetimi do ju dergohet ne te njejten menyre*). (*Ne rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, cdo anetar i ketij bashkimi duhet te paraqesë ketë dokument*)
**a/1-** Në vendosjen e këtij kriteri NJHDT ka vepruar në kundërshtim me nenin 46, pika 1, e LPP pasi legjislacioni i prokurimit publik kërkon që kriteret e

kualifikimit duhet të jenë të qarta dhe të mirëpërcaktuara nga AK, me qëllim që të jenë sa më të mirkuptueshme jo vetëm nga OE por edhe në funksion të procesit të vlerësimit. AK ka informacionin e nevojshëm në lidhje me detyrimet që OE mund të kenë në Bashki. Në ketë kuptim kërkesa e AK për paraqitjen e këtij vërtetimi konsiderohet e panevojshmedhe pengesë për ofertuesit pjesmarrës në ketë procedurë. Gjithashtu kjo kërkesë frenon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit public.

**b-** Kontrata te ngjashme konsiderohen te vlefshme nese zerat kryesore te punimeve kane volume te konsiderueshme krahasimore me keto te përcaktuara per ketë prokurim.

**b/1-** Kjo kërkesë "volume të krahasueshme" është përtej përcaktimeve të neneve 26 e 28 të VKM nr.914, datë 28.12.2014, ku parashikohet se për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon punë të ngjashme, por edhe të faktit se vendosja e tij ndikon drejtpërdrejt në kufizimin e konkurencës.

**c-** 3. Kandidati/ofertuesi duhet te paraqesë Liçensen profesionale te shoqerise duke deshmuar se zoteron keto kategori lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës edhe për kategoritë:

- NP 9A Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulikë dhe bonifikime.
- NP 12B Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore.

**c/1-** Ku bazuar në **VKM nr.42,** datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" **nuk ka punime të tilla në preventiv.**

**d-** Kandidati/ofertuesi duhet te paraqesë:

- Çertifikaten per menaxhimin e cilesise se punimeve ISO 9001-2008 (e vlefshme) , leshuar nga institucione zyrtarete akredituara per ketë qellim.
- Çertifikate per menaxhimin e mjedisit ISO 14001-2004 (e vlefshme),leshuar nga institucione zyrtarete akredituara per ketë qellim.
- Çertifikate permenaxhimin e shendetit dhe sigurimit ne pune OHSAS-18001-2007 (e vlefshme),leshuar nga institucione zyrtarete akredituara per ketë qellim.
- Çertifikatë PASS 99:2012. (e vlefshme)"Sisteme te menaxhimit te integruar" leshuar nga institucione zyrtarete akredituara per ketë qellim.
- SA 8000: 2014 Per pergjegjesite sociale te lidhura me personelin leshuar nga institucione zyrtarete akredituara per ketë qellim.
- Certifikatë ISO 39001:2012 "Sisteme te menaxhimit te sigurise rrugore (e vlefshme leshuar nga institucione zyrtare te akredituara per ketë qellim.
- Certifikata ISO 50001 -2011 : Per sistemin e menaxhimit te energjise objekt I se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) leshuar nga institucione zyrtarete akredituara per ketë qellim.

**d/1-** Kërkesa e NJHDT që certifikata të jetë për ketë qëllim, është në kundërshtim me LPP dhe e pa argumentuar pasi Certifikatat ISO lëshohen për punën në tërësi të OE dhe jo për kontrata të emërtuara. Ato lëshohen për periudha kohore dhe jo për punime të caktuara.

**d/2-** Sqarojmë se ISO 27001:2013 ka si objekt: specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe vazhdimisht përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit në kontekstin e organizatës. Ajo gjithashtu përfshin kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të

përshtatura për nevojat e organizatës. Kërkesat e përcaktuara në ISO / IEC 27001:2013 janë të përgjithshme dhe kanë për qëllim të jenë të zbatueshme për të gjitha organizatat, pavarësisht nga lloji, madhësia apo natyra. 3 Objekti i prokurimit nuk ka të bëjë me asnjë përcjellje informacioni apo menaxhim informacioni pasi çdo gjë që është e nevojshme për realizimin e këtij projketi është e publikuar dhe nuk përbën aspak informacion sekret apo të klasifikuar. Kjo ISO nuk gjen mbështetje dhe është e panevojshme për ketë objekt prokurimi
Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 30 “Kërkesat e cilësisë”.
**e-** Kandidati/ofertuesi duhet te paraqesë dokumentacion qe vërteton qe per periudhën Janar- 2015dhe Shkurt 2017, ka pasur te punësuar per ketë periudhë mesatarishtjo me pak se 120 punonjës (duke përfshirë edhe stafin tekniko menaxherial ) .
Per ketë , dokumentacioni qe duhet te paraqesë është:
- Vërtetim nga sig shoqërore apo dega tatimeve per numrin e te punësuarve dhe qe u janë paguar detyrimet per kontributet e tyre per muajt e periudhës se mësipërme.
- Liste pagesat e konfirmuar nga administrata tatimore per muajt e kesaj periudhë shoqëruar me formularët e deklarimitte kontributeve te sigurimeve shoqërore dhe shendetesore (FDP),formularët e deklarimit të të ardhurave nga punësimi(TAP).
**e/1- NJHDT** nuk e ka argumentuar numrin e fuqisë punëtore me grafikun dhe volumin e punimeve.
**e/2 K**ërkesa “e konfirmuar nga administrata tatimore” , është në kundërshtim me VKM nr.922, datë 29.12.2014, “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave dhe dokumenteve të tjera tatimore vetëm nëpërmjet formës elektronike”, neni 2, pasi OE ka detyrim vetëm të deklarojë listëpagesat nëpërmjet formës elektronike dhe jo ti konfirmojë ato në administratën tatimore.
**f-** Pjese e stafit teknik te operatorit duhet te jene ; Ing Ndërtimi, 1 Ing Hidroteknik 1, Ing Mjedisi 1, Ing Gjeolog 1, Ing Mekanik 1 , Ing Elektrik 1 , Ing.Gjeodet 1
Per plotesimin e kushtit te mësipërm kerkohet:
1. Sejcili prej pjesetareve te stafit teknik te mësipërm duhet te gjenden ne licensen e shoqerise.
2. Sejcili prej pjesetareve te stafit teknik te mësipërm duhet te gjenden ne liste pagesat e shoqerise
3. Sejcili prej pjesetareve te stafit teknik te mësipërm duhet te ketë kontrate pune te vlefshme me shoqerine.
4. CV dhe diplomat e tyre

**f/1- Sa më sipër kërkesa për 7** drejtues teknik, është i fryrë dhe ul konkurencën në procedurë. OE mund të marrë staf edhe të punësuar me kontratë. Gjithashtu sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor që stafi i punonjësve të jetë i pasqyruar në listëpagesa, **kjo kërkesë kufizon numrin e shoqërive pjesëmarrëse që nuk zotërojnë staf teknik të përhershëm** (gjë që reflektohet në listëpagesat e shoqërisë), por që kanë mundësinë t’a sigurojnë ketë staf, duke lidhur kontrata pune me afat sa afati i kontratës objekt prokurimi.
**g-** Operatoret ekonomike duhet te kene te punësuar minimalisht 6 punonjës te kualifikuar si me poshte:

- 2 Teknik Ndërtimi me kualifikime teknike nga IQT(ISHTI-sot) ose subjekte privatë të akredituara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.
- 2 punonjës elektriçistë me kualifikime teknike IQT(ISHTI-sot) ose subjekte privatë të akredituara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.
- 2 punonjës hidraulikë me kualifikime teknike IQT(ISHTI-sot) ose subjekte privatë të akredituara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Per punonjësit e kualifikuar duhet te paraqitet kontrata individuale e punes e vlefshme per kohëzgjatjen e kontratës qe prokurohet shoqëruar me dëshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik si dhe duhet te figurojnë ne liste pagesat e shoqerise.

2.5.3 Operatoret ekonomike duhet te paraqesin kontrata individuale e punes e vlefshme per kohëzgjatjen e kontratës qe prokurohet dhe dëshmitë e drejtimit per te pakten 6 manovratore te makinerive te renda te cilet duhet te figurojnë ne liste pagesat e shoqerise.

**g/1-** NJHDT nuk e ka argumentuar me volume punimesh dhe grafik kërkesën për këta punonjës të certifikuar.

**h-** 2.6. Dëshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund t`i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës edhe për :

| | | |
|---|---|---|
| Fabrike Asfalto betoni i pajisur me leje mjedisore | Ne pronësi ose me qera | Copë 1 |
| Fabrikeprodhim betoni i pajisur me leje mjedisore | Ne pronësi ose qera | Copë 1 |
| Linjë per prodhim materialesh inerte | Ne pronësi ose qera | Copë 1 |

Per Fabriken e Asfaltit, Linjë per prodhim materialesh inerte dhe fabrikes se betonit duhet te paraqiten dokumentat e pronësise, lejen mjedisore per ushtrim aktivitetit te leshuara nga QKL. Ne rast se janë me qera duhet te paraqitet kontrata e qerase se bashku me aktin e pronësise se qiradhenesit shoqëruar me lejen mjedisore nga QKL. Ne rast se operatori ekonomik ka kontrate furnizimi duhet te paraqitet akti i pronësise se furnizuesit shoqëruar me lejen mjedisore te leshuar nga QKL. Kontrata e qerase dhe e furnizimit duhet te jene noteriale dhe te kene afat vlefshmerie sa kohezgjatja e kontratës qe prokurohet.

**h/1-** Sa më sipër **NJHDT** ka vendosur kërkesë evazive njëherë me pronësi ose qera dhe në vazhdim kontratë furnizimi.

**a-** 2.6.1 Operatori ekonomik pjesemarres duhet te paraqesë kontrate furnizimi noteriale me prodhuesin e shoqëruar me certifikatë ISO per keto zera punimesh:
F.v peme dekorative te shoqëruar me license nga QKL per prodhim ose tregtim te farave dhe fidaneve ne emer te furnizuesit te projektit dhe preventivit .

2.6.2 Operatoret ekonomike duhet te paraqesin kontrate furnizimi noteriale me prodhuesin ose distributorin per materialet elektrike te percaktuara ne preventivin e objektit dhe specifikimet teknike shoqëruar me certifikatë ISO 50001_2011 per keto zera punimesh:
- F.v Shtylla Dekorative per ndricim sipas specifikimeve teknike
- F.v Ndricues Projektor me llampe SAP sipas specifikimeve teknike
- Pllaka e trotuarit 6 cm sipas specifikimeve teknike.

**g/1-** Sa më sipër kjo është një kerkesë e tejkaluar e LPP pasi përmbushja e specifikimeve teknike plotësohet me paraqitjen e deklaratës nga Operatori ekonomik, e cila është pjesë e DT. Kjo kërkesë nuk u përmbahet përcaktimit të dispozitave nënligjore të LPP në hartimin e kritereve për kualifikim, pasi kjo lloj kërkesë nuk është parashikuar në LPP.

**g/2-** Kërkesa për kontrate furnizimi noteriale me prodhuesin ose distributorin, është kërkesë e tejkaluar e LPP, duhej të ishte kontratë paraprake furnizimi, pasi lidhja e kontratës e vendos OE në rast të mosshpalljes fitues përpara detyrimeve kontraktore.

**i-** 2.6.7. Do të organizohet një vizitë në kantier me14.04.2017,ora 11:00, në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familjarizohen me kushtet lokale njohur me ne hollesi projektin dhe krijuar ide te qartae konkretembi organizimin e punes gjate zbatimit punimeve, operatori ekonomiki interesuarduhet të konfirmojë paraprakishtme shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në ketë vizitë. Të gjitha kostot e operatorëve ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër,dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.Operatoret ekonomike pas vizites ne kantier do te pajisen me vërtetim nga bashkia per viziten e kryer te cilin do ta paraqesin si pjese te dokumentave të tënderit.

**i/1-** Vendosja e kësaj kërkese në kriteret e veçanta për kualifikim është në kundërshtim me DST, të miratuara për vitin përkatës. Kjo kërkesë është pjesë e kapitullit **II. Udhëzime për operatorët ekonomikë", Seksioni 1. "Hartimi i ofertës", pika 1.3.**

**Kriteri** Neni 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 dhe neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2.

**Impakti** Përcaktim jo i drejtë i kërkesave për kualifikim.

**Shkaku** Moszbatimi i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik.

**Rëndësia** **I lartë.**

***Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi:*** A.Q., M.B., I.H.

***Komente të ardhura nga subjekti me shkresën nr.2492, datë 25.04.2019, e protokolluar në KLSH me numër 291, datë 24.05.2019.***

1- *Lidhur me pretendimin e grupit të audituesve se kërkesa për pajisje me vërtetim nga Bashkia përbën pengesë dhe frenon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë nuk qëndron për këto arsye*
*Së pari vendosja i këtij kriteri , ne kete procedure prokurimi, eshte teresisht i ligjshem dhe i mbeshtetur ne rregullat e Prokurimit Publik .*
*Aplikimi i ketij kriteri eshte I mbeshtetur ligjerisht per shkak se i jep mundesine K.V.O te skualifikoje operatoret qe mund te jene debitore te natyrave te ndryshme prane AK.*
*Nese nuk do aplikohej ky kriter atehere cdo operatori qofte edhe debitor I lind e drejta te paraqese ankim per skualifikim te paligjshem për shkak se KVO-ja do te perdorte nje kriter i cili nuk eshte percaktuar ne DST.*

***Sqarim:*** Kërkesa e këtij vërtetimi nuk është i ligjshëm dhe aspak i mbështetur në RRPP. Paraqitja e OE për marrje vërtetimi pranë bashkisë, bën me dijë interesimin për pjesmarrje në procedurë. Ju duhej të kërkonit që: ÖE të mos jetë debitor pranë Bashkisë tuaj.

2- Audituesit janë shprehur se njësia e prokurimit në rastin e kontratave të ngjashme ka cilësuar se.... *Kontrata te ngjashme konsiderohen te vlefshme nese zerat kryesore te punimeve kane volume te konsiderueshme krahasimore me keto te përcaktuara per kete prokurim*.

Sipas audituesve përcaktimi"Volume të krahasueshme"është përtej përcaktimeve të neneve 26 dhe nenit 28 të VKM nr.914,datë 29.12.2014"Rregullat e Prokurimit Publik"ku përcaktohet se autoriteti kontraktor kërkon punë të ngjashme por edhe të faktit se vendosja ndikon drejtperdrejt në kufizimin e konkurrencës.

Vendosja e këtij kriteri është në përputhje të plotë dhe konform nenit 26 të LPP.

Njësia e prokurimit në vendosjen ketij kriteri ka pasur për qëllim që KVO-ja të provojë që operatori ekonomik pjesëmarrës zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme te puneve në objekt por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në kontratën objekt prokurimi.

***Sqarim:*** Ju sqarojmë se këtë kriter e keni vendosur jo në përputhje me kërkesat e Nenit 26 "Kontratat për punë publike", të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pika 6, ku është përcaktuar se:

"6. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.".

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

**Në të cilin nuk flitet për volume të krahasueshme.**

3- Në lidhje me komentin tuaj mbi kategoritë e licenses NP9 "*Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime"* komenti i juaj nuk ka prova dhe fakte të reja për rrjedhojë nuk merret në konsideratë.

4- Në lidhje me komentin tuaj mbi certifikatat ISO se "Referuar pretendimit të audituesve se njësia e prokurimit për çertifikatat 9001,14001,18001,PASS 99:2012,8000,390001,ka kërkuar të jëtë për këtë qëllim është e gabuar për shkak se njësia e prokurimit ka shprehur qartësisht se termi"për këtë qëllim"bën fjalë që institucionet të cilat lëshojnë këto ISO të jenë të akredituara ,pra të njihen si organizëm i cili është i akredituar dhe që ka tagër të lëshojë këto certifikata në përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri ka qënë që çertifikatat ISO të kërkuara të jënë të lëshuar nga një organizëm i akredituar.

Përsa i përket pretendimit se çertifikata ISO 27001:2013 nuk është një çertifikatë e lidhur me objektin e prokurimit theksojmë se kjo çertifikatë nuk është kërkuar nga njësia e prokurimit në kriteret e veçanta të kualifikimit por me siguri është një harresë nga ana e audituesit ku mund të jetë punuar materiali.

Sjellim në vëmendje dhe vlen të theksojmë se njësia e prokurimit nuk mund të mbajë përgjegjësi për një kriter të pakërkuar në DST" .

**Sqarim:** Komenti juaj nuk merret në konsideratë, pasi ju e keni këtë kërkesë se certifikata te jete per qëllimin e prokurimit pra të objektit.

5- Në lidhje me komentin tuaj se: Së pari vendosja e këtij kriteri pra disponimi nga ana e operatorit ekonomik prej 120 punonjësish është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik dhe konkretisht …. Nenit 46, pika 1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. Numri i punonjesve

eshte percaktuar nisur nga shuma e oreve te punes te nevojshme per kryerjen e punimeve ,perllogaritur per cdo ze punimi sipas oreve te punes per njesi .Kjo vlere ne total eshte rreth 55 670 ore pune. Referuar Kodit te Punes ,nje punonjes punon 176 ore ne muaj , dhe ne nje afat tre mujor sipas grafikut te punimeve , numri i punetoreve per te realizuar objektin perllogaritet ne 105 punetore ne muaj.

Gjithashtu ,duke iu referuar edhe faktit se fondi limit i përcaktuar për këtë proçedurë prokurimi është 92 939 507 lekë (pa tvsh), kerkesa qe numri i punonjesve të jetë 120 punonjës ku përfshihet dhe stafi drejtues dhe menaxherial eshte e kerkese e vendosur ne perputhje me ligjin , objektin e prokurimit,dhe në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës .

**Sqarim:** Ju sqarojmë se ju nuk keni bërë zberthimin e preventivit për të nxjerrë numrin e punonjësve sipas zërave të manualit, pra nuk e keni të argumentuar këtë numër në procesverbalin e hartimit të DT, por e keni bërë në komente.

6- Në lidhje me komentin se: Referuar pretendimit mbi listëpagesat e konfirmuara citojmë se ky pretendim nuk qëndron për shkak se formulimi i konfirmuar nga Administrata Tatimore nuk nënkupton marrjen e firmës dhe vulosjen me vulë të njomë të listëpagesave të operatorëve ekonomikë nga ana e Tatimeve por përfshirjen në kriter edhe nëpërmjet formës elektronike.Për më tepër paraqitja e listëpagesave nga ana e OE nëpërmjet listëpagesave elektronike nuk ka shërbyer dhe nuk është konsideruar në asnjë rast nga ana e KVO si arsye për skualifikim për operatorët ekonomikë nga proçedurat e prokurimit të zhvilluara nga ana e AK Bashkia Librazhd.

**Sqarim:** Në asnjë rast nga ana e grupit të auditimit nuk është konstatuar që ka shërbyer si shkak s`kualifikimi.

7- Së pesti në aktin e konstatimit audituesit janë shprehur se kërkesa e njësisë së prokurimit që pjesë e stafit teknik të jenë 7 drejtues teknik Ing Ndertimi 1(nje)Ing Hidroteknik 1 (nje)Ing Mjedisi 1 (nje)Ing Gjeolog 1 (nje)Ing Mekanik 1 (nje)Ing Elektrik 1 (nje)Ing.Gjeodet 1 (nje) është një kërkesë e fryrë e cila ul konkurrencën në një proçedurë prokurimi si dhe kërkesa që stafi i punonjësve të jetë i pasqyruar në listëpagesa kufizon numrin e pjesëmarresve të cilët nuk zotërojë staf teknik të përhershëm.

Në nenin 26 pika 8 gërma “a” dhe “b” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomiktë nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”

Sqarojmë se përcaktimi i numrit të kërkuar të drejtuesve teknikë nuk është i fryrë por është bërë në përputhje me natyrën e punimeve si dhe kategorive të liçensës të kërkuar për këtë objekt prokurimi.

Gjithashtu , sqarojme se duke u bazuar në VKM nr.42 datë 16.01.2008 zotërimi i kategorive të punimeve të zbatimit në liçensat e shoqërisë të ndërtimit mbështetet në profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

**Sqarim:** Kërkesa e stafit, pra drejtuesve teknke prej 7 vetësh është kërkesë e fryrë e paargumentuar nga ana e juaj në procesverbalin e hartimit të DT. Sqarime të mëtejshme janë në aktkonstatimin përkatës.

8- në projektraportin e auditimit, audituesit janë shprehur se njësia e prokurimit gjithashtu ka kërkuar 6 punonjës.si elektricistë ,teknik ndërtimi,2 punonjës hidraulikë

si dhe 6 manovratorë të mjeteve të rënda për të cilën nuk është argumentuar me volume punimesh dhe grafik për këta punonjës të çertifikuar.
Mbështetur në nenin neni 26 pika 8 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 , ku shprehimisht thuhet ;Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:
a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Vendosja e këtij kriteri është një kërkesë proprocionale me objektin e prokurimit përsa kohë që në preventivin e punimeve të procedurës së prokurimit janë parashikuar kryerjen e punimeve elektrike,(F. percjelles ppv 2x1.5 mm2, F.V ndricues tip sodium 250ë IP 65 ITINERA, F.V elektroda tokezimi L=1.5 m etj),punimeve hidraulike si (F.V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 m, ndertim puseta KUZ (1x1x2)m F.V tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=75 m, t=5.2 mm PN 10, Ndertim puseta uj.bardha+zgara metalike (40x60)etj, apo punime ndërtimi si (p.sh heqje betoni, thyerje bordurash, gërmime me volume të konsiderueshme).
Pra duke u nisur edhe nga zërat e punimeve të parashikuara në preventiv si edhe nga vlera e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit ka parë të domosdoshme që pjesë e stafit të operatorit ekonomik duhet të jenë elekriçistë, manovrator, teknik ndërtimi, hidraulikë me qëllim verifikimin e kapaciteteve të shoqërive pjesëmarrëse, të cilët duhet të vërtetojnë se disponojë personel të pajisur me kualifikimet përkatëse me qëllim zbatimin e kontratës në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara nga AK.

**Sqarim:** Ju sqarojmë se këto argumentime që ju bëni në komentet tuaja duhej të ishin bërë në procesverbalin e hartimit të dokumenteve të tenderit, gjë të cilin ju nuk e keni bërë, por thjesht ju keni listuar kërkesat pa i argumentuar ato.

9- Në lidhje me fabrikat e asfakto betonit e linjë për prodhim materiale inerte argumentimi i juaj nuk qendron pasi ne DT ju e keni evazive.
10- Në lidhje me vertifikatën iso për menaxhimin e energjise argumentimi eshte dhene ne aktkonstatim dhe argumentimi juaj se se ato janë për ndricim rrugor është jashtë objetit të kësaj certifikate.
11- Në lidhje me vizitën në kantier ku ju argumentoni se në asnjë moment në kriter njësia e prokurimit nuk ka cilësuar që mosparaqitja në kantier do të përbëjë arsye për skualifikim për operatorët pjesëmarrës dhe për rrjedhojë ky kriter nuk është përdorur as nga ana e KVO si arsye skualifikimi. Ju sqarojmë se ju nuk duhej ta kishuit vendosur tek kriteret per kualifikim.

**Gjetje nr. 18: KLSH konstatoi se** procedurën e prokurimit me objekt: **"Rikualifikim urban, Blloku i banimit nr.1, të qytetit të Librazhdit"** , me të dhënat sa vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Urdhër prokurimi** Nr. 25, date 23.06.2016<br>**Procedura prokurimit** – e hapur<br>**Fondi limit**:111,470,047 lekë<br>**2016-** 55,735,023 lekë<br>**2017** – 55,735,023 lekë<br>**Burimi i financimit**: FZHR | **NJHDT** Nr. 25, date 23.06.2016<br>A.Q.<br>M.B.<br>B.A. | KVO<br>Nr. 26, date 23.06.2016<br>- L.S.<br>- E.A.<br>- S.K. |
| **Data e hapjes:**17.08.2016 | **OE Fitues:** "E..." shpk & "L..." shpk | Kontrata Nr. 5484, datë 14.10.2016 |
| **OE:**<br>Pjesemarres2 | **Diferenca me fondin limit** 738,476 leke. | Miratimi i procedurës, datë 08.09.2016. |

| | | |
|---|---|---|
| s`kualifikuar1<br>kualifikuar 1 | **Oferta Fituese** 110,731,571 lekë<br>**Titullari AK**:Nëpunësi Autorizues K.G. | Vlera e kontratës: 132,877,885 lekë me tvsh |

Rezultuan kërkesa në kundërshtim me nenin 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 dhe neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2.

**Situata** **Në DT janë kërkuar:**

**a-** Vërtetim për mospasje detyrime tatimore apo penalitete nga Bashkia Librazhd. "Vërtetim lëshuar nga Bashkia Librazhd".

**a/1-** Në vendosjen e këtij kriteri NJHDT ka vepruar në kundërshtim me nenin 46, pika 1, e LPP. Legjislacioni i prokurimit publik kërkon që kriteret e kualifikimit duhet të jenë të qarta dhe të mirë përcaktuara nga AK, me qëllim që të jenë sa më të mirkuptueshme jo vetëm nga OE por edhe në funksion të procesit të vlerësimit. AK ka informacionin e nevojshëm në lidhje me detyrimet që OE mund të kenë në Bashkin. Në ketë kuptim kërkesa e AK për paraqitjen e këtij vërtetimi konsiderohet e panevojshmedhe pengesë për ofertuesit pjesmarrës në ketë procedurë. Gjithashtu kjo kërkesë frenon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit public.

**b-** Janë kërkuar "Licensa profesionale edhe në në kategoritë:

- NP1 B Punime gërmimi në tokë.
- NP12 C Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS19 A Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë.

**b/1**- Nga ku rezulton se:

- **NP1 B, Punime gërmimi në tokë.** Është kërkuar kategoria **B** kur vlera e punimit sipas zbërthimeve të bëra me kërkesën e grupit të auditimit është në shumën 18,693,761 lekë, sipas preventivit.
- **NP12 C, Punime të inxhinierisë së mjedisit.** Është kërkuar kategoria **B** kur vlera e punimit sipas zbërthimeve të bëra nme kërkesën e grupit të auditimit është në shumën 2,770,592 lekë.
- **NS19 A, Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë.** Nuk ka punime të tilla në preventivin e punimeve.

**Ankimim për Dokumentet e Tenderit:**

**OE "V...." shpk**, e protokolluar në Bashkinë Librazhd me numër 3855, datë 06.07.2016, i cili ankimohet për sa vijon:

**a-** Të hiqet muaji qershor 2016.

**b-** Për certifikatën ISO 50001 – 2011, pasi pavarëshisht se ka punime elektrike këto përfshihen në kategorinë e licensës NP11. Kjo ISO nuk ka lidhje me ketë prokurim.

**c-** Në lidhje me kërkesës IQT/ ISHTI duhet ta vendosni edhe ekulivalente.

**d-** Kërkesa për të qenë në listë pagesë një inxhinier restaurator për minimalisht tre muajt e fundit, OE mund ta marri dhe me kontratë për ketë procedurë.

**e-** Nuk ka nevojë për ekspert kundër zjarrit.

Nga ana e **Titullari Autoritetit Kontraktor** ka dalë urdhër pezullimi i procedurës nr.395, datë 06.07.2016. Për shqyrtimin e ankesës është ngarkiuar KVO e përbërë nga: L.S., E.A., S.K.

| | |
|---|---|
| | Me relacionin nr.3859, datë 06.07.2016, ky komision ka vendosur të mos marrë në konsideratë ankesën e OE.<br>Kthim përgjigje ankimuesit me shkresën nr.3855/1, datë 06.07.2016.<br>**Ankimim ne KPP. OE "V...." shpk,** ka vazhduar ankimimin e tij në KPP, i protokolluar ky ankimim në AK me numër 1677, datë 18.07.2016.<br>KPP me Vendimin nr.1677/1, datë 20.07.2016, ka dhënë urdhër për pezullim procedure prokurimi dhe shqyrtimi në themel.<br>KPP me vendimin nr.592/2016, datë 02.08.2016 ka vendosur: "*Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "V..." sh.p.k. për prokurimin "Procedurë e Hapur" me nr. REF-43542-06-28-2016 me objekt "Rikualifikim urban, blloku banimit nr.1 qyteti Librazhd" me fond limit 111,470,047 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datë 22.07.2016 nga autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd ."*.<br>Kjo ankesë është marrë në konsideratë vetëm për IQT ose ekuivalente dhe afatin 3 mujor në listepagesë për restauratorin..<br>Bashkia Librazhd me shkresën nr.4410/1, datë 08.08.2016, i ka dërguar informacion KPP për ndryshimet e rekomanduara.<br>Me vendimin nr.592/3/2016, KPP në mbështetje te nenit 19/1 e vijues të LPP dhe nenit 28 të VKM nr.184, datë 17.03.2010, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KPP", ka hequr pezullimin e procedurës së prokurimit. |
| **Kriteri** | Neni 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 dhe neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2. |
| **Impakti** | Përcaktim jo i drejtë i kërkesave për kualifikim. |
| **Shkaku** | Moszbatimi i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik. |
| **Rëndësia** | **I lartë.** |

***Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi:* A.Q., M.B. dhe B.A.**

***Komente të ardhura nga subjekti me shkresën nr.2492, datë 25.04.2019, e protokolluar në KLSH me numër 291, datë 24.05.2019.***

Grupi audituesve kanë konstatuar si gjetje se njësia e prokurimit ka kërkuar kategoritë e mëposhtme të punimeve

1.NP1B,Punime Gërmimi në tokë

2.NP12C Punime të inxhinierisë së mjedisit.

3.NS 19A Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë

Nga ku rezulton se NP1 B punime gërmimi në tokë sipas zbërthimevetë bëra me kërkesën e grupit të auditimit është në shumën 18,693,761 lekë sipas preventivit.

NP12C Punime të inxhinierisë së mjedisit është kërkuar kategoria B kur vlera e punimit sipas zbërthimeve të bëra është në shumën 2,770,592 lekë.

NS 19A Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë nuk ka punime të tilla në preventiv.

NP1 B Klasifikimi B per kete kategori eshte percaktuar sakte dhe ne zbatim te VKM nr.42 date 16.01.2008 ,klasifikimi eshte sipas vlerave ne leke te punimeve te kryera per cdo kategori punimi. Vlera e punimeve sipas legjislacionit tatimor shqiptar eshte vlera e ndertimit duke perfshire edhe TVSH-ne .Per kategorine NP1 , vlera e punimeve te kryera eshte 22,432,512 leke ,pra mbi 20,000.000 leke , kurse vlera 18,693,761 e cilesuar nga audituesit eshte vlera e ketyre punimeve pa tvsh.

NP12 C Punime të inxhinierisë mjedisore. ***Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor****, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.*
Vlera 2,770,592 lekë pa tvsh e cilesuar nga audituesit , ose 3,324,709 leke me TVSH , eshte vlera e punimeve vetem per sa e takon punimeve per mbjellje peme , bari ,etj , si zera specifike ne preventiv. Punime te inxhinierise se mjedisit perfshijne edhe ***mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor*** sic jane te gjitha punimet e kryera per kete objekt prokurimi, si rehabilitimi e rrugeve apo shesheve, rehabilitimi e lulishteve etj. Procesi e riaftesimit natyror apo aktiviteteve te tjera mjedisore perfshin te gjitha punimet e nevojshme ndertimore ose rikonstruksioni te veprave inxhinierike .
N.S - 19 A Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë ***Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër**, **mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore,** hekurudhore, **të barrierave metalike** betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zëizoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve.*
Edhe kjo kategori punimi eshte kekuar bazuar ne te dhenat e objektit te prokurimit dhe ne zbatimit te VKM nr.42, pasi objekti “Rikualifikim urban blloku i banimit nr.1” do te ndertohet ne nje qender urbane dhe mjaft te populluar.
Ne preventiv zera punimesh te cilat nga menyra e zbatimit te punimeve realizojne eleminimin e zhurmave te automjeteve ne rruge. Keshtu edhe vendosja e konstruksioneve metalike ne ane te rruges *(F.V zgara dekorativa hekuri me figuracion dekorativ)* apo edhe shtresat rrugore duhet te plotesojne kushtet per eleminimin e zhurmave nga mjetet motorike.
**Sqarim:** Ju sqarojmë se ju nuk e keni argumentuar këtë pikë, nuk merret në konsideratë.

**C/ 1.4. Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.**
KLSH auditoi zbatimin e 7 kontratave të ndërtimit ku u konstatua një dëm ekonomik në shumën **1,483,680 lekë pa TVSH** sa vijon:
**a.** “Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)” (dëmi ekonomik **307,200 lekë pa TVSH);**
**b.** “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza II)” (dëmi ekonomik **249,200 lekë pa TVSH);**
**c.** “Rikonstruksion i kanaleve vaditës në Bashkinë Librazhd për vitin 2018”;
**d.** “Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)”) (dëmi ekonomik **267,804 lekë pa TVSH);**
**e.** “Rikualifikimi urban blloku i banimit nr. 1, qyteti Librazhd” (dëmi ekonomik **152,256 lekë pa TVSH);**

**f.** “Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres” (dëmi ekonomik **262,220 lekë pa TVSH)**
**g.** “Rehabilitim Urban, Zona në hyrjen perendimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore” (dëmi ekonomik **245,000 lekë pa TVSH)**

**Konkretisht gjetjet nga auditimi i kësaj pike të programit të auditimit janë:**

**a-** Zbatimi i kontratës me objekt: **“Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)”.**

**Gjetje nr. 19: KLSH konstatoi se** nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt : “Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)”, u konstatua se zërat e punimeve si vijon: Germim dheu me krah e transport me k. Dore 10 m, kategoria IV; Kollona të plota b/a C 16/20 të parapërgatitura dhe F.V Hekur betoni periodik ø 6-10 mm, janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **307,200 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

<table>
<tr><td>Situata:</td><td>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt : “Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga Z. K.G. dhe Bashkimit të Operatorëve “B...” SHPK (65%) përfaqësuar nga administratori z. H.I. & OE “C...” shpk dhe nga Z. F.C. (35%) u konstatua se zërat e punimeve si vijon: Germim dheu me krah e transport me k. Dore 10 m, kategoria IV; Kollona të plota b/a C 16/20 të parapërgatitura dhe F.V Hekur betoni periodik ø 6-10 mm, janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën 307,200 lekë pa TVSH duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Konkretisht në këto zëra punimesh:
<table>
<tr><th>Nr. Ana</th><th>Përshkrimi i punimeve</th><th>Njësia</th><th>Sasia</th><th>Çmimi</th><th>Vlera</th></tr>
<tr><td>2.1/a</td><td>Germim dheu me krah e transport me k. Dore 10 m, kategoria IV</td><td>m$^3$</td><td>7</td><td>1100</td><td>7700</td></tr>
<tr><td>2.147</td><td>Kollona të plota b/a C 16/20 të parapërgatitura</td><td>Copë</td><td>20</td><td>12500</td><td>250000</td></tr>
<tr><td>2.166</td><td>F.V Hekur betoni periodik ø 6-10 mm</td><td>ton</td><td>0.5</td><td>110000</td><td>49500</td></tr>
<tr><td></td><td colspan="4">Shuma në lekë pa TVSH</td><td>307,200</td></tr>
</table></td></tr>
<tr><td>Kriteri:</td><td>Kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi si dhe me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.</td></tr>
<tr><td>Ndikimi</td><td>Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës në shumën 307,200 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>Shkaku:</td><td>Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara.</td></tr>
<tr><td>Rëndësia:</td><td>I mesëm.</td></tr>
<tr><td>Rekomandime:</td><td>Nga Bashkia Librazhd të merren masa, që t’i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “B...” SHPK & “C...” shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës 307,200 lekë pa TVSH, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)”.</td></tr>
</table>

**Gjetje nr.20:** KLSH nga auditimi konstatoi se në zbatimin e punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt "Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)" të lidhur Autoritetit Kontraktor Baskisë Librazhd dhe BOE "B..." SHPK & "C..." shpk, aktualisht nuk është e montuar pajisja "Impianti i klorifikimit të ujit të pishëm" me vlerë 351,549 lekë pa TVSH si dhe nuk është realizuar pika e lidhjes për furnizimin me energji elektrike të dhomës së komandimit, duke shkaktuar Efekt negativ nga mos vendosja e impiantit të klorifikimit të ujit.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | Në zbatimin e punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt "Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)" të lidhur Autoritetit Kontraktor Baskisë Librazhd dhe BOE "B..." SHPK & "C..." shpk, aktualisht nuk është e montuar pajisja "Impianti i klorifikimit të ujit të pishëm" me vlerë 351,549 lekë pa TVSH si dhe nuk është realizuar pika e lidhjes për furnizimin me energji elektrike të dhomës së komandimit, duke shkaktuar Efekt negativ nga mos vendosja e impiantit të klorifikimit të ujit. |
| **Kriteri:** | Nga auditimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi. |
| **Ndikimi** | Efekt negativ duke rritur vlerën e kontratës. |
| **Shkaku:** | Mos lidhje e impiantit për mungesë energjie elektrike. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandime**: | Nnga Bashkia Librazhd të merren masa, që t'i kërkohet BOE "B..." SHPK & "C..." shpk, përfaqësuar nga OE "B..." SHPK, lidhja e energjisë elektrike si dhe montimi sipas projektit të zbatimit dhe preventivit në zbatimin të detyrimeve kontraktuale të zbatuesit të punimeve. |

**Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:**
1. Mbikqyrësi i punimeve "Zenit-06" SHPK, nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në: ***Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7;* ***Kontratën** për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt* "Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)" *të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe BOE* "B..." SHPK & "C..." SHPK *dhe* ***UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*

**b-** Zbatimi i kontratës me objekt: **"Ndërtimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza II)".**

**Gjetje nr. 21:** KLSH nga auditimi konstatoi se në zbatimin e punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: Ndërtimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza II), të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga Z. K.G. dhe Operatorit Ekonomik "B..." SHPK (65%) përfaqësuar përfaqësuar nga administratori z. K.I. u konstatua se zëri i punimeve, "**2(3.30/c) Gërmim shkëmbi me krahë , në seksion të detyruar, h=1.5 m, shkëmb i fortë,** është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **249,200 lekë pa TVSH**

duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | Në zbatimin e punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: Ndërtimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza II), të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga Z. K.G. dhe Operatorit Ekonomik "B..." SHPK (65%) përfaqësuar përfaqësuar nga administratori z. K.I. u konstatua se zëri i punimeve, "**2(3.30/c) Gërmim shkëmbi me krahë , në seksion të detyruar, h=1.5 m, shkëmb i fortë,** është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **249,200 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Argumentimi i kësaj diference në volume punimesh, pasqyrohet si vijon:<br>Degëzimet për furnizimin me ujë sipas lagjeve, Dj = 63 mm, Dj = 50 mm, Dj = 40 mm, Dj = 32 mm, Dj =25 mm.<br>Zëri 2(3.30/c) Germim shkëmbi me krahë , në seksion të detyruar , h=1.5 m, shkëmb i fortë.<br>Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 3914.56 m3 germim shkëmbi me çmim 1,400 lekë. Libreza e masave pasqyron volumin 3914.56 m3 germim shkëmbi të zbërthyer në mënyrë analitike: Nga auditimi projektit të zbatimit të azhurnuar si dhe nga auditimi në objekt u konstatua se është realizuar volumi 3736.56 m3 germim shkëmbi dhe jo 3914.56 m3 germim shkëmbi. Për sa më sipër trajtuar diferenca prej 178 m3 germim shkëmbi është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga shoqëria "B..." SHPK, në vlerën 249,200 lekë pa TVSH [178 m3 x 1,400 lekë/m3 ]. |
| **Kriteri:** | Kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi si dhe me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar. |
| **Ndikimi** | Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës në shumën **249,200 lekë pa TVSH**. |
| **Shkaku:** | Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandime**: | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t'i kërkojë Operatorit Ekonomik "B..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **249,200 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Ndërtimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza II)". |

**Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:**

1. Mbikëqyrësi i punimeve "E..." SHPK, nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

- ***Ligjin nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7.*

- ***Kontratën** për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt* “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza II)” *të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe BOE* “B...” SHPK & “C...” SHPK.
- ***UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*

2. Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt u konstaua se janë kryer punime më shumë, mbi shtrirjen e tubave dhe konkretisht, për Dj = 63 mm, Dj = 50 mm, Dj = 40 mm, Dj = 32 mm, Dj =25 mm.

**c-** Zbatimi i kontratës me objekt: **“Rikonstruksion i kanaleve vaditës në Bashkinë Librazhd për vitin 2018”.**

Kontrata e zbatimit me objekt : “Rikonstruksion i kanaleve vaditës në Bashkinë Librazhd për vitin 2018”, është lidhur me datë 04.06.2018 dhe nr. prot. 2830, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga Z. K.G. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “R..G...” SHPK përfaqësuar nga administratori (përfaqësues ligjor) z. T.K. dhe “E...” SHPK përfaqësuar nga z. F.B. Vlera e kontratës bazë është 19,778,746 lekë pa TVSH. Afati i realizimit të punimeve do të jetë 40 ditë nga data e fillimit të punimeve. Periudha e garancisë do të jetë 12 muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.
Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera deri në periudhën e auditimit, nuk rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera.

**d-** Zbatimi i kontratës me objekt: **“Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)”).**

**Gjetja nr. 22** KLSH nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)”, u konstatua se zëri i punimeve, “Zëri (An-9) Mbushje me zhavorr pas mureve”, është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **267,804 lekë pa TVSH duke** shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

<table>
<tr><td>Situata:</td><td>nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)”, u konstatua se zëri i punimeve, “Zëri (An-9) Mbushje me zhavorr pas mureve”, është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën 267,804 lekë pa TVSH duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.<br>Argumentimi i kësaj diference në volume punimesh, pasqyrohet si vijon:<br>Punime germimi<br>Zëri (An-9) Mbushje me zhavorr pas mureve.<br>Preventivi i ndryshuar brenda kontratës bazë pasqyron volumni 452 m$^3$ mbushje me zhavorr, me çmim 1000 lekë.<br>Situacioni përfundimtar, pasqyron volumni 452 m$^3$ mbushje me zhavorr, me çmim 1000 lekë.<br>Libreza e masave paraqet volumin 452.25 m$^3$ mbushje me zhavorr të zbërthyer në mënyrë analitike sipas tabelës:
<table>
<tr><th>Përshkrimi i mbushjeve me zhavorr</th><th>Gjatësi</th><th>lartësi</th><th>Gjerësi</th><th>volumi</th></tr>
<tr><td>G-TH-1-Prog 179 deri prog. 183</td><td>78.86</td><td>1.60</td><td>0.30</td><td>37.85</td></tr>
<tr><td>G-TH-2-Prog 115 deri prog. 117</td><td>250</td><td>1.60</td><td>0.30</td><td>120.00</td></tr>
<tr><td>G-TH-1-Prog 92 deri prog. 96</td><td>96</td><td>1.60</td><td>0.30</td><td>46.08</td></tr>
</table></td></tr>
</table>

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| G-TH-1-Prog 90 deri prog. 92 | 32.60 | 1.60 | 0.30 | 15.65 |
| G-TH-1-Prog 84 deri prog. 91 | 163.50 | 1.60 | 0.30 | 78.48 |
| G-TH-1-Prog 23 deri prog. 24 | 19.10 | 1.60 | 0.30 | 9.17 |
| G-TH-1-Prog 15 deri prog. 23 | 192.10 | 1.60 | 0.30 | 92.21 |
| G-TH-1-Prog 10 deri prog. 15 | 110 | 1.60 | 0.30 | 52.80 |
| **Shuma ne $m^3$** | | | | **452.24** |

Në fakt nga verifikimi mbi realizimin e punimeve në objekt, rezulton që:
- Zëri mbushje me zhavorr pas mureve, për prog 115 dei prog 117 nuk është realizuar fare në objekt si vijon:

| Përshkrimi i mbushjeve me zhavorr | Gjatësi | lartësi | Gjerësi | volumi |
|---|---|---|---|---|
| G-TH-2-Prog 115 deri prog. 117 | 250 | 1.60 | 0.30 | 120.00 |

Pra, sipërmarrësi i punimeve ka përfituar në mënyrë të pa drejtë shumën **120,000 lekë pa TVSH** (120 $m^3$ x 1000 lekë).

- **Zëri (An-9) Mbushje me zhavorr pas mureve,** është realizuar në kundërshtim me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) dhe me kushtet e kontratës së nënshkruar, sepse mbushja me zhavorr pas mureve nuk është realizuar me material sipas specifikimeve teknike të përcaktuara, por është përdorur shkëmb i gërmuar më parë. Ky material i përdorur i përket zërit të punimeve 3.353 "Mbushje me shkëmb të gërmuar më parë" me çmim 637 lekë. Pra ky zë është rezlizur në shumën 304,196 lekë (452 $m^3$ x 673 lekë) dhe jo në shumën 452,000 lekë ( 452 $m^3$ x 1000 lekë). Sa më sipër sipërmarrësi i punimeve OE "V..." SHPK ka përfituar në mënyrë të pa drejtë 147,804 lekë pa TVSH (452,000 lekë – 304,196 lekë).

**Kriteri:**

- ***Ligjin nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8,* <u>*ku përcaktohet se*</u>*: " ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e Librazhderialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...".*
- ***Kontratën e zbatimit*** *me objekt* "Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Librazhd, përfaqësuar nga Z. K.G. dhe OE "V...." SHPK përfaqësuar nga administratori Z. K.H.
- **Udhëzimin Nr. 2**, *datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3* <u>*ku përcaktohet se*</u>*: "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, dhe kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...".*

**Ndikimi** Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës në shumën **267,804 lekë pa TVSH**.

**Shkaku:** Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara.

**Rëndësia**: I lartë.

**Rekomandime**: Nga Bashkia Librazhd të merren masa, që t'i kërkojë Operatorit Ekonomik Operatorit Ekonomik "V..." SHPK përfaqësuar nga administratori z. K.H, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **267,804 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)".

**Gjetje nr. 23:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: "Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik "V..." SHPK përfaqësuar nga administratori z. K.H., u konstatua se, në progresivin Prog. 3+693 deri prog. 3+713, për gjatësinë 20 m dhe gjerësi 4 m, shtresat asfaltike kanë çeduar, duke shkaktuar një efekt negativ në shumën 182,000 lekë.
- Shtresë binderi me zall lavatriçe, 5 cm me makineri 80 m$^2$ x 1275 lekë = 80,000 lekë
- Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe, 3 cm me makineri 80 m$^2$ x 1000 lekë = 102,000 lekë
Për sa më sipër realizimi i punimeve me cilësi të dobët, është në kundërshtim me DST dhe kontratën dy palëshe të nënshkruar.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | U konstatua se, në progresivin Prog. 3+693 deri prog. 3+713, për gjatësinë 20 m dhe gjerësi 4 m, shtresat asfaltike kanë çeduar, duke shkaktuar një efekt negativ në shumën 182,000 lekë.<br>- Shtresë binderi me zall lavatriçe, 5 cm me makineri 80 m$^2$ x 1275 lekë = 80,000 lekë;<br>- Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe, 3 cm me makineri 80 m$^2$ x 1000 lekë = 102,000 lekë; |
| **Kriteri:** | DST, kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi. |
| **Ndikimi:** | Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës. |
| **Shkaku:** | Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandime**: | Bashkia Librazhd t'i kërkojë shoqërisë "V..." SHPK, të marrë masa për riparimin e defekteve të konstatuara në shtresat asfaltike, si dhe të realizojë riparrimin e tyre në përputhje me specifikimet teknike brenda periudhës së garancisë së defekteve.<br>Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa që në vazhdimësi për kryerjen e procesit të kolaudimit, të ngrejë grupin brenda 30 ditëve nga data e deklarimit të përfundimit të punimeve nga zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve. |

**Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:**
1. Mbikqyrësi i punimeve "Z..." SHPK, nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:
- ***Ligjin nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7.*
- ***Kontratën*** *për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt* "Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)" *të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe OE* "V...." SHPK.
- ***UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 .*

**e-** Zbatimi i kontratës me objekt: : **"Rikualifikimi urban blloku i banimit nr. 1, qyteti Librazhd":**

**Gjetja nr. 24:** KLSH nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: "Rikualifikimi urban blloku i banimit nr. 1, qyteti Librazhd", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga Z. K.G. dhe Bashkimit të

Operatorëve Ekonomik “E...” SHPK & “L...” SHPK, përfaqësuar nga OE “E...” SHPK me administrator z. N.B., u konstatua se është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **152,256 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikualifikimi urban blloku i banimit nr. 1, qyteti Librazhd”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga Z. K.G. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “E...” SHPK & “L...” SHPK, përfaqësuar nga OE “E...” SHPK me administrator z. N.B., u konstatua se zëri i punimeve, “Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m$^2$ (rruga e policisë dhe rruga Arbëria)”, është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **152,256 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, e argumentuar si vijon:<br>**Punime rehabilitimi në rrugë.**<br>**Zëri (An) Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m$^2$ (rruga e policisë dhe rruga Arbëria).**<br>Në situacionin përfundimtar sasia e këtij zëri është 4758 m$^2$ spërkatje me emulsion bituminoz me çmim 120 lekë/m$^2$. Libri i masave pasqyron 4758 m$^2$ spërkatje me emulsion bituminoz: Ky zë punimi (3.226/1) në analizat teknike të punimeve të ndërtimit VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (manuali i çmimeve) është i përfshirë në zërat e punës “Shtresë binderi” dhe “Shtresë asfaltobetoni” dhe konkretisht më çmim 88 lekë/m$^2$ me spërkatje 0.5 l/m$^2$. Nisur nga ky fakt, ky zë pune duhej të ishte situacionuar me çmim 88 lekë jo 120 lekë dhe për pasojë, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria përfaqësuese e BOE “E...” SHPK, në shumën 152,256 lekë pa TVSH [ 4758 m$^2$ x 32 lekë]. |
| **Kriteri:** | **Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:**<br>- ***Ligjin nr. 8402****, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, <u>ku përcaktohet se</u>: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.*<br>- ***Kontratën e zbatimit*** *me objekt “*Rikualifikimi urban blloku i banimit nr. 1, qyteti Librazhd”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Librazhd, përfaqësuar nga Z. K.G. dhe BOE “E...” SHPK përfaqësuar nga administratori Z. N.B.<br>- ***Udhëzimin Nr. 2****, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 <u>ku përcaktohet se</u>: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, norLibrazhd e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.* |
| **Ndikimi** | Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës për **152,256 lekë pa TVSH**. |
| **Shkaku:** | Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara. |

| | |
|---|---|
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandimi**: | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t'i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "E..." SHPK & "L..." SHPK, përfaqësuar nga OE "E..." SHPK me administrator z. N.B., duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **152,256 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt **"**Rikualifikimi urban blloku i banimit nr. 1, qyteti Librazhd**".** |

**Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:**
1. Mbikqyrësi i punimeve "E..." SHPK, nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:
- ***Ligjin nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7.*
- ***Kontratën*** *për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt "*Rikualifikimi urban blloku i banimit nr. 1, qyteti Librazhd" *të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe BOE* "E..." SHPK.
- ***UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*

**f-** Zbatimi i kontratës me objekt: **"Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres".**

**Gjetja nr.25:** KLSH nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: "Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres", janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **262,220 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: "Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga Z. K.G. dhe Operatorit Ekonomik "V..." SHPK përfaqësuar nga administratori (përfaqësues ligjor) z. F.K., u konstatua se zërat e punimeve: "Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/$m^2$"; "F.V bordura betoni 20x35 cm beton 16/20" dhe "Bazament betoni (rrethrrotullimi)dhe zëri (2.271) shtresë mozaik mermeri (rrethrrotullimi)", janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **262,220 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. |
| **Kriteri:** | Kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi. |
| **Ndikimi** | Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës. |
| **Shkaku:** | Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandime**: | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t'i kërkojë Operatorit Ekonomik "V..." SHPK përfaqësuar nga administratori z. F.K., duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **262,220 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të |

| | |
|---|---|
| | pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres". |

**Gjetja nr. 26:** KLSH Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: "Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres", u konstatua se, se në piketën poshtë urës për gjatësinë 7 m dhe gjerësi 4 m shtresat asfaltike (shtresë binderi dhe shtresë asfaltobetoni) janë dëmtuar, dhe nisur nga fakti që punimet e ndërtimit janë brenda periudhës së garancisë, nga sipërmarrësi i punimeve duhet të merren masa për riparimin/zëvendësimin e tyre.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: "Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga Z. K.G. dhe Operatorit Ekonomik "V..." SHPK përfaqësuar nga administratori z. F.K., u konstatua se, se në piketën poshtë urës për gjatësinë 7 m dhe gjerësi 4 m shtresat asfaltike (shtresë binderi dhe shtresë asfaltobetoni) janë dëmtuar, dhe nisur nga fakti që punimet e ndërtimit janë brenda periudhës së garancisë, nga sipërmarrësi i punimeve duhet të merren masa për riparimin/zëvendësimin e tyre. Për sa më sipër realizimi i punimeve me cilësi të dobët, është në kundërshtim me DST dhe kontratën dy palëshe të nënshkruar. Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera deri në periudhën e auditimit, rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera në vlerën prej **262,220** lekë pa TVSH, e argumentuar si vijon:<br>**Punime rehabilitimi Axhensia dhe vendqendrimi i ri i autobuzave**<br>**Zëri (An) Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m$^2$.**<br>Në situacionin përfundimtar sasia e këtij zëri është 1285 m$^2$ me çmim 93.83 lekë. Libri i masave pasqyron 1285 m$^2$ zbatuar në objektin sheshi demokracia: Ky zë punimi në analizat teknike të punimeve të ndërtimit (manuali i çmimeve) është i përfshirë në zërat e punës "Shtresë binderi" dhe "Shtresë asfaltobetoni". Nisur nga ky fakt, ky zë pune nuk duhej situacionuar, për pasojë vlera e volumit prej 1285 m$^2$ , është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria "V..." SHPK, në shumën 120,571.55 lekë me TVSH [ 1285 m$^2$ x 93.83 lekë].<br>**Zëri (3.618) F.V bordura betoni 20x35 cm beton 16/20.**<br>Preventivi i ripunuar nr. 2 lidhur me zërin "Zëri (3.618) F.V bordura betoni 20x35 cm beton 16/20" pasqyron sasinë 150 ml, me çmim 1155.75 lekë. Situacioni pasqyron 150 ml bordura betoni me çmim 1155.75 lekë.<br>Libreza e masave pasqyron 150 ml bordura betoni realizuar në objektin parkimi i autobuzave. Në fakt nga auditimi i realizimit të këtij zëri punimesh në objekt rezultoi se, bordurat e betonit janë 17 x 25 cm dhe jo 20 x 35 cm, pra vendosja e tyre është bërë në kundërshtim me specifikimet teknike dhe kërkesat teknike të projektit të zbatimit.<br>Referuar analizës së çmimeve nr. 3.618 për zërin "Bordura betoni parafabrikat, 20 x 35 cm" çmimi total i këtij zëri është 1515 lekë, kurse zëri |

| | |
|---|---|
| | “Librazhderial” i bordurës 20 x 35 cm është 900 lekë. Pra bordura përbën 60 % (900/1515x100) të çmimit total të zërit.<br>- Referuar çmimit të zërit “F.V Bordura betoni parafabrikat, 20 x 35 cm” në ofertën ekonomike dhe situacionin përfundimtar, çmimi total i këtij zëri është 1155.75 lekë, kurse çmimi i vetë bordurës 20 x 35 cm, duke konsideruar peshën e bordurës sipas analizës së manualit (në masën 60%) është 693.45 lekë (60% x 1155.75 lekë).<br>Nisur nga fakti që sipërmarrësi ka përdorur bordura 17 x 25 cm, çmimi real i bordurës së përdorur duhet të ishte 693.45 lekë dhe diferenca e çmimit e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi është 462.30 lekë (1155.75 – 693.45).<br>Sa më sipër realizimi i zërit “F.V Bordura betoni parafabrikat C 16/20, 17 x25 cm”, sipas përllogaritjes me interpolim linear është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria “V...” SHPK., në vlerën **69,345 lekë pa TVSH** [462.3 lekë x 150 ml bordurë].<br>**Zëri (3.240) Bazament betoni (rrethrrotullimi) dhe zëri (2.271) shtresë mozaik mermeri (rrethrrotullimi).**<br>Në situacionin nr.1 zërat e punimeve të mësipërm rezultojnë të realizuar. Në librezën e masave bazamenti i beetonit është pasqyruar në volumin 4 $m^3$, por nuk janë përcaktuar dimensionet (gjatësia, gjerësia, lartësia) si piketa si refencë, edhe për zërin shtresë mozaik mermeri gjithashtu nuk janë përcaktuar dimensionet (gjatësia, gjerësia, lartësia) si piketa si refencë. Gjithashtu në librezë për këta dy zëra punimesh nuk është paaraqitur skica. Nga auditimi në objekt (tek sheshi Demokracia) u konstatua se nuk janë realizuar punimet.<br>Për sa më sipër zërat trajtuar është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria “V...” SHPK, në shumën **31,485.16 lekë** për zërin bazament betoni dhe **40,819.68 lekë** për zërin shtresë mozaik mermeri tek rrethrrotullimi. |
| **Kriteri:** | Kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi. |
| **Ndikimi** | Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës. |
| **Shkaku:** | Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandime**: | Bashkia Librazhd t’i kërkojë Operatorit Ekonomik “V...” SHPK , të marrë masa për riparimin e defekteve të konstatuara në shtresat asfaltike, si dhe të realizojë riparrimin e tyre në përputhje me specifikimet teknike brenda periudhës së garancisë së defekteve. |

**Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:**

1. Mbikëqyrësi i punimeve “Z...” SHPK, nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

- ***Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.*
- ***Kontratën** për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt* “Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazgdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres” *të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe shoqërisë* “V...” SHPK.

- ***UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*

**g-** Zbatimi i kontratës me objekt: **"Rehabilitim Urban, Zona në hyrjen perendimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore".**

**Gjetja nr. 27:** KLSH nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: "Rehabilitim Urban, Zona në hyrjen perendimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore", rezultoi se janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **245,000 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: "Rehabilitim Urban, Zona në hyrjen perendimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik "V..." SHPK përfaqësuar nga administratori (përfaqësues ligjor) z. F.K., u konstatua se zëri i punimeve: "Kallëp dërrase për mure", është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **245,000 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, e argumentuar si vijon:<br>**Ndërtim mur betoni mbrojtës L = 140 ml**<br>**Zëri 3 (305) Kallëp dërrase për mure.**<br>Preventivi i ripunuar për zërin "Kallëp dërrase për mure" pasqyron sasinë 490 $m^2$, me çmim 500 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 490 $m^2$ kallëp dërrase, me çmim 500 lekë. Libreza e masave pasqyron sasinë 1572 $m^2$ kallëp dërrase të detaluara në mënyrë analitike.<br>Referuar analizës së çmimeve nr. 3.243 për zërin "Beton C 16/20 mure" çmimi total i këtij zëri është 11,105 lekë, dhe përbëhet nga nënzërat:<br>Betonjere 500 liter, Vibrator thellësie, Çimento 32.5 N, Zall i lare lavatrice, Rere e lare, Uje, Kallepe dërrase<br>Sa më sipër duket qartë se çmimin e zërit "Kallëp dërrase për mure" është përfshirë edhe nënzëri "Kallëpe dërrase".<br>Nisur nga fakti që sipërmarrësi ka situacionuar dy herë zërin e kallëpeve, përkatësisht si zë më vete tek zëri 3.305 dhe si nën zë punimi në zërin 3.243, nuk duhej që i njëjti zë punimi të paguhet 2(dy) herë.<br>Sa më sipër, është librezuar dhe situacionuar më tepër " zëri i kallëpeve" dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria "V..." SHPK., në vlerën 245,000 lekë pa TVSH. |
| **Kriteri:** | Kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi dhe paragrafi i tretë i nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar. |
| **Ndikimi** | Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës. |
| **Shkaku:** | Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekoman dime**: | Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t'i kërkojë Operatorit Ekonomik "V..." SHPK përfaqësuar nga administratori z. F.K., duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **245,000 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të |

| | |
|---|---|
| | pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Rehabilitim Urban, Zona në hyrjen perendimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore" |

**Gjetja nr. 28:** KLSH nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: "Rehabilitim Urban, Zona në hyrjen perendimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore", u konstatua dëmtim i performancës së kontratës pasi mungonin 6 stola druri me çmim 30,000 lekë, të cilat duhet të zëvendësohen gjatë periudhës së garancisë së difekteve dhe në vijim duhet të njoftohet KLSH në rrugë zyrtare mbi realizimin e plote të këtij zëri punimesh, dhe nisur nga fakti që punimet e ndërtimit janë brenda periudhës së garancisë, nga sipërmarrësi i punimeve duhet të merren masa për zëvendësimin e tyre.

| | |
|---|---|
| **Situata:** | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: "Rehabilitim Urban, Zona në hyrjen perendimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd, përfaqësuar nga Z. K.G. dhe Operatorit Ekonomik "V..." SHPK përfaqësuar nga administratori z. F.K., u konstatua se, se mungonin 6 stola druri me çmim 30,000 lekë, të cilat duhet të zëvendësohen gjatë periudhës së garancisë së difekteve dhe në vijim duhet të njoftohet KLSH në rrugë zyrtare mbi realizimin e plote të këtij zëri punimesh, dhe nisur nga fakti që punimet e ndërtimit janë brenda periudhës së garancisë, nga sipërmarrësi i punimeve duhet të merren masa për zëvendësimin e tyre. |
| **Kriteri:** | Kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi. |
| **Ndikimi** | Efekt negativ në realizimin e kontratës me performancë të mirë. |
| **Shkaku:** | Dëmtim i pronës nga njërëz të papërgjegjshëm. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekoman dime**: | Bashkia Librazhd t'i kërkojë Operatorit Ekonomik "V..." SHPK , të marrë masa për zëvendësimin e stolave në përmbushje të kushteve të kontratës dhe të specifikimeve teknike brenda periudhës së garancisë së defekteve. |

**Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:**
1. Mbikëqyrësi i punimeve "M...." SHPK, nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:
- ***Ligjin nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7.*
- ***Kontratën*** *për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt* **"**Rehabilitim Urban, Zona në hyrjen perendimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore**"** *të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe shoqërisë* "V..." SHPK.
- ***UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 .*

Më hollësisht problematikat janë në **ANEKSIN E**, bashkëlidhur.

## Ç. MBI VLERËSIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM PUBLIK, PËR PERIUDHËN 2016-2018.

Bazuar në VKM nr.212, datë 30.03.2012, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", Njësia e Auditit të Brendshëm, Bashkia Librazhd është pjesë përbërëse e Strukturës Organizative të Bashkisë, Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se: **manuali specifik** është hartuar mbështetur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresën nr 758, datë 02.06.2014. **Karta e Auditit të Brendshëm** është hartuar në zbatim të nenit nr.12, pika c, nenit 14, pika b dhe nenit 24, pika c të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik", një kopje e të cilit është dërguar në Njësinë Qëndrore të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (NJQHAB).

**Gjetje nr. 29:**

**Situata**

Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Librazhd për periudhën objekt auditimi është miratuar për të funksionuar me tre punonjës, në fakt për periudhën 01.01.2016 deri me 30.06.2018 ka funksionuar me një punonjës dhe më pas me dy punonjës, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik".
Në fakt nga auditimi rezultoi se për periudhën 01.01.2016 deri me 30.06.2018, kjo strukturë ka funksionuar me një punonjës, me detyrën e përgjegjësit dhe pas kësaj me dy punonjës në detyrën auditues. Nga auditimi rezulton se përgjegjësi nuk është me statusin e nëpunësit civil, ka certifikatën si audit i brendshëm.
U konstatua se për periudhën objekt auditimi plani i auditimeve nuk është realizuar 100% , sipas tabels sa vijon:

| Viti | Plan | Fakt | % |
|---|---|---|---|
| 2016 | 10 | 5 | 50 |
| 2017 | 9 | 6 | 78 |
| 2018 | 9 | 7 | 83 |

Për vitin 2016, janë rekomanduar gjithsej 22 masa (8 masa shpërblim dëmi dhe 14 masa organizative);
Për vitin 2017, janë rekomanduar gjithsej 50 masa (29 masa organizative dhe 21 masa shpërblim dëmi);
Për vitin 2018, janë rekomanduar gjithsej 41 masa (40 organizative dhe 1masë shpërblim dëmi).
Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Librazhd, nuk ka vlerësuar si duhet riskun, dhe për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, si dhe nuk ka arkëtim dëmi, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Raportimi nga AB është bërë i saktë.Për vitin 2016, janë rekomanduar gjithsej 22 masa (8 masa shpërblim dëmi dhe 14 masa organizative);
Për vitin 2017, janë rekomanduar gjithsej 50 masa (29 masa organizative dhe 21 masa shpërblim dëmi);

| | |
|---|---|
| | Për vitin 2018, janë rekomanduar gjithsej 41 masa (40 organizative dhe 1masë shpërblim dëmi). Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Librazhd, nuk ka vlerësuar si duhet riskun, dhe për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, si dhe nuk ka arkëtim dëmi, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Raportimi nga AB është bërë i saktë. |
| **Kriteri** | Ligji nr. 114/2015 datë 06.11.2015, "Për Auditimin e Brendshëm ne Sektorin Publik", VKM nr.212, datë 30.03.2012, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10 2016, "Për miratimin e Manualit te Auditimit te Brendshëm në sektorin publik" |
| **Impakti** | Mos thellimi në problematikat e trajtuara sipas fushave në auditimet e kryera si dhe mos nxjerrja e përgjegjësive e mos marrja e masave për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke mos realizuar kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. |
| **Shkaku** | Mungesa e kontrollit të rekomandimeve dhe cilësisë së auditimeve të kryera. |
| **Rëndësia** | I mesëm. |
| **Rekomandimi:** | Nga Bashkia Librazhd të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të plotësohet me numrin e punonjësve sipas organikës së miratuar, të bëjë program të veçantë për auditivin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për cdo auditim. |
| **Afati për zbatim** | Në vazhdimësi. |

*Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi: z.R.H. me detyrë Përgjegjës i Njësisë së Aditit të Brendshëm për periudhën e auditimit.*

## IV GJETJET DHE REKOMANDIMET

**Në përfundim të trajtimit të çështjeve sa në sipër për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë:**

**A- <u>MASA ORGANIZATIVE</u>:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera në Bashkinë Librazhd rezultoi se, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk është përcaktuar qartë tërësia e rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Është hartuar rregullorja e funksionimit të njësisë, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se:
-*Në lidhje me mjedisin e kontrollit*. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh.
-*Në lidhje me menaxhimin e riskut:* Nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut sipas nenit 21. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.
-*Në lidhje me informacionin dhe komunikimin*: Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohej me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 23 – 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
- Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Librazhd, për periudhën objekt auditimi, është miratuar për të funksionuar me tre punonjës. Nga auditimi rezultoi se për periudhën 01.01.2016 deri me 30.06.2018, ka funksionuar me një punonjës dhe më pas me dy punonjës. NJAB nuk ka vlerësuar si duhet riskun.
- Për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10 2016, “Për miratimin e Manualit te Auditimit te Brendshëm në sektorin publik” “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 75 -77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>1.1. Rekomandimi:</u>** Nga Bashkia Librazhd, nëpërmjet Nëpunësit Autorizues dhe strukturës së Auditit të Brendshëm, të marren masa për njohjen nga menaxhimi dhe stafi i MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe

kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**Në vijimësi.**

**1.2.Rekomandimi:** Nga Bashkia Librazhd të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të plotësohet me numrin e punonjësve sipas organikës së miratuar,

**1.3. Rekomandimi**: NJAB, Bashkia Librazhd, të hartojë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për cdo auditim.

**Menjëherë.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara, rezultoi se:

**a-** ***Llogaria 210*** *"Toka, troje, terrene",* sipas të dhënave të pasqyrave financiare, në fund të vitit 2017 paraqitet në vlerën **2,882,715** lekë. Krahasuar me vitin 2016 ka shtesë në zërin "Toka, troje terrene" në vlerën **2,261,693 lekë**. Kjo shtesë ka të bëjë me investime në varrezat e reja publike të qytetit me emërtimin "Varrezat e fushës së Manes", në vlerën 2,261,693 lekë, investim i përfunduar dhe i marrë në dorëzim gjatë vitit 2017. **Vlera prej 621,522 lekë** (e përbërë nga 144,650 lekë vlera e truallit të varrezave të vjetra të qytetit, dhe 476,872 lekë vlera e trashëguar nga ish komuna Qendër, sot NJA e Bashkisë Librazhd, për prita lumore e mbrojtje tokash) është gjendje në fund të vitit 2016. ***Pavarësisht se është regjistruar në kontabilitet "Prita lumore" e trashëguar nga ish komuna Qendër, në vlerën 476,872 lekë, nuk është e regjistruar në ZVRPP.***

**b-** ***Llogaria 211*** "Pyje, kullota, plantacione" paraqitet në vlerën 4,662,464 lekë dhe i përket ish komunës Hotolisht. Kjo llogari nuk ka pësuar ndryshime krahasuar me vitin 2016. Për këto objekte janë hartuar listat, por për këto pasuri nuk është kryer regjistrimi i pronave në ZVRPP, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi VKM nr. 510, datë 10.6.15 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme" që janë vënë në dispozicion të Bashkisë Librazhd dhe njësive administrative.

**c- Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione"** është në vlerën 557,525,466 lekë dhe përbehet nga 111 ndërtesa. Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të Bashkisë Librazhd vlera e llogarisë "Ndërtime e konstruksione" në fund të vitit 2017 është 557,525,466 lekë. Krahasuar me vitin 2016 kemi një shtesë prej **15,544,739** lekë. Në debi të kësaj llogarie janë kontabilizuar shpenzimet për investime të Bashkisë Librazhd gjate vitit 2017. Kjo shtese ka ardhur si rezultat i shtimit të vlerës se disa objekteve nga investimet e kryera në objekte.

Nga auditimi rezultoi se janë regjistruar si pasuri dhe janë pajisur me certifikatë pronësie vetëm ndërtesat në territorin e ish Bashkisë Librazhd, përkatësisht 22 ndërtesa me një vlerë në kontabilitet prej 161,220,267 lekë. Ndërsa për 89 ndërtesa qe ndodhen ne territorin e ish komunave qe i janë bashkuar Bashkisë Librazhd në kuadrin e reformës territoriale dhe qe janë përfshirë në kontabilitet me një vlere prej 396,323,199 lekë, nuk është bere regjistrimi i tyre si pasuri e Bashkisë Librazhd .

***d- Llogaria 213*** *"Rrugë, rrjete vepra ujore"*, sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Librazhd, në fund të vitit 2017 është në shumën 1,958,871,679 lekë. Krahasuar me vitin 2016 kemi një shtesë në vlerë të kësaj llogarie **prej 677,009,852 lekë** si rezultat i investimeve të kryera nga Bashkia Librazhd gjate vitit 2017 në shumën **80,019,117 lekë**, në rrugë, rrjete e vepra ujore si dhe si rezultat i transferimit kapital pa pagesë të kanaleve vaditëse nga Drejtoria Rajonale e Ujitjes dhe Kullimit Korçe. Shtesat e kësaj llogarie gjatë vitit 2017 janë në vlerën **596,990,736 lekë**.

Lista e objekteve të ardhura nga Drejtoria Rajonale e Kullimit Korçe për rrjete vepra ujore kanë vlere fillestare, por këto objekte nuk janë hipotekuar, regjistrimi i tyre në kontabilitet është kryer sipas proces-verbalit datë 18.12.2016, "Mbi gjendjen aktuale për transferimin e infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit" të mbajtur nga komisionet përkatëse të Bordit Rajonal të Kullimit Korçë dhe Bashkisë Librazhd, me nr. prot 1528, datë 16.03.2017. ***Nga ana e Bashkisë Librazhd*** asetet janë bëra hyrje dhe janë kontabilizuar, pa u regjistruar në ZVRPP.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 24 – 27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Librazhd të merren masa për inventarizimin e këtyre aktiveve, plotësimi i dosjes me dokumentet ligjore dhe regjistrimi i tyre ne ZVRPP Librazhd.

**Menjëherë.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i **Llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm"** rezultoi se sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Librazhd gjendja e debitorëve ne fund te vitit 2017 është 75,553,179 lekë. Konstatohet se nuk janë përfshire në bilancet e viteve 2016- 2017 detyrimet e pa likuiduara për vendimet gjyqësore në **vlerën 9,094,562 lekë.** Gjatë vitit 2017-2018, janë likuiduar detyrimet e lindura nga vendimet gjyqësorë të formës prerë **6,883,329 lekë**, pavarësisht se nuk janë përfshirë në bilancin e viteve të mësipërme. Vlera e detyrime për vendimet gjyqësore të formës se prerë me datë 31.12.2018 është 22,656,907 lekë, vlerë e cila duhet të përfshihet ne bilancin e vitit 2018.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 27 – 28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Nga auditimi u konstatua se në fund të vitit 2018, detyrimet e faturuara dhe të pa likuiduara për fondet e bashkisë, buxhetit të shtetit, Fondit të Zhvillimit të Rajoneve dhe Vendimeve Gjygjësore në fund të vitit 2018 është **në shumën 87,132,631 lekë** Nga të cilat:
-Fatura të pa likuiduara për mallra e shërbime, për 33 raste në vlerën, 28,831,096 lekë;
-Fatura të pa likuiduara për mallra e shërbime para vitit 2015 nga ish Komunat, janë 9 raste në vlerën, 35,644,628 lekë;
-Vendime gjygjësore në vlerën, 22,656,907 lekë,
mos likuidimi i detyrimeve vjen në kundërshtim me nenin 52- *Kryerja e shpenzimeve*, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 9 dhe 10, të ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" i ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.05.2014; Udhëzimin plotësues të MF nr. 02, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 – *Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.*
*(Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 33 -34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1. Rekomandimi:** Nga ana e Bashkisë Librazhd, të merren masa që të përfshihet vlera e detyrimeve për vendimet gjyqësore të formës së prerë në shumën 22,656,907 lekë ne bilancin e vitit 2018.
**3.2.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, Drejtoria Ekonomike, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **87,132,631 lekë.**

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Taksave, Bashkia Librazhd, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të

zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **188 persona** me vlerë **6,368,160 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd, sipas Aneksit nr. 21.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 34 -35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Sektorit të Taksave në bashkëpunim me ALUIZNI-n Librazhd dhe ZVRPP Librazhd të merren masa të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së infrastrukturës në vlerën **6,368,160 lekë**.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej **520 subjekte debitore, për vlerën 26,214,306 lekë lekë** (sipas Anekseve nr. 22, 23 dhe 24) dhe **4921 familje për vlerën 39,016,000 lekë** (për taksë toke në vlerën 18,711,000 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 7,134,000 lekë, për taksë trualli në vlerën 35,000 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 13,136,000 lekë. Kështu sipas të dhënave kemi 480 subjekte aktiv me detyrime, e barabartë me 92.3% të numrit total të subjekteve (520 subjekte), gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të Sektorit të Taksave në arkëtimin e detyrimeve debitorë,
Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për njoftimin e subjekteve debitore të biznesit të vogël nuk ka zbatuar përcaktimet e pikës 1 të nenit 89, të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 35 -37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Taksave, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj 520 subjekteve me vlerë prej 26,214,306 lekë dhe 4921 familje për vlerën 39,016,000 lekë dhe në bashkëpunim me Sektorin Juridik, në funksion të mbledhjes së detyrimeve të papaguara, të marrë masa administrative apo sekuestro deri në kallëzim penal për mos pagesë të detyrimeve.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Librazhd, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e lidhura me subjektet për shfrytëzimin e sipërfaqeve për ndërtimin e HECEVE, **për vlerën 2,465,694 lekë,** që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, Veprim në kundërshtim me nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe kushtet e kontratave.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 37 -38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**6.1. Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **2,465,694 lekë,** nga *(subjekti "D...." në vlerën 339,300 lekë, "Hec. D...." në vlerën 1,421,733 lekë, "E...." në vlerën 359,500 lekë dhe "B...." në vlerën 345,161 lekë).*

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Librazhd, për subjektet të cilat nga MIE kanë marrë leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore dhe kullosore nuk ka zbatuar kërkesat ligjore, për lidhjen e kontratave për shfrytëzim të fondit pyjor nga subjekte të ndryshme **me sipërfaqe 512 ha**, për realizimin e të ardhurave për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me kërkesave të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të pikës 6 neni 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor", me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, nuk ka njoftuar subjektet për t`u paraqitur për lidhjen e kontratave për të ushtruar këtë aktivitet dhe likuidimin e detyrimeve që lindin nga zbatimi i VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", sipas lidhjes nr. 2.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 38 -39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>7.1 Rekomandimi:</u>** Agjencia e Pyjeve dhe Kullotave Bashkia Librazhd, t'i kërkojë Ministrisë Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.
Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi: KLSH nga auditimi konstatoi se** fondi limit dhe specifikimet teknike për procedurat e prokurimit per vitet 6 mujori i dytë 2016, 2017 e 2018, janë përllogaritur nga komisionet e vlerësimit të fondit limit, të ngritur sipas urdhrave të Kryetarit të Bashkisë, sipas tabelave ANEKS C/3, bashkëlidhur. Në këto urdhra është përcaktuar që specifikimet teknike të hartohen në përputhje me kërkesat e nenit 23 "Specifikimet teknike" të LPP. Në kundërshtim me urdhrin e dhënë nga Titullari i AK në procesverbalet e punës së komisioneve, ku është hartuar preventivi (fondi limit), nuk janë përcaktuar kërkesat teknike në lidhje me procedurën e prokurimit (fuqinë punëtore, stafin drejtues teknik, punonjësit e specializuar, kategoritë e licencës, makineritë, certifikatat ISO, etj.), në kundërshtim me kërkesat e nenit 23/4 të LPP, si dhe të Urdhrave të Titullarit të Autoritetit Kontraktor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 39 -44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>8.1. Rekomandimi:</u>** Bashkia Librazhd të marrë masa që komisionet e hartimit të fondit limit, të respektojnë urdhrat e Titullarit të AK si dhe aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik.

**Menjëherë.**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt "Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)" të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe BOE "B..." SHPK & "C..." shpk, me nr.kontrate 7352 prot dt. 28.12.2016, përfaqësuar nga OE "B...", u konstatua se aktualisht në veprën e ndërtuar, me vlerë 16.223.216 lekë nuk është montuar pajisja "Impianti i klorifikimit të ujit të pishëm" me vlerë 351,549 lekë pa TVSH si dhe nuk është realizuar pika e lidhjes për furnizimin me energji elektrike të dhomës së komandimit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 62 -65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**9.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t'i kërkojë BOE "B..." SHPK & "C..." shpk, përfaqësuar nga OE "B..." SHPK, lidhjen e energjisë elektrike si dhe montimin e Impiantit të klorifikimit të ujit të pishëm, sipas projektit të zbatimit në zbatimin të detyrimeve kontraktuale i përcaktuar në kontratën dy paleshe.

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës nr. 3121 prot, datë 06.06.2017, me objekt: "Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik "V..." SHPK, me vlerë kontrate 130,072,725 lekë, u konstatua se, në progresivin Prog. 3+693 deri Prog. 3+713, pra për gjatësinë 20 m dhe gjerësi 4 m shtresat asfaltike kanë çeduar duke shkaktuar një efekt negativ si vijon:
- Shtresë binderi me zall lavatriçe, 5 cm me makineri 80 m2 x 1275 lekë = 80,000 lekë
- Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe, 3 cm me makineri 80 m2 x 1000 lekë = 102,000 lekë

Për sa më sipër është në kundërshtim me DST dhe kontratën e nënshkruar, cilësia e punimeve në ndërtim.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 68 -70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**10.1 Rekomandimi:** Bashkia Librazhd t'i kërkojë shoqërisë "V..." SHPK, të marrë masa për riparimin e defekteve të konstatuara në shtresat asfaltike, si dhe të realizojë riparrimin e tyre në përputhje me specifikimet teknike brenda periudhës së garancisë së defekteve.
Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa që në vazhdimësi për kryerjen e procesit të kolaudimit, të ngrejë grupin brenda 30 ditëve nga data e deklarimit të përfundimit të punimeve nga zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës Nr. 5439 dt. 11.09.2017, me vlerë 92,567,493 me objekt: "Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibrës", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik "V..." SHPK, u konstatua se, në piketën poshtë urës për gjatësinë 7 m dhe gjerësi 4 m shtresat asfaltike (shtresë binderi dhe shtresë asfaltobetoni) janë dëmtuar. Nisur nga fakti që punimet e ndërtimit janë brenda periudhës së garancisë AK të marrë masa që të mos e marrë në dorëzim pa bërë rregullimet përkatëse. Për sa më sipër realizimi i punimeve me cilësi të dobët, është në kundërshtim me DST dhe kontratën dy palëshe të nënshkruar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 71 -73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**11.1 Rekomandimi:** Bashkia Librazhd t'i kërkojë Operatorit Ekonomik "V..." SHPK , të marrë masa për riparimin e defekteve të konstatuara në shtresat asfaltike, si dhe të realizojë riparrimin e tyre në përputhje me specifikimet teknike brenda periudhës së garancisë së defekteve pasi objekti është në periudhën e garancisë së defekteve.

**Menjëherë**

## B- MASA PËR SHPËRBLIM DËMI :

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë

27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,483,680 lekë,** si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt : “Furnizimi me ujë i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd me nr.kontrate 7352 prot dt. 28.12.2016, me vlerë 16.223.216 lekë dhe Bashkimit të Operatorëve “B...” SHPK & OE “C...” shpk u konstatua se zërat e punimeve si vijon: Gërmim dheu me krah e transport me k. Dore 10 m, kategoria IV; Kollona të plota b/a C 16/20 të parapërgatitura dhe F.V Hekur betoni periodik ø 6-10 mm, janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **307,200 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 63 -64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>1.1 Rekomandimi:</u>** Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t’i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “B...” SHPK & “C...” shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **307,200 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Furnizimi me uje i fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza I)”.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës nr.7352 prot dt. 28.12.2016, me vlerë 16.223.216 lekë, me objekt: Ndërtimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza II), të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik “B...” SHPK u konstatua se zëri i punimeve: “2(3.30/c) Gërmim shkëmbi me krahë, në seksion të detyruar, h=1.5 m, shkëmb i fortë” është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **249,200 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 63 -65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>2.1 Rekomandimi:</u>** Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t’i kërkojë Operatorit Ekonomik “B...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 249,200 lekë pa TVSH, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit të fshatrave Dorez, Gizavesh, Librazhd Katund, Librazhd Qendër (Faza II)”.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës nr. 3121 prot, datë 06.06.2017, me vlerë kontrate 130,072,725 lekë, me objekt: “Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik “V...” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve “Zëri (An-9) Mbushje me zhavorr pas mureve”, është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në

shumën **267,804 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 66 -69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t'i kërkojë Operatorit Ekonomik "V..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **267,804 lekë pa TVSH,** të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Ndërtim Rruga Orenje-Librazhd (Loti II)".

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës Nr. 5484 prot dt. 14.10.2016, me vlerë 132,877,885 me objekt: "Rikualifikimi urban blloku i banimit nr. 1, qyteti Librazhd"), të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "E..." SHPK & "L..." SHPK, përfaqësuar nga OE "E..." SHPK, u konstatua se zëri i punimeve, "Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 $l/m^2$, Rruga e Policisë dhe Rruga Arbëria", është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume është në shumën **152,256 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 66 -70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**4.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t'i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "E..." SHPK & "L..." SHPK, përfaqësuar nga OE "E..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **152,256 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt **"**Rikualifikimi urban blloku i banimit nr. 1, qyteti Librazhd**".**

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës Nr. 5439 dt. 11.09.2017, me vlerë 92,567,493, me objekt: "Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik "V..." SHPK përfaqësuar nga administratori (përfaqësues ligjor) z. F.K., u konstatua se zërat e punimeve: "Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 $l/m^2$"; "F.V bordura betoni 20x35 cm beton 16/20" dhe "Bazament betoni (rreth rrotullimi) dhe zëri (2.271) shtresë mozaik mermeri (rreth rrotullimi)", janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume është në shumën **262,220 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 70 -70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**5.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t'i kërkojë Operatorit Ekonomik "V..." SHPK përfaqësuar nga administratori z. F.K., duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **262,220 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Rehabilitimi Urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit të Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibrës".

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës Nr. 5400 dt. 28.09.2016, me vlerë 98,640,612 lekë me objekt: "Rehabilitim urban, zona në hyrjen

perëndimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Librazhd dhe Operatorit Ekonomik “V...” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve: “Kallëp dërrase për mure”, është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume është në shumën **245,000 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 73 -74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**6.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia Librazhd, që t’i kërkojë Operatorit Ekonomik “V...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **245,000 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rehabilitim Urban, Zona në hyrjen perendimore në qytetin Librazhd dhe mbrojtjen lumore”.

**Menjëherë**

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**